



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.9

23 shkurt

2012

P Ë R M B A J T J A

Urdhër i MF
nr.3, datë 10.1.2012

Për shpalljen e ndryshimeve të disa Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), të ndodhura gjatë viteve 2010-2011.....

Faqe

353

URDHËR
Nr.3, datë 10.1.2012

PËR SHPALLJEN E NDRYSHIMEVE TË DISA STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË KONTABILITETIT (SNK) DHE STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR (SNRF), TË NDODHURA GJATË VITEVE 2010-2011

Në mbështetje të nenit nr.4, pika 3, të ligjit nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.672, datë 26.10.2005 “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe të funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit dhe sipas vendimit nr.4, datë 26.12.2011 të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit,

URDHËROJ:

1. Shpalljen për zbatim të ndryshimeve në standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe në standardet ndërkombëtare të raportimit financiar, të hartuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit gjatë viteve 2010 e 2011, dhe të përkthyer nga gjuha angleze nën përgjegjësinë e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, si më poshtë:

- Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit nr.27 “Pasqyrat financiare individuale”.
- Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit nr.28 “Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta”.

- Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar nr.9 “Instrumentet financiare”.

2. Njësitë ekonomike, të cilat sipas parashikimeve të ligjit nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe raportimin financiar” janë të detyruara të zbatojnë standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të raportimit financiar, të aplikojnë ndryshimet si në pikën 1 të këtij urdhri, duke filluar nga data 1 janar 2013.

3. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen e internetit të Ministrisë së Financave dhe në atë të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode



STANDARDI NDËRKOMBËTAR I KONTABILITETIT 27 PASQYRAT FINANCIARE INDIVIDUALE

Objektivi

1. Objektivi i këtij Standardi është të përshkruajë kërkesat lidhur me kontabilizimin dhe dhënien e informacioneve shpjeguese për investimet në filiale, sipërmarrjet e përbashkëta dhe pjesëmarrjet kur një njësi ekonomike përgatit pasqyra financiare individuale.

Objekti

2. Ky Standard do të zbatohet për kontabilizimin e investimeve në filiale, në sipërmarrje të përbashkëta dhe në pjesëmarrje, kur njësi ekonomike zgjedh të paraqesë pasqyra financiare individuale ose kur kjo gjë i kërkohet nga rregullat lokale.

3. Ky Standard nuk ka detyrimin të përcaktojë se cilat njësi ekonomike duhet të hartojnë pasqyra financiare individuale. Ai zbatohet kur një njësi ekonomike përgatit pasqyra financiare individuale në përputhje me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar.

Përkufizimet

4. Në këtë standard termat e mëposhtëm janë përdorur me këto kuptime:

Pasqyra financiare të konsoliduara janë pasqyrat financiare të një grupi ku aktivet, pasivet, kapitali i vet, të ardhurat, shpenzimet dhe fluksi i mjeteve monetare të shoqërisë kontrolluese dhe filialeve të saj paraqiten si pasqyra financiare të një njësie të vetme ekonomike.

Pasqyra financiare individuale janë pasqyrat financiare që paraqiten nga një shoqëri mëmë (d.m.th. një investitor që kontrollon një filial) ose nga një investitor me kontroll të përbashkët, ose me ndikim të rëndësishëm mbi një sipërmarrje, në të cilën investimet trajtohen me kosto ose në përputhje me SNRF 9 “Instrumentet financiare”.

5. Termat në vijim janë përkufizuar në shtojcën A të SNRF 10 “Pasqyrat financiare” të konsoliduara, në shtojcën A të SNRF 11 “Marrëveshjet e përbashkëta dhe në paragrafin 3 të SNK 28 Investime në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta”:

- pjesëmarrje;
- kontroll;
- grup;
- kontroll i përbashkët;
- sipërmarrje e përbashkët;
- sipërmarrës i përbashkët;
- njësi ekonomike kontrolluese;
- ndikim i rëndësishëm;
- filial.

6. Pasqyra financiare individuale janë ato pasqyra që paraqiten së bashku me pasqyrat financiare të konsoliduara ose pasqyrat financiare ku investimet në filial ose në sipërmarrjet e përbashkëta trajtohen sipas metodës së kapitalit, me përjashtim të rrethanave të paraqitura në paragrafin 8. Nuk nevojitet që pasqyrat financiare individuale t’u bashkëngjiten apo të shoqërojnë këto pasqyra.

7. Pasqyrat financiare në të cilat është përdorur metoda e kapitalit nuk janë pasqyra financiare individuale. Gjithashtu, pasqyrat financiare të një njësie ekonomike që nuk ka filial, pjesëmarrje ose interes sipërmarrës të përbashkët në një sipërmarrje të përbashkët nuk janë pasqyra financiare individuale.

8. Një njësi ekonomike që përjashtohet nga konsolidimi në përputhje me paragrafin 4 (a) të SNRF 10 ose që përjashtohet nga zbatimi i metodës së kapitalit në përputhje me paragrafin 17 të SNK 28 (i ndryshuar në 2011) mund të paraqesë pasqyrat financiare individuale si të vetmet pasqyra financiare.

Përgatitja e pasqyrave financiare individuale

9. Pasqyrat financiare individuale do të përgatiten në përputhje me të gjitha SNRF-të e zbatueshme, me përjashtim të kërkesave të paragrafit 10.

10. Kur një njësi ekonomike përgatit pasqyra financiare individuale, ajo do të trajtojë investimet në filial, sipërmarrje të përbashkëta dhe pjesëmarrje, ose:

- a) me kosto; ose
- b) në përputhje me SNRF 9.

Njësia ekonomike do të zbatojë të njëjtin trajtim kontabël për çdo kategori të investimeve. Investimet e mbajtura me kosto duhet të kontabilizohen në përputhje me SNRF 5, aktivet afatgjata që mbahen për t'u shitur dhe operacionet jo të vijueshme kur ato janë klasifikuar si të mbajtura për shitje (ose janë përfshirë në një grup për nxjerrje nga përdorimi që është klasifikuar si i mbajtur për shitje). Matja e investimeve që kontabilizohen sipas SNRF 9 nuk ndryshon në rrethana të tilla.

11. Nëse një njësi ekonomike zgjedh, në përputhje me paragrafin 18 të SNK 28 (ndryshuar në vitin 2011) të masë investimet e saj në një filial ose në sipërmarrje të përbashkët me vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes në përputhje me SNRF 9, ajo duhet t'i trajtojë këto investime në pasqyrat financiare individuale të saj në të njëjtën mënyrë.

12. Një njësi ekonomike do të njohë një dividend nga një filial, sipërmarrje e përbashkët ose pjesëmarrje, në fitim ose humbje në pasqyrat financiare individuale të saj, në kohën kur përcaktohet e drejta për marrjen e dividendit.

13. Kur një njësi ekonomike kontrolluese riorganizon strukturën e saj të grupit nëpërmjet krijimit të një njësie ekonomike të re si kontrolluese të saj në mënyrë që të plotësohen kërkesat në vijim:

a) njësia e re kontrolluese merr kontrollin nga njësia ekonomike kontrolluese e mëparshme nëpërmjet emetimit të instrumenteve të kapitalit në këmbim të instrumenteve ekzistuese të kapitalit të njësisë ekonomike kontrolluese fillestare;

b) aktivet dhe pasivet e grupit të ri dhe të grupit fillestar janë të njëjta, menjëherë, para dhe pas riorganizimit; dhe

c) pronarët e njësisë ekonomike kontrolluese fillestare para riorganizimit zotërojnë të njëjtat madhësi absolute dhe relative interesi mbi aktivet neto të grupit fillestar dhe të grupit të ri menjëherë para dhe pas riorganizimit;

dhe njësia ekonomike kontrolluese e re, në pasqyrat financiare të saj i kontabilizon investimet e saj në njësinë ekonomike kontrolluese fillestare në përputhje me paragrafin 10 (a), njësia ekonomike e re kontrolluese duhet të masë koston e investimit me vlerën kontabël të aksioneve të saj në zërat e kapitalit të vet të pasqyrave financiare individuale të njësisë ekonomike kontrolluese fillestare në datën e riorganizimit.

14. Në mënyrë të ngjashme, një njësi ekonomike që nuk është njësi kontrolluese mund të krijojë një njësi ekonomike të re si kontrolluese të saj në një mënyrë që plotëson kërkesat e paragrafit 13. Kërkesat në paragrafin 13 zbatohen njëllor edhe për këto riorganizime. Në raste të tilla termat “njësia kontrolluese fillestare” dhe “grupi fillestar” i referohen “njësisë ekonomike fillestare”.

Dhënia e informacioneve shpjeguese

15. Njësia ekonomike duhet të zbatojë të gjitha SNRF-të përkatëse kur ajo jep informacione shpjeguese në pasqyrat financiare individuale të saj, përfshirë kërkesat në paragrafët 16 dhe 17.

16. Kur një njësi ekonomike kontrolluese në përputhje me paragrafin 4 (a) të SNRF 10, zgjedh të mos përgatisë pasqyra financiare të konsoliduara dhe në vend të tyre përgatit pasqyra financiare individuale, ajo duhet të japë informacione shpjeguese në këto pasqyra për:

a) faktin që pasqyrat financiare janë pasqyra financiare individuale; që është përdorur përjashtimi nga konsolidimi; emrin dhe vendin kryesor të biznesit (dhe shteti ku është regjistruar nëse është i ndryshëm) i njësisë ekonomike, pasqyrat financiare të konsoliduara të së cilës, që janë sipas standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar, kanë qenë hartuar për përdorim publik; dhe adresa ku mund të merren këto pasqyra financiare individuale.

b) një listë të investimeve të rëndësishme në filiale, sipërmarrje të përbashkëta dhe pjesëmarrje, përfshirë:

- i) emrin e këtyre investimeve;



ii) vendin kryesor të biznesit (dhe shtetin ku është regjistruar nëse është i ndryshëm) të këtyre investimeve;

iii) pjesën e saj të interesave të zotëruar (dhe pjesën e saj të të drejtave për të votuar, nëse janë të ndryshme) në këto investime.

c) një përshkrim të metodës së përdorur për të kontabilizuar investimet e listuara në pikën (b).

17. Kur një njësi ekonomike kontrolluese (përveç atyre të përcaktuara në paragrafin 16) ose një investitor me kontroll të përbashkët ose ndikim të rëndësishëm mbi një investim, përgatit pasqyra financiare individuale, njësia ekonomike kontrolluese ose investitori do të identifikojë pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me SNRF 10, SNRF 11 ose SNK 28 (ndryshuar në vitin 2011) se kujt i përket. Njësia ekonomike kontrolluese ose investitori duhet të japë, gjithashtu, informacione shpjeguese në pasqyrat financiare individuale të saj për:

a) faktin që pasqyrat janë pasqyra financiare individuale dhe arsyet pse janë përgatitur këto pasqyra nëse kjo nuk kërkohet nga ligji.

b) listën e investimeve të rëndësishme në filiale, sipërmarrje të përbashkëta dhe pjesëmarrje, përfshirë:

i) emrin e këtyre investimeve.

ii) vendin kryesor të biznesit (dhe shtetin ku është regjistruar nëse është i ndryshëm) të këtyre investimeve.

iii) pjesën e saj të interesave të zotëruar (dhe pjesën e saj të të drejtave për të votuar, nëse janë të ndryshme) në këto investime.

c) një përshkrim të metodës së përdorur për të kontabilizuar investimet e listuara në pikën (b).

Njësia ekonomike kontrolluese ose investitori, gjithashtu, duhet të identifikojë se kujt i përket pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me SNRF 10, SNRF 11 ose SNK 28 (ndryshuar në vitin 2011).

Data e hyrjes në fuqi dhe dispozitat kalimtare

18. Njësia ekonomike duhet të zbatojë këtë Standard për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 janar 2013 e në vijim. Lejohet zbatimi para kësaj date. Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë Standard për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione për këtë fakt dhe të zbatojë njëkohësisht SNRF 10, SNRF 11, SNRF 12 “Dhënia e informacioneve shpjeguese mbi interesat në njësi të tjera ekonomike” dhe SNK 28 (ndryshuar në vitin 2011).

Referenca të SNRF 9

19. Nëse një njësi ekonomike zbaton këtë Standard, por akoma ajo nuk ka zbatuar SNRF 9, çdo referencë ndaj SNRF 9 duhet të lexohet si referencë ndaj SNK 39 “Instrumentet financiare: Njohja dhe matja”.

Shfuqizimi i SNK 27 (2008)

20. Ky Standard është nxjerrë njëkohësisht me SNRF 10. Së bashku, të dy SNRF-të zëvendësojnë SNK 27 “Pasqyrat financiare të konsoliduara dhe individuale (ndryshuar në vitin 2008).

STANDARDI NDËRKOMBËTAR I KONTABILITETIT 28 INVESTIMET NË PJESËMARRJE DHE SIPËRMARRJET E PËRBASHKËTA

Objektivi

1. Objektivi i këtij standardi është të përshkruajë trajtimin kontabël për investimet në pjesëmarrje dhe të përcaktojë kërkesat për zbatimin e metodës së kapitalit neto kur bëhet trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta.

Qëllimi

2. Ky standard do të zbatohet nga të gjitha njësitë ekonomike që janë investitore me kontroll të përbashkët, ose influencë të konsiderueshme mbi një të investuar.

Përkufizimet

3. Më poshtë jepen përkufizimet e disa termave që përdoren në këtë standard:

Një pjesëmarrje është një njësi ekonomike mbi të cilën investitori ka influencë domethënëse.

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë pasqyrat financiare të një grupi në të cilin aktivet, pasivet, kapitali neto, të ardhurat, shpenzimet dhe flukset e mjeteve monetare të shoqërisë mëmë dhe filialeve të saj janë paraqitur si të ishte një njësi ekonomike e vetme.

Metoda e kapitalit neto është një metodë e kontabilitetit sipas së cilës investimi njihet fillimisht me kosto dhe më pas rregullohet për ndryshimet pas blerjes të pjesës që i përket investitorit tek aktivet neto të të investuarit. Fitimi ose humbja e investitorit përfshin pjesën e tij në fitimin ose humbjen e të investuarit dhe të ardhurat e tjera të përgjithshme të investitorit përfshijnë pjesën e tij në të ardhurat e tjera të përgjithshme të të investuarit.

Një marrëveshje e përbashkët është një marrëveshje nga e cila dy ose më shumë palë kanë kontroll të përbashkët.

Kontroll i përbashkët është ndarja kontraktuale e miratuar e kontrollit të një marrëveshjeje, kontroll ky që ekziston vetëm kur vendimet për aktivitetet përkatëse kërkojnë pëlqimin unanimit të palëve që ndajnë kontrollin.

Një sipërmarrje e përbashkët është një marrëveshje e përbashkët ku palët që kanë kontroll të përbashkët në marrëveshje kanë të drejta në aktivet neto të marrëveshjes.

Një sipërmarrës i përbashkët është palë në një sipërmarrje të përbashkët që ka kontrollin e kësaj sipërmarrjeje.

Influencë domethënëse është fuqia për të marrë pjesë në vendimet për politikën financiare dhe operative të të investuarit, por nuk është kontroll ose kontroll i përbashkët i këtyre politikave.

4. Përkufizimet e termave të mëposhtëm jepen në paragrafin 4 të SNK 27 “Pasqyrat financiare individuale” dhe në shtojcën A të SNRF 10 “Pasqyrat financiare të konsoliduara” dhe janë përdorur në këtë standard sipas kuptimit të dhënë në SNRF-të ku ata janë përcaktuar:

- kontrolli i një të investuari;
- grupi;
- shoqëria mëmë;
- pasqyra financiare individuale;
- filial.

Influenca domethënëse

5. Nëse një njësi ekonomike zotëron, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë (p.sh. nëpërmjet filialeve) 20 për qind ose më shumë të fuqisë votuese të të investuarit, presupozohet që njësi ekonomike ka influencë domethënëse, me përjashtim të rastit kur mund të shihet qartë se kjo nuk është e vërtetë. Në të kundërtën, nëse njësi ekonomike zotëron, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë (p.sh. nëpërmjet filialeve) më pak se 20 për qind të fuqisë votuese të investuarit, presupozohet se njësi ekonomike nuk ka influencë thelbësore, përveç rasteve kur tregohet qartë se një zotërim i tillë nuk përbën influencë thelbësore. Një zotërim thelbësor ose i pjesës më të madhe të pronësisë nga një investitor tjetër nuk pengon medoemos një njësi ekonomike që të ketë influencë thelbësore.

6. Ekzistenca e influencës së konsiderueshme nga një njësi ekonomike, zakonisht, evidentohet në një ose më shumë nga mënyrat e mëposhtme:

- a) përfaqësimi në bordin e drejtorëve ose në organin ekuivalent qeverisës të të investuarit;
- b) pjesëmarrja në proceset e hartimit të politikave, duke përfshirë pjesëmarrjen në vendimet për dividendët ose shpërndarjet e tjera;
- c) transaksione materiale ndërmjet njësisë ekonomike dhe të investuarit të saj;
- d) shkëmbimi i personelit drejtues; ose
- e) sigurimi i informacionit thelbësor teknik.

7. Një njësi ekonomike mund të zotërojë garanci aksionesh të veta, opsione blerje aksionesh, instrumente borxhi ose të kapitalit neto që janë të konvertueshme në aksione të zakonshme, ose instrumente të tjera të ngjashme që, nëse ushtrohen ose konvertohen, kanë potencialin t’i japin njësisë ekonomike fuqi votuese shtesë ose të zvogëlojnë fuqinë votuese të një pale tjetër mbi politikën financiare dhe operative të një njësie tjetër ekonomike (p.sh. të drejtat votuese potenciale). Ekzistenca dhe efekti i të



drejtave votuese potenciale që janë aktualisht të ushtrueshme ose të konvertueshme, duke përfshirë të drejtat votuese potenciale të mbajtura nga njësitë e tjera ekonomike, merren parasysh kur vlerësohet nëse një njësi ekonomike ka influencë thelbësore. Të drejtat votuese potenciale nuk janë aktualisht të ushtrueshme ose të konvertueshme kur, për shembull ato nuk mund të ushtrohen ose të konvertohen deri në një datë të ardhshme, ose deri në ndodhjen e një ngjarjeje të ardhshme.

8. Në vlerësimin nëse të drejtat votuese potenciale kontribuojnë në influencën thelbësore, njësi ekonomike shqyrton të gjitha faktet dhe rrethanat (përfshirë kushtet e ushtrimit të të drejtave votuese potenciale dhe çdo marrëveshje tjetër kontraktuale edhe nëse konsiderohet individualisht apo në kombinim) që ndikojnë në të drejtat potenciale, me përjashtim qëllimeve të drejtimit dhe aftësisë financiare për t'i ushtruar ose konvertuar këto të drejta potenciale.

9. Një njësi ekonomike humb influencën thelbësore mbi një të investuar kur ajo humb fuqinë për të marrë pjesë në vendimet politike financiare dhe operative të këtij të investuari. Humbja e influencës thelbësore mund të ndodhë me ose pa një ndryshim në nivelet relative apo absolute të zotërimit. Kjo mund të ndodhë, për shembull, kur një pjesëmarrje bëhet subjekt i kontrollit të qeverisë, gjykatave, administratorëve ose rregullatorëve. Gjithashtu, kjo mund të ndodhë edhe si rezultat i një marrëveshjeje kontraktuale.

Metoda e kapitalit neto

10. Sipas metodës së kapitalit neto, në njohjen fillestare investimi në një pjesëmarrje ose në një sipërmarrje të përbashkët njihet me kosto dhe vlera kontabël rritet apo ulet për të njohur pjesën e investitorit në fitimin ose humbjen e të investuarit pas datës së blerjes. Pjesa e investitorit në fitimin ose humbjen e të investuarit njihet në fitimin ose humbjen e investitorit. Shpërndarjet e marra nga një i investuar zvogëlojnë vlerën kontabël të investimit. Gjithashtu, mund të jenë të nevojshme rregullimet në vlerën kontabël për ndryshimet në interesin proporcional të investitorit në të investuarin, që rrjedhin nga ndryshimet në të ardhurat e tjera të përgjithshme të të investuarit. Këto ndryshime përfshijnë ato që rrjedhin nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale dhe nga diferencat e përkthimit të këmbimit të monedhave të huaja. Pjesa e investitorit në këto ndryshime njihet në të ardhurat e tjera të përgjithshme të tij (shih SNK 1 “Paraqitja e pasqyrave financiare”).

11. Njohja e të ardhurave në bazë të shpërndarjeve të marra nuk mund të jetë një matje e përshtatshme e të ardhurave të fituara nga një investitor për një investim në një pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët, për shkak se shpërndarjet e marra mund të kenë pak lidhje me performancën e pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët. Për shkak se investitori ka kontroll të përbashkët, ose influencë domethënëse mbi të investuarin, ai ka një interes në pjesëmarrjen ose sipërmarrjen e përbashkët dhe, si rezultat, kthim nga investimi i tij. Investitori e llogarit këtë interes duke zgjeruar objektin e pasqyrave të tij financiare për të përfshirë pjesën e tij të fitimit ose humbjes nga ky i investuar. Si rrjedhim, zbatimi i metodës së kapitalit neto siguron raportim më tepër informues mbi aktivet neto të investitorit dhe fitimin ose humbjen e tij.

12. Kur ekzistojnë të drejta votuese potenciale apo derivative të tjera që përmbajnë të drejta votuese potenciale, interesi i një njësie ekonomike në një pjesëmarrje ose një sipërmarrje të përbashkët përcaktohet vetëm në bazë të interesave të pronësisë ekzistuese dhe nuk pasqyron ushtrimin e mundshëm ose konvertimin e të drejtave votuese potenciale dhe të instrumenteve të tjera derivative, përveçse kur zbatohet paragrafi 13.

13. Në disa rrethana, një njësi ekonomike ka në thelb, një pronësi ekzistuese si rezultat i një transaksioni që aktualisht i jep të drejtën në kthimet e lidhura me një interes pronësie. Në rrethana të tilla, pjesa proporcionale që i caktohet njësisë ekonomike përcaktohet duke marrë parasysh ushtrimin eventual të këtyre të drejtave votuese potenciale dhe instrumentet e tjera derivative që aktualisht i japin të drejtën njësisë ekonomike në kthimet nga investimi.

14. SNRF 9 “Instrumentet financiare” nuk zbatohen në interesat në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta, të cilat kontabilizohen duke përdorur metodën e kapitalit neto. Nuk janë objekt i SNRF 9 ato instrumente që në thelb përmbajnë të drejta votuese potenciale, të cilat aktualisht japin të drejtë në kthimet e lidhura me një interes të pronësisë në një pjesëmarrje ose një sipërmarrje të përbashkët. Në të

gjitha rastet e tjera, instrumentet që përmbajnë të drejta votuese potenciale në një pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët trajtohen në përputhje me SNRF 9.

15. Përveç rastit kur një investim ose një pjesë e një investimi në një pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët është klasifikuar si i mbajtur për shitje në përputhje me SNRF 5 “Aktivet afatgjata të mbajtura për shitje dhe veprimtaritë e ndërprera”, investimi apo ndonjë interes i mbajtur në investim, që nuk klasifikohet si i mbajtur për shitje, duhet të klasifikohet si një aktiv afatgjatë.

Zbatimi i metodës së kapitalit neto

16. Një njësi ekonomike me kontroll të përbashkët ose influencë thelbësore mbi një të investuar do ta trajtojë investimin e tij në një pjesëmarrje ose një sipërmarrje të përbashkët duke përdorur metodën e kapitalit neto, me përjashtim të rastit kur ky investim kualifikohet për përjashtim në përputhje me paragrafët 17-19.

Përjashtimet nga zbatimi i metodës së kapitalit neto

17. Një njësi ekonomike nuk duhet të zbatojë metodën e kapitalit neto për investimin e saj në një pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët në qoftë se ajo është një shoqëri mëmë që është përjashtuar nga përgatitja e pasqyrave financiare të konsoliduara nëpërmjet përjashtimit nga objekti në paragrafin 4 (a) të SNRF 10 ose nëse zbatohen të gjitha sa më poshtë:

a) Njësia ekonomike është një filial i zotëruar plotësisht ose është filial i zotëruar pjesërisht nga një tjetër njësi ekonomike dhe pronarët e tjerë të saj, përfshirë edhe ata pa të drejtë vote, janë të informuar dhe nuk kanë kundërshtime për faktin që njësia ekonomike nuk zbaton metodën e kapitalit neto.

b) Instrumentet e borxhit ose të kapitalit neto të njësisë ekonomike nuk tregtohen në një treg publik (në bursën e vendit apo të huaj ose tregje jashtë bursave, duke përfshirë tregjet lokale dhe rajonale).

c) Njësia ekonomike nuk ka depozituar dhe as nuk është në procesin e depozitimit, të pasqyrave të saj financiare në një komision të letrave me vlerë ose organizëm tjetër rregullator, me qëllim emetimin e ndonjë klase të instrumenteve në një treg publik.

d) Shoqëria mëmë përfundimtare ose e ndërmjetme e njësisë ekonomike përgatit pasqyra të konsoliduara financiare të disponueshme për përdorim publik që janë në përputhje me SNRF-të.

18. Kur një investim në një pjesëmarrje ose një sipërmarrje të përbashkët është mbajtur nga ose mbahet në mënyrë të tërthortë nëpërmjet një njësie ekonomike që është një organizatë sipërmarrje kapitali ose një fond i përbashkët, njësi besimi dhe njësi ekonomike e ngjashme, përfshirë investimet e lidhura me fondet e sigurimeve, njësia ekonomike mund të zgjedhë të masë investimet në këto pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në përputhje me SNRF 9.

19. Kur njësia ekonomike ka një investim në një pjesëmarrje, një pjesë e të cilit është mbajtur në mënyrë të tërthortë përmes një organizate sipërmarrjeje kapitalesh ose një fondi të përbashkët, njësi besimi dhe njësive ekonomike të ngjashme, përfshirë investimet e lidhura me fondet e sigurimeve, njësia ekonomike mund të zgjedhë të masë këtë pjesë investimi në pjesëmarrje me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në përputhje me SNRF 9 pavarësisht nëse organizata e sipërmarrjes së kapitaleve, ose fondi i përbashkët, njësia e besimit dhe njësitë ekonomike të ngjashme, përfshirë investimet e lidhura me fondet e sigurimeve, kanë apo jo influencë thelbësore mbi këtë pjesë të investimeve. Nëse njësia ekonomike bën këtë zgjedhje, ajo do të zbatojë metodën e kapitalit neto të çdo pjesë e mbetur e investimit të saj në një pjesëmarrje, që nuk është mbajtur nëpërmjet një organizate kapitalesh ose një fondi të përbashkët, njësi besimi dhe njësive ekonomike të ngjashme, përfshirë investimet e lidhura me fondet e sigurimeve.

Klasifikimi i mbajtur për shitje

20. Një njësi ekonomike do të zbatojë SNRF 5 për një investim ose një pjesë të një investimi në një pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët që i plotëson kriteret për t’u klasifikuar si i mbajtur për shitje. Çdo pjesë e mbajtur e një investimi në një pjesëmarrje ose një sipërmarrje të përbashkët që nuk është klasifikuar si e mbajtur për shitje do të kontabilizohet duke përdorur metodën e kapitalit neto deri



sa ndodh nxjerrja jashtë përdorimit e pjesës, që është klasifikuar si e mbajtur për shitje. Pasi nxjerrja jashtë përdorimit të ketë ndodhur, një njësi ekonomike do të trajtojë çdo interes të mbajtur në pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët në përputhje me SNRF 9, përveç rastit kur interesi i mbajtur vazhdon të jetë një pjesëmarrje ose një sipërmarrje e përbashkët, rast në të cilin njësi ekonomike përdor metodën e kapitalit neto.

21. Kur një investim ose një pjesë e një investimi në një pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët, i klasifikuar më parë si i mbajtur për shitje, nuk i plotëson kriteret për t'u klasifikuar si i tillë, ai do të kontabilizohet duke përdorur metodën e kapitalit neto në mënyrë retrospektive, që nga data e klasifikimit të tij si i mbajtur për shitje. Pasqyrat financiare do të ndryshohen për periudhat që nga viti i klasifikimit si i mbajtur për shitje.

Ndërprerja e përdorimit të metodës së kapitalit neto

22. Një njësi ekonomike do të ndërpresë përdorimin e metodës së kapitalit neto nga data kur investimet e saj pushojnë së qeni një pjesëmarrje ose një sipërmarrje e përbashkët, si më poshtë:

a) Nëse investimi bëhet një filial, njësi ekonomike do ta kontabilizojë investimin e saj në përputhje me SNRF 3 "Kombinimet e biznesit" dhe SNRF 10.

b) Nëse interesi i mbajtur në një ish-pjesëmarrje ose ish-sipërmarrje të përbashkët është një aktiv financiar, njësi ekonomike do ta masë interesin e mbajtur me vlerën e drejtë. Vlera e drejtë e interesit të mbajtur do të konsiderohet si vlera e drejtë e tij në njohjen fillestare, si një aktiv financiar në përputhje me SNRF 9. Njësi ekonomike do të njohë në fitim ose humbje çdo diferencë në mes:

i) vlerës së drejtë të çdo interesi të mbajtur dhe çdo të ardhure nga nxjerrja e një pjese interesi në pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët; dhe

ii) vlerës kontabël të investimit në datën e ndërprerjes së metodës së kapitalit neto.

c) Kur njësi ekonomike ndërpret përdorimin e metodës së kapitalit neto, ajo do të kontabilizojë të gjitha shumatat e njohura më parë në të ardhura të tjera të përgjithshme në lidhje me këtë investim mbi të njëjtën bazë që do të ishte e nevojshme nëse i investuari do t'i kishte nxjerrë në mënyrë të drejtpërdrejtë aktivet ose pasivet e lidhura.

23. Prandaj, në qoftë se një fitim ose humbje e njohur më parë në të ardhura të tjera të përgjithshme nga i investuari do të riklasifikohet në fitim ose humbje nga shitja e aktiveve ose pasiveve të lidhura, njësi ekonomike riklasifikon fitimin ose humbjen neto nga kapitali në fitim ose humbje (si një rregullim riklasifikimi), kur metoda e kapitalit neto është ndërprerë. Për shembull, nëse një pjesëmarrje apo një sipërmarrje e përbashkët ka diferenca këmbimi kumulative në lidhje me një veprimtari të huaj dhe njësi ekonomike ndërpret përdorimin e metodës së kapitalit neto, ajo do ta riklasifikojë në fitim ose humbje fitim, ose humbje neto që më parë është njohur në të ardhura të tjera të përgjithshme në lidhje me veprimtarinë e huaj.

24. Nëse një investim në një pjesëmarrje bëhet një investim në një sipërmarrje të përbashkët ose një investim në një sipërmarrje të përbashkët bëhet një investim në një pjesëmarrje, njësi ekonomike vazhdon të zbatojë metodën e kapitalit neto dhe nuk e rimat interesin e ruajtur.

Ndryshimet në interesin e pronësisë

25. Nëse interesi i pronësisë i një njësie ekonomike në një pjesëmarrje ose një sipërmarrje të përbashkët është zvogëluar, por njësi ekonomike vazhdon të zbatojë metodën e kapitalit neto, ajo do ta riklasifikojë në fitim ose humbje përqindjen e fitimit ose humbjes neto, të njohur më parë në të ardhura të tjera të përgjithshme në lidhje me këtë ulje në interesin e pronësisë, në qoftë se fitimi ose humbja neto do të jetë e nevojshme të klasifikohet në fitim ose humbje nga shitja e aktiveve ose detyrimeve të lidhura.

Procedurat e metodës së kapitalit neto

26. Shumë prej procedurave që janë të përshtatshme për zbatimin e metodës së kapitalit neto janë të ngjashme me procedurat e konsolidimit të përshkruara në SNRF 10. Për më tepër, konceptet bazë në procedurat e përdorura në trajtimin kontabël të blerjes së një filiali janë adoptuar edhe në trajtimin kontabël të blerjes së një investimi në një pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët.

27. Pjesa e një grupi në një pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët është totali i zotërimeve në këtë pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët nga shoqëria mëmë dhe filialet e saj. Për këtë qëllim,

kontrollat në pjesëmarrjet ose sipërmarrjet e tjera të përbashkëta të grupit janë injoruar. Kur një pjesëmarrje ose një sipërmarrje e përbashkët ka filiale, pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkëta, fitimi ose humbja, të ardhurat e tjera të përgjithshme dhe aktivet neto të marra parasysh gjatë zbatimit të metodës së kapitalit neto janë ato të njohura në pasqyrat financiare të pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët (përfshirë edhe pjesën e fitimit ose humbjes së pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët, të ardhura të tjera të përgjithshme dhe aktive neto të pjesëmarrjeve dhe sipërmarrjeve të saj të përbashkëta), pas rregullimesh të nevojshme që japin efekt në politikat kontabël uniforme (shih paragrafët 35 dhe 36).

28. Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga transaksionet “e fillimit” dhe “fundore” midis një njësie ekonomike (përfshirë filialet e saj të konsoliduara) dhe pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së saj të përbashkët, njihen në pasqyrat financiare të njësisë ekonomike vetëm në masën e interesave të investitorëve të palidhur me pjesëmarrjen ose sipërmarrjen e përbashkët. Transaksionet “e fillimit” janë për shembull shitjet e aktiveve nga një pjesëmarrje ose një sipërmarrje e përbashkët tek investitori. Transaksionet “fundore” janë për shembull shitjet ose kontributet e aktiveve nga investitori te pjesëmarrja ose sipërmarrja e përbashkët e tij. Pjesa e investitorit në fitimet ose humbjet e pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët që rrjedhin nga këto transaksione është eliminuar.

29. Kur transaksionet fundore japin evidencë të një zvogëlimi në vlerën neto të realizueshme të aktiveve që do të shiten ose do të jepen, ose të një humbjeje nga zhvlerësimi të këtyre aktiveve, këto humbje do të njihen në mënyrë të plotë nga investitori. Kur transaksionet e fillimit japin një evidencë të një zvogëlimi në vlerën neto të realizueshme të aktiveve që do të blihen ose të një humbjeje nga zhvlerësimi të këtyre aktiveve, investitori do të njohë pjesën e vet në këto humbje.

30. Kontributi i një aktivi jomonetar në një pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët, në këmbim të një interesi të kapitalit neto në to do të kontabilizohet në përputhje me paragrafin 28, me përjashtim të rastit kur kontributi nuk ka përmbajtje tregtare, sikurse është përshkruar ky term në SNK 16 “Aktivet afatgjata materiale”. Nëse një kontribut i tillë nuk ka përmbajtje tregtare, fitimi ose humbja konsiderohet e përcaktuar, si dhe nuk njihet përveç kur zbatohet paragrafi 31. Të tilla fitime dhe humbje të përcaktuara do të eliminohen kundrejt investimeve të kontabilizuara duke përdorur metodën e kapitalit neto dhe nuk do të paraqiten si fitime ose humbje të shtyra në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar të njësisë ekonomike ose në pasqyrën e pozicionit financiar të njësisë ekonomike në të cilën investimet janë kontabilizuar duke përdorur metodën e kapitalit neto.

31. Nëse përveç marrjes së një interesi kapitali në një pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët, një njësi ekonomike merr shtesë edhe aktive monetare ose jomonetare, ajo njeh në mënyrë të plotë në fitim ose humbje pjesën e fitimit ose humbjes neto për kontributin jomonetar në lidhje me aktivet monetare ose jomonetare të marra.

32. Një investim llogaritet duke përdorur metodën e kapitalit neto, nga data në të cilën ai bëhet një pjesëmarrje ose sipërmarrje e përbashkët. Në blerjen e investimit, çdo ndryshim ndërmjet kostos së investimit dhe vlerës së drejtë neto të pjesës së njësisë ekonomike në aktivet dhe detyrimet e identifikueshme të të investuarit, trajtohet si më poshtë:

a) Emri i mirë në lidhje me një pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët përfshihet në vlerën kontabël të investimit. Amortizimi i emrit të mirë nuk lejohet.

b) Çdo tejkalim i vlerës së drejtë neto të pjesës së njësisë ekonomike në aktivet dhe detyrimet e identifikueshme të të investuarit ndaj kostos së investimit, përfshihet si e ardhur në përcaktimin e pjesës së njësisë ekonomike në fitimin ose humbjen e pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët gjatë periudhës në të cilën investimi është kryer.

Rregullimet e duhura në pjesën e njësisë ekonomike në fitimin ose humbjen e pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët pas blerjes, bëhen për shembull për amortizimin e aktiveve të amortizueshme bazuar në vlerat e tyre të drejta në datën e blerjes. Në mënyrë të ngjashme, rregullimet e duhura në pjesën e njësisë ekonomike në fitimin ose humbjen e pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët, pas blerjes, bëhen për mbulimin e humbjeve nga zhvlerësimi, të tilla si: për emrin e mirë, ose për aktivet afatgjata materiale.



33. Gjatë zbatimit të metodës së kapitalit neto njësia ekonomike përdor pasqyrat financiare më të fundit të pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët. Kur fundi i periudhës raportuese të njësisë ekonomike është i ndryshëm nga ai i pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët, këta të fundit përgatitin, për përdorim nga njësia ekonomike, pasqyra financiare me të njëjtën datë si pasqyrat financiare të njësisë ekonomike, përveç rastit kur është e pamundur të bëhet një gjë e tillë.

34. Kur në përputhje me paragrafin 33, pasqyrat financiare të një pjesëmarrjeje ose sipërmarrjeje të përbashkët të përdorura në zbatimin e metodës së kapitalit neto, janë përgatitur për një datë të ndryshme nga ajo e përdorur nga njësia ekonomike, atëherë do të bëhen rregullime për transaksione ose ngjarje të rëndësishme që ndodhin në mes të kësaj date dhe datës së pasqyrave financiare të njësisë ekonomike. Në çdo rast, diferenca midis fundit të periudhës raportuese të pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët dhe atij të njësisë ekonomike duhet të jetë jo më e madhe se tre muaj. Kohëzgjatja e periudhave raportuese dhe çdo ndryshim ndërmjet fundit të periudhave raportuese duhet të jetë të njëjtë nga periudha në periudhë.

35. Pasqyrat financiare të njësisë ekonomike do të përgatiten duke përdorur politika uniforme kontabël për transaksione, si dhe ngjarje në rrethana të ngjashme.

36. Nëse një pjesëmarrje ose sipërmarrje e përbashkët përdor politika kontabël të ndryshme nga ato të njësisë ekonomike për transaksione, si dhe ngjarje në rrethana të ngjashme, do të bëhen rregullime që politikat kontabël të pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët të jenë në përputhje me ato të njësisë ekonomike, kur pasqyrat financiare të pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët përdoren nga njësia ekonomike në zbatimin e metodës së kapitalit neto.

37. Nëse një pjesëmarrje ose sipërmarrje e përbashkët ka aksione preferenciale kumulative që mbahen nga palë të ndryshme nga njësia ekonomike dhe janë të klasifikuara si kapital neto, njësia ekonomike llogarit pjesën e saj të fitimit ose humbjes pasi rregullon dividendët mbi këto aksione, pavarësisht nëse ato janë deklaruar apo jo.

38. Nëse pjesa e humbjeve të një njësie ekonomike nga një pjesëmarrje ose sipërmarrje e përbashkët është e barabartë ose e tejkalon interesin e saj në pjesëmarrje ose sipërmarrjen e përbashkët, njësia ekonomike ndërpret njohjen e pjesës së saj në humbjet e mëtejshme. Interesi në një pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët është vlera kontabël e investimeve në to e përcaktuar duke përdorur metodën e kapitalit neto, së bashku me ndonjë interes afatgjatë që, në thelb është pjesë e investimit neto të njësisë ekonomike në pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët. Për shembull një zë, për të cilin shlyerja nuk është planifikuar dhe as ka të ngjarë të ndodhë në të ardhmen e afërt, është në thelb një shtrirje e investimeve të njësisë ekonomike në atë pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët. Këta zëra mund të përfshijnë aksionet preferenciale, llogaritë e arkëtueshme afatgjata ose kreditë afatgjata, por nuk përfshijnë llogaritë e arkëtueshme tregtare, llogaritë e pagueshme tregtare ose ndonjë llogari të arkëtueshme afatgjatë, për të cilat ekziston kolaterali i duhur, i tillë si kreditë e siguruar. Humbjet e njohura, duke përdorur metodën e kapitalit neto, përtej investimit të njësisë ekonomike në aksione të zakonshme shpërndahen në përbërësit e tjerë të interesit të njësisë ekonomike në një pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët në renditje të kundërt me shkallën e vjetërsisë së tyre (p.sh. përparësia në likuidim).

39. Pasi interesi i njësisë ekonomike është ulur në zero, merren masa për humbjet shtesë, dhe njihet një detyrim, vetëm në masën që njësia ekonomike ka shkaktuar detyrime ligjore ose konstruktive ose ka bërë pagesa në emër të pjesëmarrjes ose sipërmarrjes, së përbashkët. Nëse pjesëmarrja, ose sipërmarrja e përbashkët më pas raporton fitime, njësia ekonomike rifillon njohjen e pjesës së saj në këto fitime vetëm pasi pjesa e vet në to është e barabartë me pjesën e humbjeve që nuk janë njohur.

Humbjet nga zhvlerësimi

40. Pas zbatimit të metodës së kapitalit neto, përfshirë edhe njohjen e humbjeve të pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët, në pajtim me paragrafin 38, njësia ekonomike zbaton SNK 39 "Instrumentet financiare": Njohja dhe matja për të caktuar nëse është e nevojshme të njihet ndonjë humbje shtesë nga zhvlerësimi në lidhje me investimin e saj neto në pjesëmarrjen ose sipërmarrjen e përbashkët.

41. Gjithashtu, njësia ekonomike zbaton SNK 39, për të përcaktuar nëse ndonjë humbje shtesë nga zhvlerësimi është njohur në lidhje me interesin e saj në pjesëmarrjen ose sipërmarrjen e përbashkët që nuk është pjesë e investimit neto dhe e kësaj humbjeje nga zhvlerësimi.

42. Meqë emri i mirë, që është pjesë e vlerës kontabël të një investimi në një pjesëmarrje ose një sipërmarrje të përbashkët, nuk njihet veçmas, ai nuk testohet veçmas për zhvlerësim sipas kërkesave për testimin e zhvlerësimit të emrit të mirë në SNK 36 “Zhvlerësimi i aktiveve”. Në vend të kësaj, e tërë vlera kontabël e investimit testohet për zhvlerësim në përputhje me SNK 36, si një aktiv i vetëm, duke krahasuar shumën e tij të rikuperueshme (më e larta e vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot për shitje) me vlerën e tij kontabël, sa herë që zbatimi i SNK 39 tregon se investimi mund të jetë zhvlerësuar. Një humbje nga zhvlerësimi, e njohur në këto rrethana, nuk i shpërndahet ndonjë aktiv, përfshirë edhe emrin e mirë, që përbën një pjesë të vlerës kontabël të investimit në pjesëmarrje ose sipërmarrjen e përbashkët. Prandaj, çdo anulim i kësaj humbjeje nga zhvlerësimi njihet në përputhje me SNK 36, në masën që shumën e rikuperueshme e investimit rritet më pas. Në përcaktimin e vlerës në përdorim të investimit, një njësi ekonomike vlerëson:

a) pjesën e vet të vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të vlerësuara që pritet të gjenerohet nga pjesëmarrja ose sipërmarrja e përbashkët, duke përfshirë flukset e mjeteve monetare nga veprimtaritë e pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët dhe të ardhurat nga shitja përfundimtare e investimit; ose

b) vlerën aktuale të flukseve monetare të ardhshme të vlerësuara që pritet të rrjedhin nga dividendët që do të merren nga investimi dhe nga shitja e tij përfundimtare.

Duke përdorur supozimet e duhura, të dyja metodat japin të njëjtin rezultat.

43 . Shuma e rikuperueshme e një investimi në një pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët do të vlerësohet për çdo pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët, përveç rastit kur pjesëmarrja ose sipërmarrja e përbashkët nuk gjeneron flukse hyrëse monetare nga përdorimi i vazhdueshëm që janë kryesisht të pavarura nga ato të aktiveve të tjera të njësisë ekonomike.

Pasqyrat financiare individuale

44. Një investim në një pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët do të kontabilizohet në pasqyrat financiare të njësisë ekonomike në përputhje me paragrafin 10 të SNK 27 (i ndryshuar në vitin 2011).

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha transitore

45. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këtë Standard për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2013 e në vijim. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë Standard për një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt dhe në të njëjtën kohë zbaton SNRF 10, SNRF 11 “Marrëveshjet e përbashkëta”, SNRF 12 “Dhënia e informacionit shpjegues për interesat në njësitë e tjera ekonomike” dhe SNK 27 (i ndryshuar në 2011).

Referencat në SNRF 9

46. Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë Standard, por ende nuk zbaton SNRF 9, çdo referencë për SNRF 9 do të lexohet si një referencë për SNK 39.

Tërheqja e SNK 28 (2003)

47. Ky Standard zëvendëson SNK 28 Investime në pjesëmarrje (i rishikuar në 2003).

STANDARDI NDËRKOMBËTAR I RAPORTIMIT FINANCIAR 9 INSTRUMENTET FINANCIARE

Kapitulli 1. Objektivi

1.1. Objektivi i këtij SNRF-je është të caktojë parimet për raportimin financiar të aktiveve financiare dhe pasiveve financiare, që do të paraqesë një informacion të rëndësishëm dhe të dobishëm për përdoruesit e pasqyrave financiare, në vlerësimin e tyre të shumave, afatit dhe pasigurisë së flukseve monetare të ardhshme të një njësie ekonomike.



Kapitulli 2. Qëllimi

2.1 Një njësi ekonomike duhet të zbatohet këtë SNRF për të gjithë zërat që janë objekt i SNK 39 “Instrumentet financiare: Njohja dhe matja”.

Kapitulli 3. Njohja dhe çregjistrimi

3.1 Njohja fillestare

3.1.1 Një njësi ekonomike do të njohë një aktiv financiar ose një pasiv financiar në pasqyrën e saj të pozicionit financiar, atëherë dhe vetëm atëherë, kur njësia ekonomike bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit (shih paragrafët B3.1.1 dhe B3.1.2). Kur një njësi ekonomike njeh për herë të parë një aktiv financiar, ajo do ta klasifikojë atë në përputhje me paragrafët 4.1.1-4.1.5 dhe do ta masë atë në përputhje me paragrafët 5.1.1 dhe 5.1.2. Kur një njësi ekonomike njeh për herë të parë një pasiv financiar, ajo do ta klasifikojë atë në përputhje me paragrafët 4.2.1 dhe 4.2.2 dhe do ta masë atë në përputhje me paragrafin 5.1.1.

Blerje ose shitje e aktiveve financiare sipas mënyrës së rregullt

3.1.2 Një blerje ose shitje në mënyrë të rregullt e aktiveve financiare do të njihet dhe çregjistrohet, sipas rastit, duke bërë kontabilizimin në datën e tregtimit ose në datën e shlyerjes (shih paragrafët B3.1.3-B3.1.6) 3.2 .

3.2 Çregjistrimi i aktiveve financiare

3.2.1 Në pasqyrat financiare të konsoliduara, paragrafët 3.2.2-3.2.9, B3.1.1, B3.1.2 dhe B3.2.1-B3.2.17 zbatohen në një nivel të konsoliduar. Kështu, në radhë të parë një njësi ekonomike konsolidon të gjitha filialet në përputhje me SNK 27 “Pasqyrat financiare të konsoliduara dhe individuale” dhe KIS-12 “Konsolidimi - njësitë ekonomike për qëllime të veçanta” dhe më pas në grupin që krijohet zbatohen paragrafët 3.2.2-3.2.9, B3.1.1, B3.1.2 dhe B3.2.1 -B3.2.17.

3.2.2 Para se të vlerësojë nëse, dhe deri në çfarë mase çregjistrimi duhet të bëhet sipas paragrafëve 3.2.3-3.2.9, një njësi ekonomike përcakton nëse këta paragrafë duhet të zbatohen për një pjesë të një aktivi financiar (ose një pjesë të një grupi aktivesh financiare të ngjashme) ose për një aktiv financiar (ose një grup aktivesh financiare të ngjashme) në tërësinë e tij, si më poshtë.

a) Paragrafët 3.2.3-3.2.9 zbatohen për një pjesë të një aktivi financiar (ose një pjesë të një grupi aktivesh financiare të ngjashme), nëse dhe vetëm nëse, pjesa që konsiderohet për çregjistrim plotëson një nga këto tri kushtet:

i) Pjesa përbëhet vetëm nga flukse mjetesh monetare të identifikuar në mënyrë specifike prej një aktivi financiar (ose një grup aktivesh financiare të ngjashme). Për shembull, kur një njësi ekonomike hyn në një marrëveshje për një interval të normës së interesit me anën e së cilës pala tjetër fiton të drejtën për flukset monetare të interesit, por jo për flukset monetare të principalit nga një instrument borxhi, zbatohen paragrafët 3.2.3-3.2.9 për këto flukse monetare nga interesi.

ii) Pjesa përbën vetëm një pjesë plotësisht proporcionale (*pro rata*) të flukseve monetare nga një aktiv financiar (ose një grup aktivesh financiare të ngjashme). Për shembull, kur një njësi ekonomike hyn në një marrëveshje ku pala tjetër përfiton të drejtën e 90 për qind të të gjitha flukseve monetare të një instrumenti borxhi, zbatohen paragrafët 3.2.3-3.2.9 për 90 për qind të këtyre flukseve monetare. Nëse ka më shumë se një palë, secila prej tyre nuk është e nevojshme që të ketë një pjesë proporcionale mjetesh monetare, me kusht që njësia ekonomike transferuese ka një pjesë plotësisht proporcionale.

iii) Pjesa përbën vetëm një pjesë plotësisht proporcionale (*pro rata*) të flukseve monetare të identifikuar në mënyrë specifike nga një aktiv financiar (ose një grup aktivesh financiare të ngjashme). Për shembull, kur një njësi ekonomike hyn në një marrëveshje ku pala tjetër përfiton të drejtën e një pjese 90 për qind të flukseve monetare të interesit nga një aktiv financiar, zbatohen paragrafët 3.2.3-3.2.9 për 90 për qind të këtyre flukseve monetare. Nëse ka më shumë se një palë, secila prej tyre nuk është e nevojshme që të ketë një pjesë proporcionale të mjeteve monetare të identifikuar në mënyrë specifike, me kusht që njësia ekonomike transferuese ka një pjesë plotësisht proporcionale.

b) Në të gjitha rastet e tjera, paragrafët 3.2.3-3.2.9 zbatohen për aktivin financiar në tërësinë e tij (ose për grupin e aktiveve financiare të ngjashme në tërësinë e tyre). Për shembull, kur një njësi ekonomike transferon: i) të drejtat për 90 përqindëshin e parë ose të fundit të arkëtimeve në mjete

monetare nga një aktiv financiar (ose një grup aktivesh financiare); ose ii) të drejtat për 90 për qind të flukseve monetare nga një grup llogarish të arkëtueshme, por ofron një garanci për të kompensuar blerësit për çdo humbje kredie deri në 8 për qind të shumës së principalit të llogarive të arkëtueshme, zbatohen paragrafët 3.2.3-3.2.9 për aktivin financiar (ose një grup aktivesh financiare të ngjashme) në tërësinë e tij.

Në paragrafët 3.2.3-3.2.12, termi “aktiv financiar” i referohet si një pjesë të një aktivi financiar (ose një pjesë të një grupi aktivesh financiare të ngjashme) të identifikuar si në pikën (a) më sipër, ashtu edhe një aktiv financiar (ose një grupi aktivesh financiare të ngjashme) në tërësinë e tij.

3.2.3 Një njësi ekonomike do të çregjistrojë një aktiv financiar, kur dhe vetëm kur:

a) përfundojnë të drejtat kontraktuale për flukset monetare nga aktivi financiar; ose

b) transferon aktivin financiar siç është parashtruar në paragrafët 3.2.4 dhe 3.2.5 dhe transferimi kualifikohet për çregjistrim në përputhje me paragrafin 3.2.6.

(Shih paragrafin 3.1.2 për shitje në mënyrë të rregullt të aktiveve financiare.)

3.2.4 Një njësi ekonomike transferon një aktiv financiar, nëse dhe vetëm nëse, ose:

a) transferon të drejtat kontraktuale për të marrë flukset monetare të aktivit financiar; ose

b) ruan të drejtat kontraktuale për të marrë flukset monetare të aktivit financiar, por merr përsipër një detyrim kontraktual t’u paguajë flukset monetare një ose më shumë marrësve në një marrëveshje që plotëson kushtet në paragrafin 3.2.5.

3.2.5 Kur një njësi ekonomike ruan të drejtat kontraktuale për të marrë flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar (aktivi fillestar), por merr përsipër një detyrim kontraktual për t’ua paguar këto flukse të mjeteve monetare një ose më shumë njësive ekonomike (përfituesve eventualë), njësia ekonomike e trajton transaksionin si një transferim të një aktivi financiar, nëse dhe vetëm nëse, plotësohen njëkohësisht tri kushtet e mëposhtme.

a) Njësia ekonomike nuk ka detyrimin t’ua paguajë shumat përfituesve eventualë, nëse nuk mbledh shumat ekuivalente nga aktivi fillestar. Paradhëniet afatshkurtra nga njësia ekonomike, me të drejtën e mbulimit të plotë të shumës së dhënë hua plus interesin e konstatuar sipas normave të tregut nuk e shkelin këtë kusht.

b) Njësia ekonomike nuk lejohet, nga kushtet e kontratës së transferimit, ta shesë ose vërë si kolateral aktivin fillestar, përveçse kur e përdor si garanci për përfituesit eventualë për detyrimin që t’u paguajë flukse monetare.

c) Njësia ekonomike ka detyrimin të dërgojë çfarëdo fluksi monetar që mbledh në emër të përfituesve të rastit pa vonesë të ndjeshme. Përveç kësaj, njësia ekonomike nuk ka të drejtë të riinvestojë flukse të tilla monetare, me përjashtim të investimeve në mjete monetare ose ekuivalente të saj (siç përcaktohet në SNK 7 “Pasqyra e flukseve monetare”) gjatë periudhës afatshkurtër të shlyerjes nga data e arkëtimit në datën e dërgimit të kërkuar prej përfituesve të rastit, dhe interesi i fituar në investime të tilla u kalohet këtyre përfituesve.

3.2.6 Kur një njësi ekonomike transferon një aktiv financiar (shih paragrafin 3.2.4), ajo do të vlerësojë masën në të cilën ruan rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit financiar. Në këtë rast:

a) nëse njësia ekonomike transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit financiar, ajo do ta çregjistrojë aktivin financiar dhe do të njohë veç e veç si aktive ose pasive çdo të drejtë dhe detyrim të krijuar ose të mbajtur gjatë transferimit.

b) nëse njësia ekonomike mban thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit financiar, ajo do të vazhdojë ta njohë aktivin financiar.

c) nëse njësia ekonomike as nuk transferon, as nuk mban thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit financiar, ajo duhet të përcaktojë nëse ka ruajtur kontrollin e aktivit financiar. Në këtë rast:

i) në qoftë se njësia ekonomike nuk ka ruajtur kontrollin, ajo do ta çregjistrojë aktivin financiar dhe do të njohë veç e veç, si aktiv ose pasiv, çdo të drejtë dhe detyrim të krijuar ose mbajtur gjatë transferimit.



ii) nëse njësia ekonomike e ka ruajtur kontrollin, ajo do të vazhdojë ta njohë aktivin financiar në masën e përfshirjes së vazhdueshme në të (shih paragrafin 3.2.16).

3.2.7 Transferimi i rreziqeve dhe i përfitimeve (shih paragrafin 3.2.6), vlerësohet duke krahasuar ekspozimin e njësisë ekonomike, para dhe pas transferimit, me ndryshueshmërinë në shumat dhe afatin e flukseve monetare neto të aktivit të transferuar. Një njësi ekonomike ka mbajtur thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së një aktivi financiar në qoftë se ekspozimi ndaj ndryshueshmërisë në vlerën aktuale të flukseve monetare të ardhshme neto nga aktivi financiar nuk ka ndryshuar dukshëm, si rezultat i transferimit (p.sh. për shkak se njësia ekonomike ka shitur një aktiv financiar që është subjekt i një marrëveshjeje për ta riblerë atë me një çmim të fiksuar ose me çmimin e shitjes plus kthimin e një huadhënësi). Një njësi ekonomike ka transferuar kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së një aktivi financiar në qoftë se ekspozimi ndaj kësaj ndryshueshmërie nuk është më e rëndësishme në lidhje me ndryshueshmërinë e përgjithshme në vlerën aktuale të flukseve monetare të ardhshme neto të lidhura me aktivin financiar (për shembull për shkak se njësia ekonomike ka shitur një aktiv financiar që është subjekt vetëm i një opsioni për ta riblerë atë me vlerën e tij të drejtë në kohën e riblerjes apo ka transferuar një pjesë plotësisht proporcionale të flukseve monetare nga një aktiv financiar më i madh në një marrëveshje, siç është një nënpjesëmarrje në hua, që plotëson kushtet e paragrafit 3.2.5).

3.2.8 Shpesh është e dukshme nëse njësia ekonomike ka transferuar ose ka mbajtur thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe nuk është nevoja të bëhet ndonjë llogaritje. Në raste të tjera, është e nevojshme të llogaritet dhe të krahasohet ekspozimi i njësisë ekonomike ndaj ndryshueshmërisë në vlerën aktuale të flukseve monetare të ardhshme neto para dhe pas transferimit. Llogaritja dhe krahasimi bëhen duke përdorur si normë skontimi një normë interesi aktuale të përshtatshme tregu. Të gjitha ndryshueshmëritë e mundshme të arsyeshme në flukset monetare neto merren parasysh, duke iu dhënë më tepër peshë atyre rezultateve që kanë më shumë gjasa të ndodhin.

3.2.9 Nëse njësia ekonomike e ka ruajtur kontrollin (shih paragrafin 3.2.6 (c)) e aktivit të transferuar, shitja e aktivit varet nga aftësia e atij që e ka marrë. Njësia ekonomike nuk ruan kontrollin, nëse marrësi ka aftësinë praktike t'ia shesë aktivin në tërësinë e tij një pale të tretë të palidhur dhe është në gjendje ta ushtrojë këtë aftësi në mënyrë të njëanshme dhe pa qenë nevoja të vërë kufizime të tjera për transferimin. Në të gjitha rastet e tjera, njësia ekonomike ruan kontrollin.

Transferimet që kualifikohen për çregjistrim

3.2.10 Nëse një njësi ekonomike transferon një aktiv financiar në një transferim që kualifikohet për çregjistrim në tërësinë e tij dhe e mban të drejtën për shërbimin ndaj aktivit financiar kundrejt një tarife, ajo do të njohë ose një aktiv shërbimi, ose një pasiv shërbimi për këtë kontratë shërbimi. Në qoftë se tarifa që do të merret nuk pritet ta kompensojë njësinë ekonomike në mënyrën të mjaftueshme për kryerjen e shërbimit, do të njihet një pasiv shërbimi me vlerën e drejtë për detyrimin e shërbimit. Në qoftë se tarifa që do të merret pritet të jetë më shumë se një kompensim i mjaftueshëm për shërbimin, do të njihet një aktiv shërbimi për të drejtën e shërbimit me shumën e përcaktuar në bazë të një shpërndarje, të vlerës kontabël neto të aktivit financiar më të madh në përputhje me paragrafin 3.2.13.

3.2.11 Nëse si rezultat i një transferimi, një aktiv financiar çregjistrohet në tërësinë e tij, por transferimi bën që njësia ekonomike të marrë një aktiv financiar të ri ose të marrë përsipër një detyrim financiar të ri, ose një pasiv shërbimi, njësia ekonomike do të njohë një aktiv financiar të ri, pasiv financiar të ri ose pasiv shërbimi të ri me vlerën e drejtë.

3.2.12 Në çregjistrimin e një aktivi financiar në tërësinë e tij, diferenca midis:

a) vlerës kontabël neto (e matur në datën e çregjistrimit); dhe

b) shumës së marrë (duke përfshirë çdo aktiv të ri të përfutur pakësuar me çdo detyrim të ri të pranuar);

do të njihet në fitim ose humbje.

3.2.13 Në qoftë se aktivi i transferuar është pjesë e një aktivi financiar më të madh (p.sh. kur një njësi ekonomike transferon flukset monetare të interesit që janë pjesë e një instrumenti borxhi, shih paragrafin 3.2.2 (a)) dhe pjesa e transferuar kualifikohet për çregjistrim në tërësinë e saj, vlera kontabël

neto e mëparshme e aktivitet financiar më të madh do të ndahet midis pjesës që vazhdon të njihet dhe pjesës që çregjistrohet, mbi bazën e vlerave të drejta përkatëse të këtyre pjesëve në datën e transferimit. Për këtë qëllim, një aktiv shërbimi i mbajtur do të trajtohet si një pjesë që vazhdon të jetë e njohur. Diferenca midis:

a) vlerës kontabël neto (e matur në datën e çregjistrimit) të shpërndarë në pjesën e çregjistruar; dhe

b) shumës së marrë për pjesën e çregjistruar (përfshirë çdo aktiv të ri të përftuar, të pakësuar me çdo pasiv të ri të pranuar);

do të njihet në fitim ose humbje.

3.2.14 Kur një njësi ekonomike shpërndan vlerën kontabël neto të mëparshme të një aktivi financiar më të madh midis pjesës që vazhdon të njihet dhe pjesës që është çregjistruar, është e nevojshme të përcaktohet vlera e drejtë e pjesës që vazhdon të njihet. Kur njësi ekonomike ka një histori të shitjes së pjesëve të ngjashme me pjesën që vazhdon të njihet apo ekzistojnë transaksione tregu të tjera për pjesë të tilla, çmimet më të fundit të transaksioneve aktuale japin vlerësimin më të mirë të vlerës së drejtë të kësaj pjese. Kur nuk ka kuota çmimesh apo transaksione tregu të kohëve të fundit për të mbështetur vlerën e drejtë të pjesës që vazhdon të njihet, vlerësimi më i mirë i vlerës së drejtë është diferenca midis vlerës së drejtë të aktivitet financiar më të madh në tërësi dhe shumës së arkëtuar nga marrësi për pjesën që nuk njihet.

Transferimet që nuk kualifikohen për çregjistrim

3.2.15 Njësi ekonomike do të vazhdojë të njohë aktivin e transferuar në tërësinë e tij dhe do të njohë një detyrim financiar për shumën e arkëtuar, nëse një transferim nuk çon në çregjistrim, sepse njësi ekonomike ka ruajtur kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivitet të transferuar. Në periudhat e mëvonshme, njësi ekonomike do të njohë çdo të ardhur nga aktivi i transferuar dhe çdo shpenzim të kryer për detyrimin financiar.

Përfshirja e vazhdueshme në aktivitet e transferuara

3.2.16 Nëse një njësi ekonomike as nuk transferon, as nuk mban thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të një aktivi të transferuar, dhe ruan kontrollin e aktivitet të transferuar, ajo vazhdon të njohë aktivin e transferuar në masën e përfshirjes së vazhdueshme. Masa e përfshirjes së vazhdueshme në aktivin e transferuar është shkalla në të cilën njësi ekonomike është e ekspozuar ndaj ndryshimeve në vlerën e aktivitet të transferuar. Për shembull:

a) Kur përfshirja e vazhdueshme e njësisë ekonomike merr formën e garantimit të aktivitet të transferuar, masa e përfshirjes së vazhdueshme të njësisë ekonomike është më e ulëta e: i) shumës së aktivitet; dhe ii) shumës maksimale të shumës së arkëtuar që njësi ekonomike mund të jetë e detyruar të paguajë (shuma e garancisë).

b) Kur përfshirja e vazhdueshme e njësisë ekonomike merr formën e një opsioni të shkruar ose të blerë (ose të dyja) të aktivitet të transferuar, masa e përfshirjes së vazhdueshme e njësisë ekonomike është shuma e aktivitet të transferuar që njësi ekonomike mund ta riblejë. Megjithatë, në rastin e një opsioni të shkruar për një aktiv që matet me vlerën e drejtë, masa e përfshirjes së vazhdueshme e njësisë ekonomike është e kufizuar në më të ulëtën e vlerës së drejtë të aktivitet të transferuar dhe çmimit të ushtrimit të opsionit (shih paragrafin B3.2.13).

c) Kur përfshirja e vazhdueshme merr formën e një opsioni të shlyer në mjete monetare ose të një kushti të ngjashëm mbi aktivin e transferuar, masa e përfshirjes së vazhdueshme e njësisë ekonomike matet në të njëjtën mënyrë si ajo që rezulton nga opsioni i shlyer në mjete jomonetare sikurse është parashtruar në pikën (b) më sipër.

3.2.17 Kur një njësi ekonomike vazhdon të njohë një aktiv në masën e përfshirjes së vazhdueshme, ajo nje gjithashtu një pasiv të lidhur. Pavarësisht nga kërkesat e tjera për matjen në këtë SNRF, aktivi i transferuar dhe pasivi i lidhur maten mbi një bazë që pasqyron të drejtat dhe detyrimet që njësi ekonomike ka ruajtur. Pasivi i lidhur matet në mënyrë të tillë që vlera kontabël neto e aktivitet të transferuar dhe e tij është:



a) kostoja e amortizuar e të drejtave dhe detyrimeve që ka njësi ekonomike, nëse aktivi i transferuar matet me koston e amortizuar; ose

b) e barabartë me vlerën e drejtë të të drejtave dhe detyrimeve që ka mbajtur njësi ekonomike duke i matur mbi një bazë të veçuar, në qoftë se aktivi i transferuar matet me vlerën e drejtë.

3.2.18 Njësia ekonomike do të vazhdojë të njohë çdo të ardhur të realizuar nga aktivi i transferuar në masën e përfshirjes së vazhdueshme dhe do të njohë çdo shpenzim të kryer për pasivin e lidhur.

3.2.19 Për qëllimin e matjes së mëpasshme, ndryshimet e njohura në vlerën e drejtë të aktivitetit të transferuar dhe pasivit të lidhur trajtohen kontabilisht vazhdimisht me njëri-tjetrin në përputhje me paragrafin 5.7.1, dhe nuk do të kompensohen.

3.2.20 Në qoftë se përfshirja e vazhdueshme e një njësie ekonomike është vetëm në një pjesë të një aktivi financiar (p.sh. kur një njësi ekonomike ka një opsion për të riblerë pjesë të një aktivi të transferuar, apo ka një interes të mbetur që nuk çon në mbajtjen thelbësore të të gjitha rreziqeve dhe përfitimeve të pronësisë dhe ajo ruan kontrollin), njësi ekonomike shpërndan vlerën kontabël neto të mëparshme të aktivitetit financiar midis pjesës që vazhdon ta njohë sipas përfshirjes së vazhdueshme dhe pjesës që nuk e njeh më, mbi bazën e vlerave të drejta përkatëse të këtyre pjesëve në datën e transferimit. Për këtë qëllim, zbatohen kërkesat e paragrafit 3.2.14. Diferenca midis:

a) vlerës kontabël neto (e matur në datën e çregjistrimit) që i është caktuar pjesës që nuk njihet më; dhe

b) shumës së arkëtuar për këtë pjesë;
do të njihet në fitim ose humbje.

3.2.21 Në qoftë se aktivi i transferuar matet me koston e amortizuar, opsioni në këtë SNRF për të përcaktuar një pasiv financiar me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes nuk është i zbatueshëm për pasivin e lidhur.

Të gjitha transferimet

3.2.22 Nëse një aktiv i transferuar vazhdon të njihet, aktivi dhe pasivi i lidhur nuk do të kompensohen. Në mënyrë të ngjashme, njësi ekonomike nuk do të kompensojë çdo të ardhur të realizuar nga aktivi i transferuar me çdo shpenzim të kryer për pasivin e lidhur (shih SNK 32 “Instrumentet financiare: Paraqitja”, paragrafi 42).

3.2.23 Nëse një transferues vendos kolateral jomonetar (të tillë si: instrumente borxhi ose kapitali) për të transferuarin (marrësin), kontabiliteti për kolateralin nga transferuesi dhe i transferuari varet nëse i transferuari ka të drejtën për ta shitur ose rivendosur si kolateral dhe nëse transferuesi nuk i ka plotësuar detyrimet. Transferuesi dhe i transferuari do ta trajtojnë kolateralin, si më poshtë:

a) Në qoftë se i transferuari ka të drejtën sipas kontratës ose të traditës (praktikës) për ta shitur ose rivendosur si kolateral, atëherë transferuesi do ta riklasifikojë këtë aktiv në pasqyrën e tij të pozicionit financiar (p.sh. si një aktiv të huazuar, instrument kapitali të vendosur si garanci ose llogari të arkëtueshme të riblerjes) veçmas nga aktivet e tjera.

b) Nëse i transferuari shet kolateralin e vendosur për të, ai do të njohë të ardhura nga shitja dhe një pasiv të matur me vlerën e drejtë për detyrimin e tij për ta kthyer kolateralin.

c) Nëse transferuesi nuk u përmbahet kushteve të kontratës dhe nuk ka më të drejtën ta mbajë kolateralin, ai do ta çregjistrojë atë, ndërsa i transferuari duhet ta njohë kolateralin si aktivin e tij të matur fillimisht me vlerën e drejtë ose, në qoftë se ai tashmë e ka shitur, çregjistron detyrimin e tij për kthimin e kolateralit.

d) Përveç rasteve të parashikuara në pikën (c), transferuesi do të vazhdojë ta mbajë kolateralin si aktivin e tij dhe i transferuari nuk do ta njohë atë si një aktiv.

3.3 Çregjistrimi i pasiveve financiare

3.3.1 Një njësi ekonomike do të heqë një pasiv financiar (ose një pjesë të një pasivi financiar) nga pasqyra e tij e pozicionit financiar, atëherë dhe vetëm atëherë, kur ai është likuiduar, – d.m.th. kur detyrimi i përcaktuar në kontratë është paguar apo anuluar, apo ka skaduar.

3.3.2 Një shkëmbim në mes të një huamarrësi ekzistues dhe huadhënësi të instrumenteve të borxhit, me kushte në thelb të ndryshme, duhet të trajtohet si një shlyerje e pasivit financiar fillestar dhe të njihet një pasiv financiar i ri. Në mënyrë të ngjashme, një modifikim thelbësor i kushteve të një pasivi financiar ekzistues ose i një pjese të tij (qoftë i lidhur ose jo drejtpërdrejt me vështirësinë financiare të debitorit) do të kontabilizohet si një shlyerje e pasivit financiar origjinal dhe do të njihet një pasiv financiar ri.

3.3.3 Diferenca midis vlerës kontabël neto të një pasivi financiar (ose pjese të një pasivi financiar) të likuiduar ose të transferuar në një palë tjetër dhe shumës së paguar, duke përfshirë të gjitha aktivet jomonetare të transferuara ose detyrimet e marra përsipër, do të njihet në fitim ose humbje.

3.3.4 Nëse një njësi ekonomike riblen një pjesë të një pasivi financiar, ajo do ta shpërndajë vlerën kontabël neto të mëparshme të pasivit financiar midis pjesës që vazhdon të njihet dhe pjesës që është çregjistruar në bazë të vlerave të drejta përkatëse të këtyre pjesëve në datën e riblerjes. Diferenca midis: a) vlerës kontabël neto të caktuar për pjesën që njihet; dhe b) shumës së paguar, duke përfshirë të gjitha aktivet jomonetare të transferuara ose detyrimet e marra përsipër për pjesën që njihet, do të njihet në fitim ose humbje.

Kapitulli 4. Klasifikimi

4.1 Klasifikimi i aktiveve financiare

4.1.1 Përveç rasteve kur zbatohet paragrafi 4.1.5, një njësi ekonomike duhet t'i klasifikojë aktivet financiare si të matura ose me koston e amortizuar, ose me vlerën e drejtë, duke u mbështetur në:

- a) modelin e biznesit të njësisë ekonomike për menaxhimin e aktiveve financiare; dhe
- b) karakteristikat e flukseve monetare kontraktuale të aktivitetit financiar.

4.1.2 Një aktiv financiar do të matet me koston e amortizuar nëse plotësohen të dyja kushtet e mëposhtme:

a) Aktivi mbahet sipas modelit të biznesit, objektivi i të cilit është mbajtja e aktiveve me qëllim arkëtimin e flukseve monetare kontraktuale.

b) Kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar shkaktojnë në datat e specifikuara flukse monetare, të cilat janë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit për shumën e papaguar të principalit.

Paragrafët B4.1.1–B4.1.26 japin udhëzime sesi duhet të zbatohen këto kushte.

4.1.3 Për qëllim të zbatimit të paragrafit 4.1.2 (b), interesi merret në konsideratë për vlerën kohore të parasë dhe për rrezikun e kredisë që lidhet me shumën e principalit të papaguar gjatë një periudhe kohore të caktuar.

4.1.4 Një aktiv financiar do të matet me vlerën e drejtë, nëse nuk është matur me koston e amortizuar në përputhje me paragrafin 4.1.2.

Opsioni për të caktuar një aktiv financiar me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes

4.1.5 Pavarësisht nga paragrafët 4.1.1-4.1.4, një njësi ekonomike në njohjen fillestare, mund të caktojë në mënyrë të pakthyeshme një aktiv financiar të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes nëse duke bërë kështu eliminon apo redukton ndjeshëm një mospërputhje në matje ose njohje (nganjëherë referuar si një “mospërputhje kontabël”), që ndryshe do të shkaktohej nga matja mbi baza të ndryshme të aktiveve ose pasiveve apo njohjes së fitimeve dhe humbjeve nga to (shih paragrafët B4.1.29-B4.1.32).

4.1.6 SNRF 7 “Instrumentet financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese “kërkon që njësi ekonomike të japë informacione shpjeguese për aktivet financiare që i ka përcaktuar si aktive financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

4.2 Klasifikimi i pasiveve financiare

4.2.1 Një njësi ekonomike duhet të klasifikojë të gjitha pasivet financiare si të matura më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, me përjashtim të:

a) pasiveve financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Pasive të tilla, përfshirë derivativët që janë detyrime, do të maten më pas me vlerën e drejtë.



b) pasiveve financiare që lindin kur një transferim i një aktivi financiar nuk kualifikohet për çregjistrim ose kur zbatohet mënyra e përfshirjes së vazhdueshme. Paragrafët 3.2.15 dhe 3.2.17 zbatohen për matjen e pasiveve të tilla financiare.

c) kontratat financiare të garancisë të përcaktuara në shtojcën A. Pas njohjes fillestare, një emetues i një kontrate të tillë do ta masë atë më pas (nëse paragrafi 4.2.1 (a) ose (b) nuk zbatohet) me vlerën më të lartë midis:

i) shumës së përcaktuar në përputhje me SNK 37 “Provizione, pasive të kushtëzuara dhe aktive të kushtëzuara” dhe

ii) shumës të njohur fillimisht (shih paragrafin 5.1.1) pakësuar, kur është e përshtatshme, me amortizimin kumulativ të njohur në përputhje me SNK 18 “Të ardhurat”.

d) angazhimet për të siguruar një kredi me një normë interesi më të ulët se e tregut. Pas njohjes fillestare, një emetues i një angazhimi të tillë do ta masë më pas atë (përveçse kur zbatohet paragrafi 4.2.1 (a)) me më të lartën e:

i) shumës së përcaktuar në përputhje me SNK 37; dhe

ii) shumës së njohur fillimisht (shih paragrafin 5.1.1) pakësuar, kur është e përshtatshme, me amortizimin kumulativ të njohur në përputhje me SNK 18.

Opsioni për të caktuar një detyrim financiar me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes

4.2.2 Një njësi ekonomike, në njohjen fillestare, mund të caktojë në mënyrë të pakthyeshme një pasiv financiar si të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kur lejohet nga paragrafi 4.3.5, apo ngaqë duke vepruar kështu sigurohet informacion më i rëndësishëm, sepse, ose:

a) eliminon apo redukton ndjeshëm një matje ose mospërputhje në njohje (nganjëherë referuar si “mospërputhje kontabël”), që ndryshe do të rridhte nga matja e aktiveve apo pasiveve, apo njohja e fitimeve dhe humbjeve nga to mbi baza të ndryshme; ose

b) një grup pasivesh financiare apo aktivesh dhe pasivesh financiare është menaxhuar dhe performanca e tij është vlerësuar mbi bazën e vlerës së drejtë, në përputhje me një menaxhim rreziku të dokumentuar ose strategji investimi, dhe informacioni rreth grupit sigurohet nga brenda nga vetë personeli drejtues kryesor i njësisë ekonomike (siç përcaktohet në SNK 24 “Dhënia e informacioneve shpjeguese për palët e lidhura”), për shembull bordi i drejtorëve dhe drejtori ekzekutiv i njësisë ekonomike.

4.2.3 SNRF 7 kërkon që njësi ekonomike të japë informacione shpjeguese rreth pasiveve financiare që janë caktuar si pasive financiare me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

4.3 Derivatvët e përfshirë

4.3.1 Një derivativ i përfshirë është një përbërës i një kontrate hibride që, gjithashtu, përfshin një joderivatv bazë - me efekt që disa nga flukset e mjeteve monetare të instrumentit të kombinuar të ndryshojnë në mënyrë të ngjashme me një derivativ të veçantë. Një derivativ i përfshirë shkakton disa ose të gjitha flukset e mjeteve monetare që përndryshe do të kërkoheshin nga kontrata që të modifikoheshin sipas një norme të caktuar interesi, çmimit të instrumentit financiar, çmimit të mallrave, kursit të këmbimit valutor, indeksit të çmimeve ose normat, klasifikimi i kredive ose indeksit të kredisë, apo variabëlve të tjerë, siç është në rastin e një variabëli jofinanciar që nuk është specifik për një palë të kontratës. Një derivativ që lidhet me një instrument financiar, por që nga pikëpamja kontraktuale është i transferueshëm në mënyrë të pavarur nga ky instrument, ose ka një palë tjetër të ndryshme, nuk është një derivativ i përfshirë, por një instrument i veçantë financiar.

Kontratat hibride me bazë një aktiv financiar

4.3.2 Nëse një kontratë hibride ka si bazë një aktiv që është brenda objektit të këtij SNRF-je, një njësi ekonomike do të zbatojë kërkesat në paragrafët 4.1.1-4.1.5 për gjithë kontratën hibride.

Kontratat e tjera hibride

4.3.3 Nëse një kontratë hibride ka një bazë që nuk është një aktiv brenda objektit të këtij SNRF-je, një derivativ i përfshirë do të ndahet nga baza dhe do të trajtohet si një derivativ, sipas këtij SNRF-je nëse, dhe vetëm nëse:

a) karakteristikat ekonomike dhe rreziqet e derivativit të përfshirë nuk janë të lidhura ngushtë me karakteristikat ekonomike dhe rreziqet e instrumentit bazë (shih paragrafët B4.3.5 dhe B4.3.8);

b) një instrument i veçantë me kushte të njëjta, si derivativi i përfshirë do të plotësonte përkufizimin e një derivativi; dhe

c) kontrata hibride nuk matet me vlerën e drejtë, ndryshimet në të cilat njihen në fitim ose humbje (d.m.th. një derivativ që është i përfshirë në një detyrim financiar me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes nuk veçohet).

4.3.4 Nëse një derivativ i përfshirë veçohet, kontrata bazë do të trajtohet në përputhje me SNRF-të përkatëse. Ky SNRF nuk tregon nëse një derivativ i përfshirë do të paraqitet veçmas në pasqyrën e pozicionit financiar.

4.3.5 Pavarësisht nga paragrafët 4.3.3 dhe 4.3.4, nëse një kontratë përmban një ose më shumë derivativë të përfshirë dhe instrumenti bazë nuk është një aktiv brenda objektit të këtij SNRF-je, një njësi ekonomike mund ta përcaktojë të gjithë kontratën hibride me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes nëse:

a) derivativi (derivativët) nuk modifikon (modifikojnë) dukshëm flukset e mjeteve monetare që përndryshe do të kërkoheshin nga kontrata; ose

b) është e qartë pa qenë nevoja të bëhet analizë e thellë, pasi që më parë, për një instrument të ngjashëm hibrid është ndaluar ndarja e derivativit të përfshirë, siç është një opsjon parapagimi i përfshirë në një kredi që lejon mbajtësin të parapaguajë kredinë afërsisht me koston e amortizuar të saj.

4.3.6 Nëse një njësi ekonomike kërkohet sipas këtij SNRF-je, të ndajë një derivativ të përfshirë nga instrumenti bazë i tij, por nuk është në gjendje të masë derivativin në mënyrë të veçantë si në blerje, apo në fund të një periudhe pasuese raportimin financiar, ajo do ta caktojë të gjithë kontratën hibride si kontratë me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

4.3.7 Nëse një njësi ekonomike nuk është në gjendje të përcaktojë me besueshmëri vlerën e drejtë të një derivativi të përfshirë në bazë të termave dhe kushteve të tij, vlera e drejtë e tij është diferenca midis vlerës së drejtë të kontratës hibride dhe vlerës së drejtë të instrumentit bazë, në qoftë se këto mund të përcaktohen në bazë të këtij SNRF-je. Nëse njësi ekonomike nuk është në gjendje të përcaktojë vlerën e drejtë të derivativit të përfshirë duke përdorur këtë metodë, zbatohet paragrafi 4.3.6 dhe kontrata hibride përcaktohet si kontratë me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

4.4 Riklasifikimi

4.4.1 Kur, dhe vetëm kur, një njësi ekonomike ndryshon modelin e saj të biznesit për menaxhimin e aktiveve financiare ajo do të riklasifikojë të gjitha aktivet financiare të prekura në përputhje me paragrafët 4.1.1-4.1.4.

4.4.2 Një njësi ekonomike nuk do të riklasifikojë çfarëdo pasivi financiar.

4.4.3 Ndryshimet e mëposhtme për sa u përket rrethanave nuk janë riklasifikime për qëllime të paragrafëve 4.4.1 dhe 4.4.2:

a) Një derivativ që ka qenë më parë një instrument mbrojtës efektiv dhe i caktuar në një mbrojtje të fluksit monetar apo mbrojtje investimi neto nuk kualifikohet, si i tillë.

b) Një derivativ bëhet një instrument mbrojtës efektiv dhe i caktuar në një mbrojtje të fluksit monetar ose të investimit neto.

Kapitulli 5. Matja

5.1 Matja fillestare

5.1.1 Në njohjen fillestare, një njësi ekonomike duhet të masë një aktiv financiar ose pasiv financiar me vlerën e tij të drejtë (shih paragrafët 5.4.1-5.4.3 dhe B5.4.1-B5.4.17) plus ose minus kostot e transaksionit që lidhen drejtpërdrejt me blerjen ose emetimin e aktivit financiar apo pasivit financiar në rastin kur ky aktiv ose pasiv financiar nuk është me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

5.1.2 Kur një njësi ekonomike bën kontabilizimin në datën e shlyerjes së një aktivi që matet më pas me koston e amortizuar, aktivi njihet fillimisht me vlerën e drejtë në datën e tregtimit (shih paragrafët B3.1.3-B3.1.6).

5.2 Matja e mëpasshme e aktiveve financiare



5.2.1 Pas njohjes fillestare, njësia ekonomike duhet të masë një aktiv financiar me vlerën e drejtë në përputhje me paragrafët 4.1.1-4.1.5 (shih paragrafët 5.4.1, 5.4.2 dhe B5.4.1-B5.4.17) ose koston e amortizuar (shih paragrafët 9 dhe AG5-AG8 të SNK 39).

5.2.2 Një njësi ekonomike do të zbatojë kërkesat e kontabilitetit mbrojtës në paragrafët 58-65 dhe AG84-AG93 të SNK 39 për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar.

5.2.3 Një njësi ekonomike do të zbatojë kërkesat e kontabilitetit mbrojtës në paragrafët 89-102 të SNK 39 për një aktiv financiar që është përcaktuar si një zë i mbrojtur (shih paragrafët 78-84 dhe AG98-AG101 të SNK 39).

5.3 Matja e mëpasshme e pasiveve financiare

5.3.1 Pas njohjes fillestare, një njësi ekonomike do të masë një detyrim financiar në përputhje me paragrafët 4.2.1-4.2.2 (shih paragrafët 5.4.1-5.4.3 dhe B5.4.1-B5.4.17 dhe paragrafët 9 dhe AG5-AG8 të SNK 39).

5.3.2 Një njësi ekonomike do të zbatojë kërkesat e kontabilitetit mbrojtës në paragrafët 89-102 e SNK 39 për një pasiv financiar që është përcaktuar si një zë i mbrojtur (shih paragrafët 78-84 dhe AG98-AG101 të SNK 39).

5.4 Matja me vlerën e drejtë

5.4.1 Në përcaktimin e vlerës së drejtë të një aktivi financiar ose një detyrimi financiar për qëllimet e zbatimit të këtij SNRF-je, SNK 32, SNK 39 ose SNRF 7, një njësi ekonomike do të zbatojë paragrafët B5.4.1-B5.4.17.

5.4.2 Evidenca më e mirë e vlerës së drejtë janë çmimet e kuotuar në një treg aktiv. Në qoftë se tregu për një instrument financiar nuk është aktiv, një njësi ekonomike përcakton vlerën e drejtë, duke përdorur një teknikë vlerësimi. Qëllimi i përdorimit të një teknike vlerësimi është që të vendosë se çfarë çmimi transaksioni do të kishte qenë në datën e matjes në një këmbim të kryer në mënyrë të vullnetshme midis palëve të palidhura nga pikëpamja e biznesit normal. Teknikat e vlerësimit përfshijnë përdorimin e transaksioneve më të fundit të tregut të kryera midis palëve të mirinformuara, të vullnetshme, të palidhura me njëra-tjetrën, nëse është e mundur, në bazë të vlerës së drejtë aktuale të një instrumenti tjetër që është në thelb i njëjtë, analizës së fluksit monetar të skontuar dhe modeleve të vlerësimit të opsioneve. Nëse ka një teknikë vlerësimi që përdoret zakonisht nga pjesëmarrësit e tregut për të caktuar çmimin e instrumentit dhe që është vërtetuar se bën vlerësime të besueshme të çmimeve të marra në transaksionet aktuale të tregut, njësia ekonomike e përdor këtë teknikë. Teknika e zgjedhur e vlerësimit përdor maksimumin e inputeve të tregut dhe mbështetet sa më pak të jetë e mundur në inpute specifike të njësisë ekonomike. Ajo përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg do të kishin parasysh në vendosjen e një çmimi dhe është në përputhje me metodologjitë e pranuar ekonomike për caktimin e çmimeve të instrumenteve financiare. Periodikisht, një njësi ekonomike kontrollon teknikën e vlerësimit dhe e teston atë për vlefshmërinë duke përdorur çmimet nga çdo transaksion aktual tregu të mbikëqyrur për të njëjtin instrument (d.m.th. pa modifikim ose ripërpunim) ose bazuar në çfarëdo të dhënash të disponueshme të tregut të mbikëqyrur.

5.4.3 Vlera e drejtë e një pasivi financiar me tipar kërkueshmërie pa afat (p.sh. një depozitë pa afat) nuk është më e vogël se shuma e pagueshme sipas kërkesës, e skontuar nga data e parë që shuma do të kërkohej për t'u paguar.

5.5 Matja me koston e amortizuar - nuk përdoret

5.6 Riklasifikimi i aktiveve financiare

5.6.1 Nëse një njësi ekonomike i riklasifikon aktivet financiare në përputhje me paragrafin 4.4.1, ajo do të zbatojë në mënyrë prospektive riklasifikimin që nga data e riklasifikimit. Njësia ekonomike nuk do riparqesë fitimet, humbjet ose interesat e njohura më parë.

5.6.2 Në qoftë se, në përputhje me paragrafin 4.4.1, një njësi ekonomike riklasifikon një aktiv financiar në mënyrë që ai të matet me vlerën e drejtë, kjo vlerë përcaktohet në datën e riklasifikimit. Çdo fitim ose humbje që rrjedh nga një ndryshim në mes vlerës kontabël të mëparshme dhe vlerës së drejtë njihet në fitim ose humbje.

5.6.3 Në qoftë se, në përputhje me paragrafin 4.4.1, një njësi ekonomike riklasifikon një aktiv financiar në mënyrë që ai të matet me koston e amortizuar, vlera e tij e drejtë në datën e riklasifikimit bëhet vlera e tij e re kontabël.

5.7 Fitime dhe humbje neto

5.7.1 Një fitim ose humbje neto nga një aktiv financiar ose pasiv financiar që matet me vlerën e drejtë do të njihet në fitim ose humbje, përveç nëse:

a) është pjesë e një marrëdhënieje mbrojtëse (shih paragrafët 89-102 të SNK 39);

b) është një investim në një instrument të kapitalit dhe njësi ekonomike ka zgjedhur për së paraqitur fitimet dhe humbjet nga ky investim në të ardhurat e tjera të përgjithshme në përputhje me paragrafin 5.7.5; ose

c) është një pasiv financiar i përcaktuar si pasiv me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes dhe njësi ekonomike duhet të paraqesë efektet e ndryshimeve në rrezikun e kredisë të pasivit në të ardhura të tjera të përgjithshme në përputhje me paragrafin 5.7.7.

5.7.2 Një fitim ose humbje neto nga një aktiv financiar që matet me koston e amortizuar, që nuk është pjesë e një marrëdhënieje mbrojtëse (shih paragrafët 89-102 të SNK 39) do të njihet në fitim ose humbje kur aktivi financiar çregjistrohet, zhvlerësohet ose riklasifikohet në përputhje me paragrafin 5.6.2 dhe nëpërmjet procesit të amortizimit. Një fitim ose humbje neto nga një pasiv financiar që matet me koston e amortizuar dhe që nuk është pjesë e një marrëdhënieje mbrojtëse (shih paragrafët 89-102 të SNK 39) do të njihet në fitim ose humbje kur pasivi financiar çregjistrohet dhe përmes procesit të amortizimit.

5.7.3 Një fitim ose humbje neto nga aktivet financiare ose pasivet financiare që janë zëra të mbrojtur (shih paragrafët 78-84 dhe AG98-AG101 të SNK 39), do të njihet në përputhje me paragrafët 89-102 të SNK 39.

5.7.4 Nëse një njësi ekonomike njeh aktivet financiare duke përdorur kontabilitetin në datën e shlyerjes (shih paragrafin 3.1.2 dhe paragrafët B3.1.3 dhe B3.1.6), çdo ndryshim në vlerën e drejtë të aktivitetit të marrë gjatë periudhës midis datës së tregtimit dhe datës së shlyerjes nuk njihet për aktivet e matura me koston e amortizuar (përveç humbjeve nga zhvlerësimi). Megjithatë, për aktivet e matura me vlerën e drejtë, ndryshimi në vlerën e drejtë do të njihet në fitim ose humbje, ose në të ardhura të tjera të përgjithshme, kur është e mundur, në bazë të paragrafit 5.7.1.

Investimet në instrumente kapitali

5.7.5 Në njohjen fillestare, një njësi ekonomike mund të bëjë një zgjedhje të pakthyeshme për të paraqitur në të ardhura të tjera të përgjithshme ndryshimet e mëpasshme në vlerën e drejtë të një investimi në një instrument kapitali brenda objektivit të këtij SNRF-je, që nuk është i mbajtur për tregtim.

5.7.6 Nëse një njësi ekonomike e bën zgjedhjen sipas paragrafit 5.7.5, ajo do të njohë në fitim ose humbje dividendët nga këto investime, kur e drejta e njësisë ekonomike për të marrë pagesën e dividendit është përcaktuar në përputhje me SNK 18.

Pasivet e përcaktuara si pasive me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes

5.7.7 Një njësi ekonomike do të paraqesë një fitim ose humbje nga një pasiv financiar të përcaktuar si pasiv me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, si më poshtë:

a) shumën e ndryshimit në vlerën e drejtë të pasivit financiar që i takon ndryshimeve në rrezikun e kredisë të këtij pasivi duhet të paraqitet në të ardhura të tjera të përgjithshme (shih paragrafët B5.7.13 B5.7.20-); dhe

b) shumën e mbetur e ndryshimit në vlerën e drejtë të pasivit do të paraqitet në fitim ose humbje, përveç rasteve kur trajtimi i efekteve të ndryshimeve në rrezikun e kredisë për pasivin, të përshkruara në (a), do të krijonte ose rriste mospërputhjen kontabël në fitim ose humbje (rast në të cilin zbatohet paragrafi 5.7.8). Paragrafët B5.7.5-B5.7.7 dhe B5.7.10-B5.7.12 japin udhëzime për të përcaktuar nëse është krijuar apo rritur një mospërputhje kontabël.

5.7.8 Në qoftë se kërkesat në paragrafin 5.7.7 do të krijojnë ose rritnin një mospërputhje kontabël në fitim ose humbje, një njësi ekonomike duhet të paraqesë të gjitha fitimet ose humbjet neto nga ky pasiv (duke përfshirë efektet e ndryshimeve në rrezikun e kredisë të tij) në fitim ose humbje.



5.7.9 Pavarësisht nga kërkesat në paragrafët 5.7.7 dhe 5.7.8, një njësi ekonomike duhet të paraqesë në fitim ose humbje të gjitha fitimet dhe humbjet neto nga angazhimet e kredisë dhe kontratat e garancisë financiare, të cilat janë përcaktuar si instrumente financiare me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Kapitulli 6. Kontabilitetit mbrojtës - nuk përdoret

Kapitulli 7. Data e hyrjes në fuqi dhe periudha transitore

7.1 Data e hyrjes në fuqi

7.1.1 Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këtë SNRF për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2013 e në vijim. Lejohet zbatimi më i hershëm. Megjithatë, në qoftë se një njësi ekonomike zgjedh të zbatojë këtë SNRF më herët dhe ndërkohë nuk e ka zbatuar SNRF 9 e publikuar më 2009, ajo duhet të zbatojë të gjitha kërkesat në këtë SNRF në të njëjtën kohë (por shih edhe paragrafin 7.3.2). Nëse një njësi ekonomike zbaton këtë SNRF në pasqyrat e saj financiare për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar 2013, ajo do të japë informacion për këtë fakt dhe në të njëjtën kohë do të zbatojë amendimet në shtojcën C.

7.2 Periudha transitore

7.2.1 Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këtë SNRF në mënyrë retrospektive, në përputhje me SNK 8 “Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet”, me përjashtim të asaj që është specifikuar në paragrafët 7.2.4-7.2.15. Ky SNRF nuk do të zbatohet për zërat që tashmë janë çregjistruar në datën e fillimit të zbatimit.

7.2.2 Për qëllimet e dispozitave të periudhës transitore në paragrafët 7.2.1 dhe 7.2.3-7.2.16, data e fillimit të zbatimit është data kur një njësi ekonomike zbaton për herë të parë kërkesat e këtij SNRF-je. Data e fillimit të zbatimit mund të jetë:

a) çdo datë midis publikimit të këtij SNRF-je dhe 31 dhjetor 2010, për njësitë ekonomike që fillojnë zbatimin e këtij SNRF-je para 1 janarit 2011; ose

b) fillimi i periudhës së parë raportuese në të cilën njësi ekonomike adopton këtë SNRF, për njësitë ekonomike që kanë filluar zbatimin e këtij SNRF-je më 1 janar 2011 e në vijim.

7.2.3 Nëse data e fillimit të zbatimit nuk është në fillimin e një periudhe raportuese, njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për këtë fakt dhe arsyet për përdorimin kësaj date të zbatimit fillestar.

7.2.4 Në datën e fillimit të zbatimit, një njësi ekonomike do të vlerësojë nëse një aktiv financiar plotëson kushtet në paragrafin 4.1.2 (a) në bazë të fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në këtë datë. Klasifikimi i bërë do të zbatohet në mënyrë retrospektive pavarësisht nga modeli i biznesit të njësisë ekonomike në periudhat e mëparshme raportuese.

7.2.5 Nëse një njësi ekonomike mat një kontratë hibride me vlerën e drejtë në përputhje me paragrafin 4.1.4 ose pikën 4.1.5, por vlera e drejtë e kësaj kontrate nuk është përcaktuar në periudhat krahasuese të raportimit, vlera e drejtë e kontratës hibride në këto periudha krahasuese raportimi do të jetë shuma e vlerave të drejta të përbërësve (d.m.th. të instrumentit bazë joderivativ dhe derivativit të përfshirë) në fund të çdo periudhe krahasuese raportimi.

7.2.6 Në datën e fillimit të zbatimit, një njësi ekonomike do të njohë çdo diferencë midis vlerës së drejtë të kontratës hibride në tërësi në këtë datë dhe shumës së vlerave të drejta të përbërësve të kontratës hibride po në këtë datë:

a) në fitimet e pashpërndara në çelje të periudhës raportuese të zbatimit për herë të parë, nëse fillimisht njësi ekonomike e zbaton këtë SNRF në fillim të një periudhe raportimi; ose

b) në fitim ose humbje nëse fillimisht njësi ekonomike e zbaton këtë SNRF gjatë një periudhe raportimi.

7.2.7 Në datën e fillimit të zbatimit, një njësi ekonomike mund të përcaktojë:

a) një aktiv financiar të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në përputhje me paragrafin 4.1.5; ose

b) një investim në instrument kapitali neto si një instrument me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera të përgjithshme në përputhje me paragrafin 5.7.5.

Një përcaktim i tillë do të bëhet në bazë të fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në datën e fillimit të zbatimit. Ky klasifikim do të zbatohet në mënyrë retrospektive.

7.2.8 Në datën e fillimit të zbatimit, një njësi ekonomike:

a) duhet të anulohet caktimin e saj të mëparshëm të një aktivi financiar të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, në qoftë se ky aktiv financiar nuk i plotëson kushtet në paragrafin 4.1.5.

b) mund të anulohet caktimin e saj të mëparshëm të një aktivi financiar të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, në qoftë se ky aktiv financiar i plotëson kushtet në paragrafin 4.1.5.

Anulime të tilla do të bëhen në bazë të fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në datën e fillimit të zbatimit. Ky klasifikim do të zbatohet në mënyrë retrospektive.

7.2.9 Në datën e fillimit të zbatimit, një njësi ekonomike:

a) mund të përcaktojë një pasiv financiar që matet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në përputhje me paragrafin 4.2.2 (a);

b) duhet të anulohet përcaktimin e saj të mëparshëm të një pasivi financiar si të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes nëse ky përcaktim është bërë në njohjen fillestare në përputhje tani me kushtin në paragrafin 4.2.2 (a) dhe ky përcaktim nuk e përmbush këtë kusht në datën e fillimit të zbatimit;

c) mund të anulohet përcaktimin e saj të mëparshëm të një pasivi financiar si të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes nëse ky përcaktim është bërë në njohjen fillestare në përputhje tani me kushtin në paragrafin 4.2.2 (a) dhe ky përcaktim nuk e përmbush këtë kusht në datën e fillimit të zbatimit.

Ky përcaktim dhe anulimi i tij do të bëhen në bazë të fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në datën e fillimit të zbatimit. Ky klasifikim do të zbatohet në mënyrë retrospektive.

7.2.10 Nëse është e pazbatueshme (siç përcaktohet në SNK 8) për një njësi ekonomike të zbatohet në mënyrë retrospektive metodën efektive të interesit apo kërkesat për zhvlerësimin në paragrafët 58-65 dhe AG84-AG93 të SNK 39, njësi ekonomike duhet ta trajtojë vlerën e drejtë të aktivitetit financiar në fund të çdo periudhe krahasuese si koston e tij të amortizuar. Në këto rrethana, vlera e drejtë e aktivitetit financiar në datën e zbatimit fillestar, do të trajtohet si kosto e re e amortizuar e këtij aktivi financiar në datën e zbatimit fillestar të këtij SNRF-je.

7.2.11 Nëse një njësi ekonomike e ka kontabilizuar më parë një investim si një instrument kapitali të pakuotuar (ose një aktiv derivativ që është i lidhur dhe duhet të shlyhet me dhënien e një instrumenti kapitali të pakuotuar) me kosto në përputhje me SNK 39, ajo do ta masë këtë instrument me vlerë të drejtë në datën e zbatimit fillestar. Çdo diferencë në mes vlerës kontabël neto të mëparshme dhe vlerës së drejtë do të njihet në fitimet e pashpërndara në çelje të periudhës raportuese që përfshin datën e zbatimit fillestar.

7.2.12 Nëse një njësi ekonomike e ka kontabilizuar më parë një pasiv derivativ, që është i lidhur dhe që duhet të shlyhet me dhënien e një instrumenti të kapitalit të pakuotuar, me kosto në përputhje me SNK 39, ajo do ta masë këtë pasiv derivativ me vlerën e drejtë në datën e zbatimit fillestar. Çdo diferencë në mes vlerës kontabël neto të mëparshme dhe vlerës së drejtë do të njihet në fitimet e pashpërndara në çelje të periudhës raportuese që përfshin datën e zbatimit fillestar.

7.2.13 Në datën e zbatimit fillestar, një njësi ekonomike duhet të përcaktojë nëse trajtimi sipas paragrafit 5.7.7 do të krijonte ose thellonte një mospërputhje kontabël në fitimin ose humbjen në bazë të fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në datën e zbatimit fillestar. Ky SNRF do të zbatohet në mënyrë retrospektive mbi bazën e këtij përcaktimi.

7.2.14 Pavarësisht kërkesës në paragrafin 7.2.1, një njësi ekonomike që adopton këtë SNRF për periudhat raportuese që fillojnë para 1 janarit 2012, nuk ka nevojë të riparohet periudhat e mëparshme. Nëse një njësi ekonomike nuk riparohet periudhat e mëparshme, ajo do të njohë çdo diferencë midis vlerës kontabël neto të mëparshme dhe vlerës kontabël neto në fillim të periudhës së raportimit vjetor, që përfshin datën e zbatimit fillestar, në fitimet e pashpërndara (ose përbërësit e tjerë të kapitalit neto, nëse është e mundur) në çelje të periudhës raportuese që përfshin datën e zbatimit fillestar. Megjithatë, në



qoftë se një njësi ekonomike riparaqet periudhat e mëparshme, pasqyrat financiare të riparaqitura duhet të pasqyrojnë të gjitha kërkesat në këtë SNRF.

7.2.15 Nëse një njësi ekonomike përgatit raporte financiare të ndërmjetme në përputhje me SNK 34 “Raportimi financiar i ndërmjetëm”, ajo nuk duhet të zbatohet kërkesat në këtë SNRF për periudhat e ndërmjetme para datës së zbatimit fillestar, nëse nuk është praktike (siç përcaktohet në SNK 8).

Njësitë ekonomike që kanë filluar zbatimin e SNRF 9 të publikuar në 2009

7.2.16 Një njësi ekonomike do të zbatohet kërkesat e periudhës transitore në paragrafët 7.2.1-7.2.15 në datën përkatëse të zbatimit fillestar. Me fjalë të tjera, një njësi ekonomike do të zbatohet paragrafët 7.2.4-7.2.11 nëse ajo zbaton SNRF 9 (publikuar në vitin 2009) ose nuk i zbaton këta paragrafë kur ajo zbaton SNRF 9 (publikuar në vitin 2010) në tërësinë e tij. Një njësi ekonomike nuk lejohet të zbatohet këta paragrafë më shumë se një herë.

7.3 Tërheqja e KIRFN 9 dhe SNRF 9 (2009)

7.3.1 Ky SNRF zëvendëson KIRFN 9 “Rivlerësimi i derivativëve të përfshirë”. Kërkesat e shtuara në SNRF 9, në tetor 2010, përfshijnë kërkesat e përcaktuara më parë në paragrafët 5 dhe 7 të KIRFN 9. Si rrjedhojë e amendimit, SNRF 1 “Adoptimi për herë të parë i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar”, ka përfshirë kërkesat e parashtruara më parë në paragrafin 8 të KIRFN 9.

7.3.2 Ky SNRF zëvendëson SNRF 9 të publikuar në 2009. Megjithatë, për periudhat vjetore që fillojnë para datës 1 janar 2013, një njësi ekonomike mund të zgjedhë të zbatohet SNRF 9 të publikuar në 2009, në vend të zbatimit të këtij SNRF-je.

SHTOJCA A TERMAT E PËRCAKTUAR

Kjo shtojcë është një pjesë integrale e SNRF-së.

Çregjistrimi	Heqja e një aktivi financiar ose pasivi financiar të njohur më parë nga pasqyra e pozicionit financiar të një njësie ekonomike.
Derivativ	Një instrument financiar ose kontratë tjetër brenda objektit të këtij SNRF-je (shih paragrafin 2.1) që i ka të tri karakteristikat e mëposhtme: a) Vlera e tij ndryshon në vartësi të ndryshimit në një normë interesi të caktuar, çmimit të instrumentit financiar, çmimit të mallrave, kursit të këmbimit të monedhës, indeksit të çmimeve ose të normave, klasifikimit të kredive ose indeksit të kredisë, ose të variabëlve të tjerë, siç është në rastin e një variabëli jofinanciar që nuk është specifik për një palë të kontratës (që nganjëherë quhet “variabël bazë”). b) Nuk kërkohet investim fillestar neto ose një investim fillestar neto që është më i vogël sesa do të ishte e nevojshme për llojet e tjera të kontratave që pritet të ndikohen në mënyrë të ngjashme nga ndryshimet në faktorët e tregut. c) Shlyerja e tij bëhet në të ardhmen.
Vlera e drejtë	Shuma me të cilën mund të shkëmbehet një aktiv, ose mund të shlyhet një detyrim, ndërmjet palëve të mirinformuara, të vullnetshme dhe të palidhura me njëra-tjetrën ¹ .
Kontratë e garancisë financiare	Një kontratë sipas të cilës emetuesi kërkohet të bëjë pagesa të përcaktuara për të zhdëmtuar mbajtësin për një humbje të ndodhur për shkak të një debitori të specifikuar që nuk arrin të bëjë pagesën në kohën e duhur në përputhje me kushtet fillestare ose të modifikuara të një instrumenti borxhi.
Pasiv financiar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes	Një pasiv financiar që i plotëson secilin nga kushtet e mëposhtme: a) Plotëson përkufizimin i mbajtur për tregtim. b) Pas njohjes fillestare ai është përcaktuar nga njësi ekonomike si instrument financiar me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në përputhje me paragrafin 4.2.2 ose 4.3.5.

¹Paragrafët 5.4.1-5.4.3 dhe B5.4.1-B5.4.17 përbajnë kërkesat për përcaktimin e vlerës së drejtë të një aktivi financiar ose pasivi financiar.

- I mbajtur për tregtim** Një aktiv financiar ose pasiv financiar që:
- a) është blerë apo krijuar kryesisht për qëllime të shitjes ose të riblerjes në afat të afërt kohor;
 - b) në njohjen fillestare është pjesë e portofolit të instrumenteve financiare që janë të menaxhuara së bashku dhe për të cilat ka evidencë të një modeli aktual të kohëve të fundit për realizimin e fitimeve afatshkurtra; ose
 - c) është një derivat (me përjashtim të një derivativi që është një kontratë e garancisë financiare ose një instrument mbrojtës i caktuar dhe efektiv).
- Data e riklasifikimit** Dita e parë e periudhës së parë të raportimit pas ndryshimit në modelin e biznesit që çon në riklasifikimin e aktiveve financiare në një njësi ekonomike.
- Mënyrë e rregullt blerje ose shitje** Një blerje ose shitje e një aktivi financiar sipas një kontrate ku kërkohet që drejtimi të bëjë dorëzimin e aktivitet brenda kuadrit kohor të vendosur në përgjithësi nga rregullorja ose konventa në tregun përkatës.

Termat e mëposhtëm janë përcaktuar në paragrafin 11 të SNK 32, paragrafin 9 të SNK 39 ose në shtojcën A të SNRF 7 dhe janë përdorur në këtë SNRF me kuptimet e specifikuar në SNK 32, SNK 39 ose SNRF 7:

- a) kosto e amortizuar e aktivitet financiar ose pasivitet financiar;
- b) rreziku i kredisë;
- c) metoda e interesit efektiv;
- d) instrument i kapitalit neto;
- e) aktiv financiar;
- f) instrument financiar;
- g) pasiv financiar;
- h) element i mbrojtur;
- i) instrument mbrojtës;
- j) kostot e transaksionit.

SHTOJCA B UDHËZIM PËR ZBATIM

Kjo shtojcë është një pjesë integrale e SNRF-së.

Njohja dhe çregjistrimi (kapitulli 3)

Njohja fillestare (seksioni 3.1)

B3.1.1 Si rrjedhojë e parimit në paragrafin 3.1.1, një njësi ekonomike i njej të gjitha të drejtat e saj kontraktuale dhe detyrimet nga derivativët në pasqyrën e pozicionit financiar përkatësisht si aktive dhe pasive, me përjashtim të derivativëve që parandalojnë një transferim të aktiveve financiare nga të qenit i trajtuar si një shitje (shih paragrafin B3.2.14). Në qoftë se një transferim i një aktivi financiar nuk kualifikohet për çregjistrim, i transferuari nuk e njej aktivin e transferuar si aktivin e tij (shih paragrafin B3.2.15).

B3.1.2 Më poshtë jepen shembuj të zbatimit të parimit në paragrafin 3.1.1.

a) Llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme të pakushtëzuara njihen si aktive ose detyrime, kur njësia ekonomike bëhet palë në kontratë dhe, si pasojë, ka një të drejtë ligjore për të marrë apo një detyrim ligjor për të paguar në mjete monetare.

b) Aktivitet e blera dhe detyrimet që ndërmerren si rezultat i një angazhimi të përcaktuar për të blerë ose shitur mallra apo shërbime, në përgjithësi, nuk njihen të paktën deri sa një nga palët ka vepruar sipas marrëveshjes. Për shembull, një njësi ekonomike që merr një porosi të përcaktuar, në përgjithësi, nuk njej një aktiv (dhe njësia ekonomike që bën porosinë nuk njej një pasiv) në kohën e angazhimit, por, përkundrazi, njohja shtyhet deri sa mallrat ose shërbimet e porositura të jenë dërguar, dorëzuar ose dhënë. Nëse një angazhim i përcaktuar për të blerë apo shitur zëra jofinanciarë është brenda objektit të këtij SNRF, në përputhje me paragrafët 5-7 të SNK 39, vlera e drejtë neto e tij njihet si një aktiv ose



pasiv në datën e angazhimit (shih (c) më poshtë). Përveç kësaj, në qoftë se një angazhim i përcaktuar i panjohur më parë përcaktohet si një element i mbrojtur në një mbrojtje me vlerën e drejtë, çdo ndryshim në vlerën e drejtë neto që ka të bëjë drejtpërdrejt me rrezikun e mbrojtur njihet si një aktiv ose pasiv pas fillimit të mbrojtjes (shih paragrafët 93 dhe 94 të SNK 39).

c) Një kontratë e ardhshme që është brenda objektit të këtij SNRF-je (shih paragrafin 2.1) njihet si një aktiv ose pasiv në datën e angazhimit, sesa në datën në të cilën bëhet shlyerja. Kur një njësi ekonomike bëhet palë në një kontratë të ardhshme, vlerat e drejta të së drejtës dhe e detyrimit shpesh janë të barabarta, kështu që vlera e drejtë neto e kontratës është zero. Nëse vlera e drejtë neto e të drejtës dhe e detyrimit nuk është zero, kontrata njihet si një aktiv ose pasiv.

d) Kontrata opsioni që janë brenda objektit të këtij SNRF-je (shih paragrafin 2.1) njihen si aktive ose pasive kur mbajtësi apo shkruesi bëhet palë në kontratë.

e) Transaksionet e planifikuara për të ardhmen, pa marrë parasysh sa janë të mundshme, nuk janë aktive dhe pasive për shkak se njësi ekonomike nuk është bërë palë në një kontratë.

Mënyra e rregullt e blerjes ose shitjes së aktiveve financiare

B3.1.3 Një mënyrë e rregullt blerjeje ose shitjeje e aktiveve financiare njihet ose duke përdorur kontabilizimin në datën e tregtimit, ose në datën e shlyerjes, siç përshkruhet në paragrafët B3.1.5 dhe B3.1.6. Një njësi ekonomike do të zbatojë të njëjtën metodë në vazhdimësi për të gjitha blerjet dhe shitjet e aktiveve financiare, që janë klasifikuar në të njëjtën mënyrë në përputhje me këtë SNRF. Për këtë qëllim, aktivet që janë matur detyrimisht me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes formojnë një klasifikim të veçantë nga aktivet e përcaktuara si të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Përveç kësaj, investimet në instrumente kapitali neto të kontabilizuara, duke përdorur opsionin e parashikuar në paragrafin 5.7.5, formojnë një klasifikim të veçantë.


B3.1.4 Një kontratë që kërkon ose lejon shlyerjen neto të ndryshimit në vlerën e saj nuk është një kontratë në mënyrë të rregullt. Në vend të kësaj, një kontratë e tillë trajtohet si një derivativ në periudhën midis datës së tregtimit dhe datës së shlyerjes.

B3.1.5 Data e tregtimit është data që një njësi ekonomike angazhohet për të blerë ose shitur një aktiv. Kontabilizimi në datën e tregtimit i referohet: a) njohjes së një aktivi të marrë dhe detyrimit për të paguar për të në datën e tregtimit; dhe b) çregjistrimit të një aktivi që është shitur, njohjes së ndonjë fitimi ose humbjeje neto nga shitja dhe njohjes së një të drejte të arkëtueshme nga blerësi për pagesën në datën e tregtimit. Në përgjithësi, interesi nuk ka filluar të rritet mbi aktivin dhe detyrimin përkatës deri në datën e shlyerjes, kur kalon titulli.

B3.1.6 Data e shlyerjes është data që një aktiv është dorëzuar në ose nga një njësi ekonomike. Kontabilizimi në datën e shlyerjes i referohet: a) njohjes së një aktivi në ditën që është marrë nga njësi ekonomike; dhe b) çregjistrimit të një aktivi dhe njohjes së çdo fitimi ose humbjeje nga shitja në ditën që ai është dorëzuar nga njësi ekonomike. Kur një njësi ekonomike bën kontabilizimin në datën e shlyerjes trajton çdo ndryshim në vlerën e drejtë të aktivitetit të marrë gjatë periudhës midis datës së tregtimit dhe datës së shlyerjes në të njëjtën mënyrë sikurse ajo trajton aktivin e blerë. Me fjalë të tjera, ndryshimi në vlerë nuk njihet për aktivet e matura me koston e amortizuar; ai njihet në fitim ose humbje për aktivet e klasifikuara si aktive financiare të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes; dhe njihet në të ardhura të tjera të përgjithshme për investimet në instrumente kapitali të trajtuara në përputhje me paragrafin 5.7.5.

Çregjistrimi i aktiveve financiare (seksioni 3.2)

B3.2.1 Tabela e mëposhtme ilustron vlerësimin nëse, dhe në çfarë mase një aktiv financiar çregjistrohet.





Marrëveshjet në të cilat një njësi ekonomike ruan të drejtat kontraktuale për të arkëtuar flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar, por merr përsipër një detyrim kontraktual për t'u paguar flukse mjetesh monetare një apo më shumë marrësve (paragrafi 3.2.4 (b))

B3.2.2 Situata e përshkruar në paragrafin 3.2.4 (b) (kur një njësi ekonomike ruan të drejtat kontraktuale për të marrë flukse monetare nga aktivi financiar, por merr përsipër një detyrim kontraktual, t'u paguajë flukse mjetesh monetare një apo më shumë marrësve) ndodh, për shembull nëse njësi ekonomike është një njësi për qëllime të veçanta ose besimi, dhe u kalon investitorëve interesa të dobishme në aktivet bazë financiare që ajo zotëron dhe ofron shërbimin e këtyre aktiveve financiare. Në këtë rast, aktivet financiare kualifikohen për çregjistrim nëse plotësohen kushtet në paragrafët 3.2.5 dhe 3.2.6.

B3.2.3 Në zbatim të paragrafit 3.2.5, njësi ekonomike mund të jetë, për shembull, krijuesja e aktivitet financiar, ose ajo mund të jetë një grup që përfshin një njësi ekonomike për qëllime të veçanta të konsoliduara që ka blerë aktivin financiar dhe ua kalon flukset e mjeteve monetare investitorëve të palës së tretë të palidhur.

Vlerësimi i transferimit të rreziqeve dhe përfitimeve të pronësisë (paragrafi 3.2.6)

B3.2.4 Shembuj kur një njësi ekonomike ka transferuar thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë janë:

- a) një shitje e pakushtëzuar e një aktivi financiar;
- b) një shitje e një aktivi financiar së bashku me një opion për ta riblerë aktivin financiar me vlerën e drejtë të tij në kohën e riblerjes; dhe
- c) një shitje e një aktivi financiar së bashku me një opion blerjeje ose shitjeje që është vështirë të jetë me para (d.m.th. një opion që është pa para saqë është shumë vështirë të ndodhë e kundërta para skadimit).

B3.2.5 Shembuj kur një njësi ekonomike ka mbajtur thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë janë:

- a) një transaksion shitje dhe riblerje ku çmimi i riblerjes është një çmim fiks ose çmimi i shitjes plus kthimin e huadhënësit;
- b) një marrëveshje e letrave me vlerë të kreditimit;
- c) një shitje e një aktivi financiar së bashku me një kthim të përgjithshëm të kontratës së shkëmbimit që ia transferon përsëri njësisë ekonomike ekspozimin ndaj rrezikut të tregut;
- e) një shitje e një aktivi financiar së bashku me një opion kthimi apo blerjeje që është vështirë të jetë me para (d.m.th. një opion që është pa para, saqë është shumë vështirë të ndodhë e kundërta para skadimit); dhe
- ë) një shitje e llogarive të arkëtueshme afatshkurtra, në të cilën njësi ekonomike garanton të kompensojë marrësin për humbjet e kredisë që kanë të ngjarë të ndodhin.

B3.2.6 Nëse një njësi ekonomike përcakton sesi rezultat i transferimit ka transferuar thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivitet të transferuar, ajo nuk e njeh aktivin e transferuar përsëri në një periudhë të ardhshme, nëse nuk e riblen aktivin e transferuar në një transaksion të ri.

Vlerësimi i transferimit të kontrollit

B3.2.7 Një njësi ekonomike nuk ruan kontrollin e një aktivi të transferuar nëse i transferuari (marrësi) ka aftësinë praktike për ta shitur këtë aktiv. Një njësi ekonomike ruan kontrollin e një aktivi të transferuar nëse i transferuari nuk ka aftësinë praktike për ta shitur këtë aktiv. Një i transferuar ka aftësinë praktike për ta shitur aktivin e transferuar në qoftë se ai tregtohet në një treg aktiv, sepse i transferuari mund ta riblerë aktivin e transferuar në treg, nëse ai duhet t'ia kthejë aktivin njësisë ekonomike. Për shembull, një i transferuar mund të ketë aftësinë praktike për ta shitur një aktiv të transferuar, nëse aktivi i transferuar është subjekt i një opsioni që lejon që njësi ekonomike ta riblerë atë, por i transferuari mund të jetë i gatshëm ta marrë aktivin e transferuar në treg nëse ushtrohet opsioni. Një i transferuar nuk ka aftësinë praktike për ta shitur aktivin e transferuar, nëse njësi ekonomike ruan një opion të tillë dhe i transferuari nuk është i gatshëm ta marrë aktivin e transferuar në treg, nëse njësi ekonomike ushtron opsionin e saj.

B3.2.8 I transferuari ka aftësinë praktike për ta shitur aktivin e transferuar vetëm nëse ai mund t'ia shesë aktivin e transferuar në tërësinë e tij një pale të tretë të palidhur dhe është në gjendje ta ushtrojë këtë aftësi në mënyrë të njëanshme dhe pa imponuar kufizime shtesë për të. Pyetja kritike është ajo që çfarë është në gjendje të bëjë në praktikë i transferuari, dhe jo se çfarë të drejtash kontraktuale ka ai në lidhje me atë që mund të bëjë me aktivin e transferuar ose çfarë ndalimesh kontraktuale ekzistojnë. Në veçanti:

a) një e drejtë kontraktuale për të shitur aktivin e transferuar ka ndikim të vogël praktik, në qoftë se nuk ka treg për aktivin e transferuar; dhe

b) aftësia për ta shitur aktivin e transferuar ka ndikim të vogël praktik, në qoftë se ajo nuk mund të ushtrohet lirshëm. Për këtë arsye:

i) aftësia e të transferuarit për ta shitur aktivin e transferuar duhet të jetë e pavarur nga veprimet e të tjerëve (d.m.th. ajo duhet të jetë një aftësi e njëanshme); dhe

ii) i transferuari duhet të jetë në gjendje për shitjen e aktivit të transferuar pa pasur nevojë të shtojë kushte kufizuese ose “pengesa” për ta transferuar (p.sh. kushtet për mënyrën se si një aktiv kredie është shërbyer apo një opsion i jep të transferuarit të drejtën për të riblerë aktivin).

B3.2.9 Fakti që i transferuari nuk ka gjasa të shesë aktivin e transferuar nuk do të thotë se transferuesi ka ruajtur kontrollin e aktivit të transferuar. Megjithatë, në qoftë se një kontratë me opsion ose garanci kufizon të transferuarin nga shitja e aktivit të transferuar, atëherë transferuesi ka ruajtur kontrollin e aktivit të transferuar. Për shembull, në qoftë se një kontratë opsioni ose garanci është mjaft e vlefshme ajo kufizon të transferuarin nga shitja e aktivit të transferuar për shkak se marrësi, në praktikë, nuk do t'ia shiste aktivin e transferuar një pale të tretë pa shtuar një opsion të ngjashëm ose kushte të tjera kufizuese. Në vend të kësaj, i transferuari do të mbajë aktivin e transferuar në mënyrë që të marrë pagesat nën garanci ose kontrata e opsionit. Në këto rrethana transferuesi ka ruajtur kontrollin e aktivit të transferuar.

Transferimet që kualifikohen për çregjistrim

B3.2.10 Një njësi ekonomike mund të ruajë të drejtën e një pjesë të pagesave të interesit për aktivet e transferuara, si kompensim për shërbimin ndaj këtyre aktiveve. Pjesa e pagesave të interesit që njësi ekonomike do të hiqte dorë me përfundimin ose transferimin e kontratës së shërbimit, shpërndahet në aktiv shërbimi ose pasiv shërbimi. Pjesa e pagesave të interesit që njësi ekonomike nuk do të heqë dorë është një interes i arkëtueshëm i shitur veçmas. Për shembull, në qoftë se njësi ekonomike nuk do të heqë dorë nga ndonjë interes mbi përfundimin ose transferimin e kontratës së shërbimit, i gjithë interesi i shpërndarë është vetëm një interes i arkëtueshëm i shitur veçmas. Për qëllime të zbatimit të paragrafit 3.2.13, vlerat e drejta të aktivit të shërbimit dhe të interesit të arkëtueshëm të shitur veçmas përdoren për të shpërndarë vlerën kontabël të llogarisë së arkëtueshme në mes të një pjese të aktivit që është çregjistruar dhe pjesës që vazhdon të njihet. Në qoftë se nuk ka asnjë tarifë shërbimi të caktuar ose tarifa për t'u marrë nuk pritet që të kompensojë njësinë ekonomike në mënyrë adekuate për kryerjen e shërbimit, njihet një pasiv për detyrimin e shërbimit me vlerën e drejtë.

B3.2.11 Në vlerësimin e vlerave të drejta të pjesës që vazhdon të njihet dhe të pjesës që nuk njihet për qëllime të zbatimit të paragrafit 3.2.13, një njësi ekonomike zbaton kërkesat e matjes së vlerës së drejtë në paragrafët 5.4.1-5.4.3 dhe B5.4.1 -B5.4.13 përveç paragrafit 3.2.14.

Transferimet që nuk kualifikohen për çregjistrim

B3.2.12 Në vijim është një zbatim i parimit të përshkruar në paragrafin 3.2.15. Në qoftë se një garanci e dhënë nga njësi ekonomike për humbjet e pësuar nga aktivi i transferuar parandalon çregjistrimin e një aktivi të transferuar, sepse njësi ekonomike ka ruajtur kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së tij, aktivi i transferuar vazhdon të njihet në tërësinë e tij dhe shuma e arkëtuar njihet si një detyrim.

Përfshirja e vazhdueshme në aktivet e transferuara

B3.2.13 Në vijim janë dhënë shembuj se si një njësi ekonomike mat një aktiv të transferuar dhe pasivet që lidhen me të në bazë të paragrafit 3.2.16.



Të gjitha aktivet

a) Në qoftë se një garanci e siguruar nga një njësi ekonomike për të paguar për humbjet e pësuar nga një aktiv i transferuar parandalon çregjistrimin e tij në masën e përfshirjes së vazhdueshme, aktivi i transferuar në datën e transferimit matet me më të ulëtën e: i) vlerës kontabël neto të aktivit; dhe ii) shumës maksimale të arkëtuar nga transferimi, që njësia ekonomike mund të jetë e detyruar ta kthejë (shumë garancie). Pasivi që lidhet me të matet fillimisht me shumën e garancisë plus vlerën e drejtë të garancisë (e cila është zakonisht shuma e arkëtuar për garanci). Më pas, vlera e drejtë fillestare e garancisë njihet në fitim ose humbje në bazë proporcionale me kohën (shih SNK 18) dhe vlera kontabël e aktivit zvogëlohet me ndonjë humbje nga zhvlerësimi.

Aktivët e matura me koston e amortizuar

b) Në qoftë se një detyrim i kontratës me opSION, e shkruar nga një njësi ekonomike ose e drejta e opSIONIT të blerjes e mbajtur nga një njësi ekonomike, parandalon çregjistrimin e një aktivi të transferuar dhe njësia ekonomike e mat aktivin e transferuar me koston e amortizuar, pasivi i lidhur matet me koston e tij (d.m.th. shuma e arkëtuar) e rregulluar për amortizimin e ndonjë diference në mes kësaj kostoje dhe koston së amortizuar të aktivit të transferuar në datën e skadimit të opSIONIT. Për shembull, supozojmë se kostoja e amortizuar dhe vlera kontabël e aktivit në datën e transferimit është 98 NJM dhe shuma e arkëtuar 95 NJM. Kostoja e amortizuar e aktivit në datën e ushtrimit të opSIONIT do të jetë 100 NJM. Vlera fillestare kontabël e pasivit të lidhur është 95 NJM dhe diferenca në mes 95 NJM dhe 100 NJM njihet në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Nëse opSIONI ushtrohet, çdo diferencë mes vlerës kontabël të pasivit të lidhur dhe çmimi të ushtrimit të opSIONIT njihet në fitim ose humbje.

Aktivët e matura me vlerën e drejtë

c) Në qoftë se një e drejtë opSIONI blerjeje e mbajtur nga një njësi ekonomike parandalon çregjistrimin e një aktivi të transferuar dhe njësia ekonomike e mat aktivin e transferuar me vlerën e drejtë, ai vazhdon të matet me këtë vlerë. Pasivi i lidhur matet me: i) çmimin e ushtrimit të opSIONIT pakësuar me vlerën në kohë të opSIONIT, nëse ky opSION është në ose me para; ose me ii) vlerën e drejtë të aktivit të transferuar pakësuar me vlerën në kohë të opSIONIT nëse ky opSION nuk është me para. Rregullimi për matjen e detyrimit të lidhur siguron që vlera kontabël neto e aktivit dhe e pasivit të lidhur të jetë vlera e drejtë e së drejtës së opSIONIT të blerjes. Për shembull, nëse vlera e drejtë e aktivit bazë është 80 NJM, çmimi i ushtrimit të opSIONIT është 95 NJM dhe vlera në kohë e opSIONIT është 5 NJM, vlera kontabël e pasivit të lidhur është 75 NJM (80 NJM - 5 NJM) dhe vlera kontabël e aktivit të transferuar është 80 NJM (d.m.th. vlera e tij e drejtë).

d) Në qoftë se një kontratë opSIONI e shkruar nga një njësi ekonomike parandalon çregjistrimin e një aktivi të transferuar dhe njësia ekonomike e mat aktivin e transferuar me vlerën e drejtë, detyrimi i lidhur matet me çmimin e ushtrimit të opSIONIT plus vlerën në kohë të opSIONIT. Matja e aktivit me vlerën e drejtë është e kufizuar në më të ulëtën e vlerës së drejtë dhe çmimit të ushtrimit të opSIONIT për shkak se njësia ekonomike nuk ka të drejtë të rrisë vlerën e drejtë të aktivit të transferuar mbi çmimin e ushtrimit të opSIONIT. Kjo siguron që vlera kontabël neto e aktivit dhe e pasivit të lidhur të jetë vlera e drejtë e detyrimit të kontratës së opSIONIT. Për shembull, nëse vlera e drejtë e aktivit bazë është 120 NJM, çmimi i ushtrimit të opSIONIT është 100 NJM dhe vlera në kohë e opSIONIT është 5 NJM, vlera kontabël e pasivit të lidhur është 105 NJM (100 NJM + 5 NJM) dhe vlera kontabël e aktivit është 100 NJM (në këtë rast çmimi i ushtrimit të opSIONIT).

e) Nëse një investim mbrojtës, në formën e një opSIONI blerjeje të marrë dhe opSIONI kthimi të shkruar, parandalon një aktiv të transferuar të çregjistrohet dhe njësia ekonomike e mat aktivin me vlerën e drejtë, ajo vazhdon ta masë atë me vlerën e drejtë. Detyrimi i lidhur matet me: i) shumën e çmimit të ushtrimit të opSIONIT të blerjes dhe vlerës së drejtë të opSIONIT të kthimit pakësuar me vlerën në kohë të opSIONIT të blerjes, nëse ky opSION është në ose me para; ose me ii) shumën e vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës së drejtë të opSIONIT të kthimit pakësuar me vlerën në kohë të opSIONIT të blerjes, nëse ky opSION është pa para. Rregullimi në detyrimin e lidhur siguron që vlera kontabël neto e aktivit dhe e pasivit të lidhur të jetë vlera e drejtë e opsioneve të mbajtura dhe të shkruara nga njësia ekonomike. Për

shembull, supozojmë një njësi ekonomike transferon një aktiv financiar që matet me vlerën e drejtë, ndërsa në të njëjtën kohë ka blerë një opSION me një çmim ushtrimi 120 NJM dhe ka shkruar një me një çmim ushtrimi i 80 NJM. Supozojmë, gjithashtu, se vlera e drejtë e aktivitet është 100 NJM në datën e transferimit. Vlera në kohë e opSIONIT të kthimit dhe atij të blerjes janë 1 NJM dhe 5 NJM përkatësisht. Në këtë rast, njësi ekonomike njeht një aktiv për 100 NJM (vlera e drejtë e aktivitet) dhe një pasiv për 96 NJM $[(100 \text{ NJM} + 1 \text{ NJM}) - 5 \text{ NJM}]$. Kjo bën që vlera neto e aktivitet të jetë 4 NJM, që është vlera e drejtë e opSIONEVE të mbajtura dhe të shkruara nga njësi ekonomike.

Të gjitha transferimet

B3.2.14 Deri në masën që një transferim i një aktivi nuk kualifikohet për çregjistrim, të drejtat kontraktuale të transferuesit ose detyrimet e lidhura me transferimin nuk trajtohen veçmas si derivativët në qoftë se njohja si e derivativit, ashtu dhe e aktivitet të transferuar apo pasivit që lind nga transferimi do të çojë në njohjen dy herë të të drejtave ose detyrimeve të njëjta. Për shembull, një opSION blerjeje i mbajtur nga transferuesi mund të parandalojë një transferim të aktiveve financiare nga kategoria e instrumenteve financiare për shitje. Në këtë rast, opSIONI i blerjes nuk njihet veçmas si një aktiv derivativ.

B3.2.15 Deri në masën që një transferim i një aktivi nuk kualifikohet për çregjistrim, i transferuari nuk e njeht aktivin e transferuar si aktivin e tij. I transferuari njeht një shumë të arkëtueshme nga transferuesi duke kredituar mjetet monetare ose shumën e paguar. Nëse transferuesi ka edhe të drejtën dhe detyrimin të rimarrë kontrollin e gjithë aktivitet të transferuar për një shumë të caktuar (të tilla si në një marrëveshje riblerjeje), i transferuari mund të masë llogaritë e tij të arkëtueshme me koston e amortizuar, nëse plotësohen kriteret në paragrafin 4.1.2.

Shembuj

B3.2.16 Shembujt e mëposhtëm ilustrojnë zbatimin e parimeve për çregjistrim të këtij SNRF-je.

a) Marrëveshjet e riblerjes dhe të huadhënies së letrave me vlerë. Nëse një aktiv financiar është shitur sipas një marrëveshjeje për ta riblerë atë me një çmim të caktuar ose me një çmim shitjeje plus kthimin e huadhënësit, ose në qoftë se ai është huazuar sipas një marrëveshjeje për t'ia kthyer atë transferuesit, ai nuk çregjistrohet, sepse transferuesi ruan kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë. Në qoftë se i transferuari fiton të drejtën për ta shitur ose ta lërë si kolateral aktivin, transferuesi e riklasifikon aktivin në pasqyrën e pozicionit financiar, për shembull, si një aktiv të huajtur ose llogari të arkëtueshme të riblerë.

b) Marrëveshjet e riblerjes dhe aktive nga huadhënia e letrave me vlerë që në thelb janë të njëjta. Nëse një aktiv financiar është shitur sipas një marrëveshjeje për ta riblerë të njëjtin ose kryesisht të njëjtin aktiv me një çmim të caktuar ose me një çmim shitjeje plus kthimin e huadhënësit, ose në qoftë se një aktiv financiar është huazuar apo marrë borxh në bazë të një marrëveshjeje për t'ia kthyer transferuesit të njëjtin ose kryesisht të njëjtin aktiv, ai nuk çregjistrohet, sepse transferuesi ruan kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë.

c) Marrëveshjet e riblerjes dhe të drejtat e zëvendësimit nga huadhënia e letrave me vlerë. Nëse një marrëveshje riblerjeje me një çmim fiks riblerjeje ose me një çmim të barabartë me çmimin e shitjes plus kthimin e huadhënësit, ose të një transaksioni të ngjashëm huadhënie të letrave me vlerë, i jep të transferuarit të drejtën të zëvendësojë aktivet që janë të ngjashme dhe me vlerë të drejtë të njëjtë me atë të aktivitet të transferuar në datën e riblerjes, aktivi i shitur apo i huazuar sipas një marrëveshjeje riblerjeje ose kreditimi letrash me vlerë nuk çregjistrohet, sepse transferuesi i ruan kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë.

d) E drejta e riblerjes së ofertës së parë me vlerën e drejtë. Nëse një njësi ekonomike shet një aktiv financiar dhe mban vetëm të drejtën e ofertës së parë për ta riblerë aktivin e transferuar me vlerën e drejtë, nëse më pas i transferuari e shet, njësi ekonomike e çregjistron aktivin për shkak se ajo i ka transferuar kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë.

e) Transaksion shitblerjeje i parregullt. Riblerja e një aktivi financiar menjëherë pasi ai është shitur disa herë quhet si një pastrim shitjeje shitblerjeje e parregullt. Një riblerje e tillë nuk përjashton çregjistrimin me kusht që transaksioni origjinal i plotëson kërkesat e çregjistrimit. Megjithatë, nëse një



marrëveshje për të riblerë një aktiv financiar është lidhur në të njëjtën kohë me një marrëveshje të riblerjes së të njëjtit aktiv me një çmim fiks ose çmim shitjeje plus kthimin e huadhënësit, atëherë aktivi nuk çregjistrohet.

f) Opsionet e shitjes dhe të blerjes që janë tërësisht në mjete monetare. Nëse një aktiv financiar i transferuar mund të kërkohet përsëri nga transferuesi dhe opsioni i blerjes është tërësisht në mjete monetare, transferimi nuk kualifikohet për çregjistrim, sepse transferuesi ka ruajtur kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë. Në mënyrë të ngjashme, në qoftë se aktivi financiar mund të kthehet përsëri nga i transferuari dhe opsioni i kthimit është tërësisht në mjete monetare, transferimi nuk kualifikohet për çregjistrim, sepse transferuesi ka ruajtur kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë.

g) Opsionet e shitjes dhe të blerjes që janë tërësisht pa mjete monetare. Një aktiv financiar i transferuar çregjistrohet kur është objekt vetëm i një opsioni kthimi tërësisht pa mjete monetare i mbajtur nga i transferuari ose i një opsioni blerjeje tërësisht pa mjete monetare i mbajtur nga transferuesi. Kjo për shkak se transferuesi ka transferuar kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë.

h) Aktive lehtësisht të arritshëm që janë objekt i një opsioni blerjeje që nuk është as tërësisht në mjete monetare as tërësisht pa mjete monetare. Nëse një njësi ekonomike ka një opsion blerjeje për një aktiv që është lehtësisht i arritshëm në treg dhe opsioni nuk është as tërësisht në mjete monetare, as tërësisht pa mjete monetare, aktivi nuk çregjistrohet. Kjo për shkak se njësi ekonomike: i) as ka ruajtur, as ka transferuar kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë; dhe ii) nuk ka ruajtur kontrollin. Megjithatë, në qoftë se aktivi nuk është lehtësisht i arritshëm në treg, çregjistrimi nuk bëhet në masën e shumës së aktivitetit që është objekt i opsionit të blerjes, sepse njësi ekonomike ka ruajtur kontrollin e aktivitetit.

i) Një aktiv jo lehtësisht i arritshëm objekt i një opsioni kthimi i shkruar nga një njësi ekonomike që nuk është as tërësisht me mjete monetare, as tërësisht pa mjete monetare. Nëse një njësi ekonomike transferon një aktiv financiar që nuk është lehtësisht i arritshëm në treg, dhe shkruan një opsion që nuk është tërësisht pa mjete monetare, ajo nuk ruan as nuk transferon kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë për shkak të opsionit të kthimit me shkrim. Njësi ekonomike ruan kontrollin e aktivitetit, nëse opsioni i kthimit është mjaft i vlefshëm për të parandaluar shitjen e aktivitetit nga i transferuari, rast në të cilin aktivi vazhdon të njihet deri në masën e përfshirjes së vazhdueshme të transferuesit (shih paragrafin B3.2.9). Njësi ekonomike transferon kontrollin e aktivitetit, nëse opsioni i kthimit nuk është mjaftueshëm i vlefshëm për të parandaluar shitjen e aktivitetit nga i transferuari, rast në të cilin aktivi nuk çregjistrohet.

j) Aktivitetet që janë objekt i një opsioni shitjeje apo blerjeje me vlerë të drejtë ose i një marrëveshjeje të ardhshme riblerjeje. Një transferim i një aktiviteti financiar që i nënshtrohet vetëm një opsion i kthimi apo blerjeje ose një marrëveshjeje riblerjeje të ardhshme që ka një çmim të ushtrimit të opsionit ose riblerjes të barabartë me vlerën e drejtë të aktivitetit financiar në kohën e riblerjes bën të mundur çregjistrimin, për shkak të transferimit kryesisht të të gjitha rreziqeve dhe përfitimeve të pronësisë.

k) Opsionet e shitjes ose të blerjes të shlyera me mjete monetare. Një njësi ekonomike vlerëson transferimin e një aktiviteti financiar, që është objekt i një opsioni kthimi apo blerjeje ose i një marrëveshjeje të ardhshme riblerjeje, që do të shlyhet neto në mjete monetare, për të përcaktuar nëse ka ruajtur ose transferuar kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë. Nëse njësi ekonomike nuk ka ruajtur kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivitetit të transferuar, ajo përcakton nëse ka ruajtur kontrollin e aktivitetit të transferuar. Fakti që opsioni i blerjes apo kthimit ose marrëveshja e ardhshme e riblerjes shlyhet për neto në mjete monetare nuk do të thotë automatikisht se njësi ekonomike e ka transferuar kontrollin (shih paragrafët B3.2.9 dhe “g”, “h” dhe “i” më sipër).

l) Heqja e kushtit të shlyerjes. Një heqje e kushtit të shlyerjes është një opsion riblerjeje i pakushtëzuar që i jep një njësi ekonomike të drejtën të kërkojë aktivitetet e transferuara që janë objekt i disa kufizimeve. Me kusht që një opsion i tillë nuk çon në mbajtjen dhe as në transferimin thelbësisht të të gjitha rreziqeve dhe përfitimeve të pronësisë nga njësi ekonomike, çregjistrimi përjashtohet vetëm

deri në masën e shumës së subjektit të riblerjes (duke supozuar se i transferuari nuk mund të shesë aktivet). Për shembull, në qoftë se vlera kontabël dhe të ardhurat nga transferimi i aktiveve të kredisë janë 100,000 NJM, dhe çdo kredi individuale mund të rimerret përsëri, por shuma e përgjithshme e kredive që do të mund të riblihen nuk mund të kalojë 10,000 NJM, shuma prej 90,000 NJM e kredive do të kualifikohet për çregjistrim.

m) Opsion me balancë minimale. Një njësi ekonomike, e cila mund të jetë një transferues, që shërben aktive të transferuara mund të mbajë një opsion me balancë minimale për të blerë aktivet e transferuara të mbetura kur shuma e aktiveve të papaguara bie në një nivel të caktuar në të cilin kostoja e shërbimit e këtyre aktiveve bëhet e madhe në raport me përfitimet e shërbimit. Me kusht që një opsion i tillë bën që njësi ekonomike as të mos ruajë, as të mos transferojë kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe i transferuari nuk mund të shesë aktivet, çregjistrimi përjashtohet vetëm deri në masën e shumës së aktiveve që është objekt i opsionit të blerjes

n) Interesat e varur të mbajtura dhe garancitë e kredisë. Një njësi ekonomike mund t'i ofrojë të transferuarit zgjerimin e kredisë duke i dhënë në varësi disa ose të gjithë interesat e varur të saj të mbajtur në aktivin e transferuar. Nga ana tjetër, një njësi ekonomike mund t'i ofrojë të transferuarit zgjerimin e kredisë në formën e një garancie kredie që do të mund të ishte e pakufizuar ose e kufizuar në një shumë të caktuar. Nëse njësi ekonomike ruan kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit të transferuar, aktivi vazhdon të njihet në tërësinë e tij. Nëse njësi ekonomike mban disa, por jo thelbësisht të gjitha, rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe e ka mbajtur kontrollin, çregjistrimi nuk bëhet deri në masën e shumës së mjeteve monetare ose aktiveve të tjera që mund t'i kërkohet njësisë ekonomike të paguajë.

o) E ardhura gjithsej e kontratave të shkëmbimit. Një njësi ekonomike mund të shesë një aktiv financiar tek i transferuari dhe të lidhë një kontratë shkëmbimi, ku të gjitha flukset monetare të pagesës së interesave nga aktivi bazë i kalojnë njësisë ekonomike në këmbim të një pagese fikse ose me normë variabël dhe çdo rritje ose rënie në vlerën e drejtë të aktivit bazë amortizohet nga njësi ekonomike. Në një rast të tillë, është i ndaluar çregjistrimi i të gjitha aktiveve.

p) Kontratat e shkëmbimit për normat e interesit. Një njësi ekonomike mund të transferojë tek i transferuari një aktiv financiar me normë fikse dhe të lidhë me të transferuarin një kontratë shkëmbimi të normës së interesit për të marrë një normë interesi fikse dhe të paguajë një normë interesi të ndryshueshme të bazuar në një shumë të supozuar që është e barabartë me shumën e principalit të aktivit financiar të transferuar. Kontrata e shkëmbimit të normave të interesit nuk e përjashton çregjistrimin e aktivit të transferuar nëse pagesat për kontratën e shkëmbimit nuk janë të kushtëzuara nga pagesat që bëhen për aktivin e transferuar.

q) Amortizimi i kontratave të shkëmbimit të normës së interesit. Një njësi ekonomike mund të transferojë tek i transferuari një aktiv financiar me normë fikse që paguhet me kalimin e kohës, dhe të lidhë një kontratë shkëmbimi me të transferuarin për të marrë një normë interesi fikse dhe të paguajë një normë interesi të ndryshueshme bazuar në një shumë të supozuar. Nëse shuma e supozuar e kontratës amortizohet në mënyrë që ajo të jetë e barabartë me shumën e principalit të aktivit financiar të transferuar të papaguar në çdo moment kohor, kontrata e shkëmbimit në përgjithësi do të bëjë që njësi ekonomike të mbajë kryesisht rrezikun e parapagimit, rast në të cilin njësi ekonomike ose vazhdon të njohë të gjithë aktivin e transferuar ose vazhdon të njohë aktivin e transferuar në masën e përfshirjes së vazhdueshme. Në anën tjetër, nëse amortizimi i shumës së supozuar të kontratës së shkëmbimit nuk është i lidhur me shumën e principalit të papaguar të aktivit të transferuar, një kontratë shkëmbimi e tillë nuk do të çojë në mbajtjen e rrezikut të parapagimit mbi aktivin. Për këtë arsye, nuk përjashtohet çregjistrimi i aktivit të transferuar me kusht që pagesat për kontratën nuk janë të kushtëzuara nga pagesat e interesit të bëra për aktivin e transferuar dhe kontrata nuk çon në mbajtjen nga njësi ekonomike të çfarëdo rreziqeve dhe përfitimeve të tjera të rëndësishme të pronësisë mbi aktivin e transferuar.

B3.2.17 Ky paragraf ilustron zbatimin e metodës së përfshirjes së vazhdueshme kur kjo përfshirje e njësisë ekonomike është në një pjesë të një aktivi financiar.



Supozojmë se një njësi ekonomike ka një portofol kredish të parapagueshme me kupon dhe normë interesi efektive 10 për qind, dhe që shuma e principalit dhe kostoja e amortizuar është 10,000 NJM. Ajo hyn në një transaksion në të cilin, në këmbim të një pagese prej 9,115 NJM, i transferuari fiton të drejtën e arkëtimit për 9,000 NJM të principalit plus interesin mbi të për 9.5 për qind. Njësia ekonomike ka të drejtën e arkëtimit për 1,000 NJM të principalit plus interesin 10 për qind mbi të, plus marzhin e tepërt prej 0.5 për qind mbi shumën e mbetur 9,000 NJM të principalit. Arkëtimet nga parapagimet shpërndahen midis njësisë ekonomike dhe të transferuarit në mënyrë proporcionale në raportin 1:9, por çdo mospagim zbritet nga interesi 1,000 NJM i njësisë ekonomike deri sa ai të shterojë. Vlera e drejtë e kredive në datën e transaksionit është 10,100 NJM dhe vlera e drejtë e vlerësuar e marzhit të tepërt prej 0.5 për qind është 40 NJM.

Njësia ekonomike përcakton se i ka transferuar disa rreziqe dhe përfitime të konsiderueshme të pronësisë (për shembull, rrezikun e rëndësishëm të parapagimit), por ka ruajtur edhe disa rreziqe dhe përfitime të konsiderueshme të pronësisë (për shkak të interesit vartës të mbajtur të saj), si dhe ka mbajtur kontrollin. Për këtë arsye ajo zbaton metodën e përfshirjes së vazhdueshme.

Për të zbatuar këtë SNRF, njësia ekonomike analizon transaksionet si: a) një mbajtje të një interesi të plotë proporcional të ruajtur për 1,000 NJM; plus b) vartësinë e këtij interesi të mbajtur për të siguruar shtimin e kredisë të marrësi për humbjet nga kredia.

Njësia ekonomike llogarit se 9,090 NJM (90 për qind \times 10,100 NJM) e shumës së marrë 9,115 NJM përfaqëson shumën për pjesën plotësisht proporcionale prej 90 për qind. Pjesa e mbetur e shumës së arkëtuar (25 NJM) përfaqëson shumën e arkëtuar për interesin e saj vartës të mbajtur për të siguruar zgjerimin e kredisë të marrësi për humbjet nga kredia. Përveç kësaj, marzhi i tepërt prej 0,5 për qind paraqet shumën e arkëtuar për shtim kredie. Prandaj, shuma totale e arkëtuar për shtim kredie është 65 NJM (25 NJM + 40 NJM).

Njësia ekonomike llogarit fitimin ose humbjen nga shitja e 90 për qind e flukseve të mjeteve monetare. Duke supozuar se vlerat e drejta e veçanta të pjesës prej 90 për qind të transferuar dhe pjesës 10 për qind të mbajtur nuk janë të disponueshme në datën e transferimit, njësia ekonomike shpërndan vlerën kontabël të aktivitetit në përputhje me paragrafin 3.2.14 si vijon:

	Vlera e drejtë e vlerësuar	Përqindja	Vlera kontabël e shpërndarë
Pjesa e transferuar	9,090	90%	9,000
Pjesa e mbajtur	1,010	10%	1,000
Totali	10,100		10,000

Njësia ekonomike llogarit fitimin ose humbjen e saj nga shitja e pjesës prej 90 për qind të flukseve të mjeteve monetare duke zbritur vlerën kontabël të shpërndarë të pjesës së transferuar nga shuma e arkëtuar, d.m.th. 90 NJM (9,090 NJM - 9,000 NJM). Vlera kontabël të pjesës së mbajtur nga njësia ekonomike është 1,000 NJM.

Përveç kësaj, njësia ekonomike njih përfshirjen e vazhdueshme që rezulton nga vartësia e interesit të saj të mbajtur për humbjet e kredisë. Prandaj, ajo njih një aktiv për 1,000 NJM (shuma maksimale e mjeteve monetare që nuk do të ketë nën vartësi), dhe një pasiv të lidhur për 1,065 NJM (e cila është shuma maksimale e mjeteve monetare që nuk do të ketë nën varësi, d.m.th. 1,000 NJM plus vlerën e drejtë të varësisë për 65 NJM).

Njësia ekonomike përdor të gjitha të dhënat e mësipërme për ta trajtuar transaksionin si në vijim:

	Debi	Kredi
Aktivi fillestar	-	9,000
Aktivi i njohur për varësinë ose interesin e mbetur	1,000	-
Aktivi për shumën e arkëtuar në formën e marzhit të tepërt	40	-
Fitim ose humbje (fitim neto nga transferimi)	-	90
Pasivi	-	1,065
Mjete monetare të arkëtuara	9,115	-
Totali	10,155	10,155

Menjëherë pas kryerjes së transaksionit, vlera kontabël e aktivit është 2040 NJM e përbërë nga 1,000 NJM, që paraqet koston e shpërndarë të pjesës së mbajtur dhe 1,040 NJM, që përfaqëson përfshirjen shtesë të vazhdueshme të njësisë ekonomike nga vartësia e interesit të saj të mbajtur për humbjet e kredisë (i cili përfshin marzhin e tepërt për 40NJM).

Në periudhat e mëvonshme, njësia ekonomike njih shumën e arkëtuar për shtim kredie (65 NJM) në proporcion me kohën, konstaton interesin e aktivit të njohur duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe njih çdo zhvlerësim kredie për aktivet e njohura. Si një shembull të këtij të fundit, supozojmë se në vitin e ardhshëm ka një humbje nga zhvlerësimi për kreditë bazë prej 300 NJM. Njësia ekonomike zvogëlon aktivin e vet të njohur me 600 NJM (300 NJM në lidhje me interesin e saj të mbajtur dhe 300 NJM në lidhje me përfshirjen shtesë të vazhdueshme që rrjedh nga varësia e interesit të saj të mbajtur për humbjet e kredisë) dhe zvogëlon pasivin e saj të njohur me 300 NJM. Rezultati neto ngarkohet në fitim ose humbje për zhvlerësimin e kredisë për 300 NJM.

Çregjistrimi i pasiveve financiare (seksioni 3.3)

B3.3.1 Një pasiv financiar (ose pjesë e tij) çregjistrohet kur debitori ose:

a) zvogëlon pasivin (ose pjesë të tij), duke paguar kreditorin, normalisht me mjete monetare, aktive të tjera financiare, mallra ose shërbime; ose

b) është shkarkuar ligjërisht nga përgjegjësia kryesore për pasivin (ose pjesë të tij) ose nga procesi i ligjit ose nga kreditori. (Në qoftë se debitori ka dhënë një garanci ky kusht mund të vazhdojë të jetë ende.)

B3.3.2 Nëse një emetues i një instrumenti borxhi e riblen këtë instrument, borxhi shlyhet edhe në qoftë se emetuesi është një krijues tregu në këtë instrument ose ka për qëllim ta rishesë atë në të ardhmen e afërt.

B3.3.3 Pagesa për një palë të tretë, duke përfshirë besimin (që nganjëherë quhet “klauzolë për anulim borxhi”) nuk përbën në vetvete çlirimin e debitorit nga detyrimi i tij kryesor ndaj kreditorit, në mungesë të lirimit ligjor.

B3.3.4 Nëse një debitor paguan një palë të tretë për të marrë përsipër një detyrim dhe njofton kreditorin e tij që pala e tretë ka marrë përsipër detyrimin e borxhit të tij, debitori nuk e çregjiston detyrimin e borxhit përveç rastit kur plotësohet kushti në paragrafin B3.3.1 (b). Në qoftë se debitori paguan një palë të tretë për të marrë përsipër një detyrim dhe lirohet ligjërisht nga kreditori i tij, debitori çlirohet nga borxhi. Megjithatë, në qoftë se debitori bie dakord për t’ia bërë pagesat e borxhit palës së tretë ose drejtpërdrejt kreditorit të tij fillestar, debitori njih një detyrim të ri për borxhin ndaj palës së tretë.

B3.3.5 Edhe pse lirimi ligjor, qoftë juridikisht ose nga kreditori, ka si rezultat çregjistrimin e një pasivi, njësia ekonomike mund të njohë një pasiv të ri nëse nuk janë plotësuar kriteret në paragrafët 3.2.1-3.2.23 për çregjistrimin e aktiveve financiare të transferuara. Nëse këto kriteret nuk janë



përmbushur, aktivet e transferuara nuk çregjistrohen, dhe njësia ekonomike njeh një pasiv të ri lidhur me aktivet e transferuara.

B3.3.6 Për qëllim të paragrafit 3.3.2, kushtet janë në thelb të ndryshme në qoftë se vlera aktuale e skontuar e flukseve të mjeteve monetare në bazë të kushteve të reja, duke përfshirë çfarëdo pagese neto të çdo tarife të marrë dhe të skontuar, duke përdorur normën fillestare të interesit efektiv, është të paktën 10 për qind e ndryshme nga vlera aktuale e skontuar e flukseve të mjeteve monetare të mbetura të detyrimit financiar fillestar. Nëse një shkëmbim i instrumenteve të borxhit ose modifikim i termave trajtohet si një shlyerje, çdo kosto ose pagesë e bërë njihet si pjesë e fitimit ose humbjes neto nga shuarja e borxhit. Në qoftë se shkëmbimi apo modifikim nuk është trajtuar si një shlyerje, çdo kosto ose pagesë e bërë rregullon vlerën kontabël të pasivit dhe amortizohet për periudhën e mbetur të pasivit të modifikuar.

B3.3.7 Në disa raste, një kreditor e liron një debitor nga detyrimi i tij aktual për të bërë pagesa, por debitori merr përsipër një detyrim garancie për të paguar nëse pala që ka marrë përgjegjësinë kryesore nuk i plotëson zotimet e veta. Në këto rrethana debitori:

- a) njeh një pasiv financiar të ri të bazuar në vlerën e drejtë të detyrimit të tij për garanci; dhe
- b) njeh një fitim ose humbje neto të bazuar në diferencën midis: i) të gjitha shumave të paguara; dhe ii) vlerës kontabël të pasivit financiar fillestar minus vlerën e drejtë të pasivit të ri financiar.

Klasifikimi (kapitulli 4)

Klasifikimi i aktiveve financiare (seksioni 4.1)

Modeli i biznesit të njësisë ekonomike për menaxhimin e aktiveve financiare

B4.1.1 Paragrafi 4.1.1 a) kërkon që një njësi ekonomike të klasifikojë më pas aktivet financiare me koston e amortizuar ose me vlerën e drejtë në bazë të modelit të biznesit për menaxhimin e aktiveve financiare. Një njësi ekonomike vlerëson nëse aktivet financiare e plotësojnë këtë kusht në bazë të qëllimit të modelit të biznesit, siç përcaktohet nga personeli drejtues kryesor i njësisë ekonomike (siç përkufizohet në SNK 24).

B4.1.2 Modeli i biznesit të njësisë ekonomike nuk varet nga qëllimet e drejtimit për një instrument individual. Prandaj, ky kusht nuk është një mënyrë për të bërë klasifikimin instrument për instrument dhe duhet të përcaktohet në një nivel më të lartë grupimi. Megjithatë, një njësi ekonomike e veçantë, mund të ketë më shumë se një model biznesi për menaxhimin e instrumenteve të saj financiare. Prandaj, klasifikimi nuk duhet të përcaktohet në nivelin e njësisë raportuese. Për shembull, një njësi ekonomike mund të mbajë një portofol të investimeve që menaxhon në mënyrë që të mbledhë flukset kontraktuale të mjeteve monetare dhe një tjetër portofol investimesh që ajo e menaxhon në mënyrë që ta tregtojë për të realizuar ndryshimet e vlerës së drejtë.

B4.1.3 Edhe pse objektivi i modelit të biznesit të një njësie ekonomike mund të jetë për të mbajtur aktive financiare në mënyrë që të mbledhë flukse kontraktuale të mjeteve monetare, njësia ekonomike nuk duhet të mbajë të gjitha këto instrumente deri në maturim. Kështu, modeli i biznesit i një njësie ekonomike mund të jetë për të mbajtur aktivet financiare që të mbledhë flukse kontraktuale monetare, edhe kur ndodh shitja e aktiveve financiare. Për shembull, njësia ekonomike mund të shesë një aktiv financiar nëse:

- a) aktivi financiar nuk është në përputhje me politikën e investimeve të njësisë ekonomike (p.sh. në klasifikimin e kredisë aktivi është më poshtë seç kërkohet nga politika e investimeve e njësisë ekonomike);
- b) një sigurues përshtat portofolin e investimeve për të pasqyruar një ndryshim në kohëzgjatjen e pritshme (d.m.th. kohën e pritshme të pagesave); ose
- c) një njësi ekonomike ka nevojë për të financuar shpenzimet kapitale.

Megjithatë, në qoftë se janë bërë më shumë se a disa shitje nga një "portofol", njësia ekonomike duhet të vlerësojë nëse, dhe si shitje të tilla janë në përputhje me qëllimin e mbledhjes së flukseve monetare kontraktuale.

B4.1.4 Në vijim janë shembujt se kur mund të jetë objektivi i modelit të biznesit të një njësie ekonomike për të mbajtur aktive financiare që të mbledhë flukse monetare kontraktuale. Kjo listë e shembujve nuk është përfundimtare.

Shembulli

Analiza

Shembulli 1

Një njësi ekonomike ka investime për të mbledhur flukse monetare kontraktuale, por do ta shiste një investim në rrethana të veçanta.

Edhe pse një njësi ekonomike mund të marrë parasysh, ndër të dhëna të tjera, vlerën e drejtë të aktiveve financiare nga këndvështrimi i likuiditetit (d.m.th. shuma monetare që do të realizohej nëse njësia ekonomike duhet t'i shesë aktivet) qëllimi i njësisë ekonomike është që të mbajë aktivet financiare dhe të mbledhë flukset monetare kontraktuale. Disa shitje nuk do të ishin në kundërshtim me këtë qëllim.

Shembulli 2

Një model biznesi i një njësie ekonomike është blerja e portofolave të aktiveve financiare, të tilla si kreditë. Këta portofola mund ose nuk mund të përfshijnë aktive financiare me humbjet e shkaktuara të kredisë. Nëse pagesa për kreditë nuk bëhet në kohën e duhur, njësia ekonomike përpiqet të nxjerrë flukset monetare kontraktuale me mjete të ndryshme, për shembull duke kontaktuar me debitorin me telefon, postë elektronike ose metoda të tjera.

Objektivi i modelit të biznesit të njësisë ekonomike është që të mbajë aktivet financiare dhe të mbledhë flukset monetare kontraktuale. Njësia ekonomike nuk e blen portofolin që të realizojë një fitim nga shitja e tyre.

E njëjta analizë do të zbatohet edhe në qoftë se njësia ekonomike nuk pret të arkëtojë të gjitha flukset e mjeteve monetare kontraktuale (p.sh. disa prej aktiveve financiare kanë shkaktuar humbje kredie).

Në disa raste, njësia ekonomike hyn në kontrata këmbimi të normës së interesit për të ndryshuar normën e interesit për aktive financiare të veçanta në një portofol nga një normë interesi të ndryshueshme në një normë interesi fikse.

Për më tepër, fakti që njësia ekonomike mban derivativë për të modifikuar flukset e mjeteve monetare të portofolit, në vetvete, nuk ndryshon modelin e biznesit të njësisë ekonomike. Nëse portofoli nuk menaxhohet në bazë të vlerës së drejtë, objektivi i modelit të biznesit mund të jetë mbajtja e aktiveve për të arkëtuar flukset monetare kontraktuale.

Shembulli 3

Një njësi ekonomike ka një model biznesi me objektivin e krijimit të kredive për klientët dhe më pas për t'ia shitur këto kredi një agjenti krijues instrumentesh financiare. Agjenti i emeton instrumentet tek investitorët.

Grupi i konsoliduar i krijon kreditë me objektivin e mbajtjes së tyre për të mbledhur flukse monetare kontraktuale.

Njësia ekonomike krijuese kontrollon agjentin dhe kështu e konsolidon atë.

Megjithatë, njësia ekonomike krijuese ka një objektivi të realizimit të flukseve monetare nga portofoli i kredisë duke ia shitur kreditë agjentit, kështu që menaxhimi i këtij portofoli për të mbledhur flukset monetare kontraktuale nuk do të konsiderohet për qëllime të pasqyrave financiare individuale.

Agjenti mbledh flukset monetare kontraktuale nga kreditë dhe i kalon ato tek investitorët.

Supozohet për qëllime të këtij shembulli se kreditë vazhdojnë të njihen në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar, sepse ato nuk janë çregjistruar nga agjenti.



B4.1.5 Një model biznesi, në të cilin objektivi nuk është mbajtja e instrumenteve për të mbledhur flukse monetare kontraktuale, është kur një njësi ekonomike menaxhon performancën e një portofoli aktivesh financiare me qëllim realizimin e flukseve të mjeteve monetare nëpërmjet shitjes së aktiveve. Për shembull, nëse një njësi ekonomike në mënyrë aktive menaxhon një portofol aktivesh për të realizuar ndryshimet e vlerës së drejtë që rrjedhin nga ndryshimet në marzhin e kredisë dhe kurbën e të ardhurave, modeli i biznesit të saj nuk është mbajtja e këtyre aktiveve për të mbledhur flukse monetare kontraktuale. Objektivi i njësisë ekonomike çon në blerjen dhe shitjen aktive të instrumenteve që menaxhohen për të realizuar përfitime nga vlera e drejtë në vend të mbledhjes së flukseve monetare kontraktuale.

B4.1.6 Një portofol aktivesh financiare që menaxhohet dhe performanca e të cilit vlerësohet në bazë të vlerës së drejtë (siç përshkruhet në paragrafin 4.2.2 (b)) nuk mbahet për të mbledhur flukse monetare kontraktuale. Gjithashtu, një portofol aktivesh financiare që plotëson përkufizimin si i mbajtur për tregtim nuk mbahet për të mbledhur flukset monetare kontraktuale. Portofola instrumentesh të tillë duhet të maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Flukset e mjeteve monetare kontraktuale, të cilat janë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar

B4.1.7 Paragrafi 4.1.1 kërkon që njësi ekonomike (nëse nuk zbatohet paragrafi 4.1.5) të klasifikojë një aktiv financiar të matur më pas me koston e amortizuar ose vlerën e drejtë në bazë të karakteristikave të fluksit monetar kontraktual të aktivitetit financiar që është në një grup aktivesh financiare të menaxhuara për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale.

B4.1.8 Një njësi ekonomike do të vlerësojë nëse flukset monetare kontraktuale janë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar në monedhën me të cilën aktiviteti financiar është shprehur (shih, gjithashtu, paragrafin B5.7.2).

B4.1.9 Leva është një karakteristikë e fluksit monetar kontraktual të disa aktiveve financiare. Leva rrit ndryshueshmërinë e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale, të cilat nuk kanë karakteristikat ekonomike të interesit. Opsioni i veçuar dhe kontratat e ë ardhmes janë shembuj të aktiveve financiare që përfshijnë levën. Kështu, kontratat e tilla nuk i plotësojnë kushtet në paragrafin 4.1.2 (b) dhe nuk mund të maten më pas me koston e amortizuar.

B4.1.10 Dispozitat kontraktuale që lejojnë emetuesin (d.m.th. debitorin) të parapaguajë një instrument borxhi (p.sh. një kredi apo një obligacion) ose lejojnë mbajtësin (d.m.th. kreditorin), që t'ia kthejë emetuesit një instrument borxhi para maturimit çojnë në flukse monetare kontraktuale, që janë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar, vetëm nëse:

- a) dispozita nuk është e kushtëzuar nga ngjarjet në të ardhmen, përveç për të mbrojtur:
 - i) mbajtësin kundrejt përkeqësimit të kredisë të emetuesit (p.sh. mospagesat në afat, zvogëlimi i kredisë apo shkelja e marrëveshjes së huas) ose një ndryshimi në kontrollin e emetuesit; ose
 - ii) mbajtësin ose emetuesin kundrejt ndryshimeve në ligjin përkatës, ose tatimin; dhe
- b) shumën e papagimit në thelb paraqet shumën e papaguara të principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar, e cila mund të përfshijë kompensim të arsyeshëm shtesë për përfundimin para kohe të kontratës.

B4.1.11 Dispozitat kontraktuale që lejojnë emetuesin ose mbajtësin të zgjasë afatin kontraktual të një instrumenti borxhi (d.m.th. një opsion zgjatjeje afati) rezultojnë në flukse monetare kontraktuale që janë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar, vetëm nëse:

- a) dispozita nuk kushtëzohet nga ngjarjet në të ardhmen, përveç për të mbrojtur:
 - i) mbajtësin nga përkeqësimi i kredisë së emetuesit (p.sh. mospagesat në afat, zvogëlimi i kredisë apo shkelja e marrëveshjes së huas) ose nga një ndryshim në kontrollin të emetuesit; ose
 - ii) mbajtësin ose emetuesin kundrejt ndryshimeve në ligjin përkatës ose tatimin; dhe
- b) kushtet e opsionit të zgjatjes së afatit çojnë në flukse monetare kontraktuale gjatë periudhës së zgjatjes së afatit që janë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar.

B4.1.12 Një term kontraktual që ndryshon kohëzgjatjen apo madhësinë e pagesave të principalit ose të interesit nuk do të rezultojë në flukse monetare kontraktuale që janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi shumën e papaguar të principalit përveç nëse:

a) është një normë e ndryshueshme interesi që merr parasysh vlerën në kohë të parasë dhe rrezikun e kredisë (e cila mund të përcaktohet vetëm në njohjen fillestare, dhe kështu mund të jetë fikse) e lidhur me shumën e principalit të papaguar; dhe

b) nëse termi kontraktual është një opsion parapagimi, plotëson kushtet në paragrafin B4.1.10; ose

c) nëse termi kontraktual është një opsion zgjatjeje afati, plotëson kushtet në paragrafin B4.1.11.

B4.1.13 Shembujt e mëposhtëm ilustrjnë flukset monetare kontraktuale që janë vetëm pagesat e principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar. Kjo listë e shembujve nuk është përfundimtare.

Instrumenti

Analiza

Instrumenti A

Instrumenti A është një obligacion me një datë maturimi të deklaruar. Pagesat e principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar janë të lidhura me një indeks inflacioni të monedhës në të cilën instrumenti është emetuar. Lidhja e inflacionit nuk ka ndikim dhe principalit është i mbrojtur.

Flukset monetare kontraktuale janë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar. Zinxhiri i pagesave të principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar me një indeks inflacioni të pandikueshëm rregullon vlerën në kohë të parasë në një nivel aktual. Me fjalë të tjera, norma e interesit për instrumentin pasqyron interesin “e vërtetë”. Kështu, shumat e interesit janë shuma për vlerën në kohë të parasë mbi shumën e principalit të papaguar.

Megjithatë, në qoftë se pagesat e interesit janë indeksuar në një tjetër variabël, si performanca e debitorit (p.sh. të ardhurat neto të debitorit) ose një tregues i kapitalit neto, flukset monetare kontraktuale nuk janë pagesat e principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar. Kjo për shkak se pagesat e interesit nuk janë shuma për vlerën në kohë të parasë dhe për rrezikun e kredisë të lidhura me shumën e principalit të papaguar. Ekziston një ndryshueshmëri në pagesat e interesit kontraktual që është në kundërshtim me normat e interesit të tregut.

Instrumenti B

Instrumenti B është një instrument me normë interesi variabël me një datë maturimi të deklaruar që e lejon huamarrësin të zgjedhë normën e interesit të tregut mbi një bazë të vazhdueshme. Për shembull, në çdo datë të rivënies së normës së interesit, huamarrësi mund të zgjedhë të paguajë LIBOR tremujor për një afat prej tre muajsh ose LIBOR njëmuajor për një afat prej një muaji.

Flukset monetare kontraktuale janë vetëm pagesat e principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar për sa kohë që interesi i paguar mbi jetën e instrumentit pasqyron shumën për vlerën në kohë të parasë dhe për rrezikun e kredisë të lidhur me instrumentin. Fakti që norma e interesit LIBOR është rivendosur gjatë jetës së instrumentit në vetvete nuk e skualifikon instrumentin.

Megjithatë, në qoftë se huamarrësi është në gjendje të zgjedhë që të paguajë një muaj LIBOR për tre muaj dhe që ky LIBOR mujor nuk rivendoset në çdo muaj, flukset monetare kontraktuale nuk janë pagesa të principalit dhe të interesit.



E njëjta analizë do të zbatohet në qoftë se huamarrësi është në gjendje të zgjedhë mes normës variabël të interesit mujor të publikuar dhe asaj tremujore të huadhënësit.

Megjithatë, nëse instrumenti ka një normë interesi kontraktuale të bazuar në një afat që kalon jetën e mbetur të instrumentit, flukset monetare kontraktuale të tij nuk janë pagesat e principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar. Për shembull, një obligacion me maturim të vazhdueshëm me afat pesëvjeçar që paguan një normë variabël që rivendoset në mënyrë periodike, por gjithmonë pasqyron një maturim pesëvjeçar nuk rezulton në flukse monetare kontraktuale që janë pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar. Kjo është për shkak se interesi për t'u paguar në çdo periudhë është i shkëputur nga afati i instrumentit (përveç në fillim).

Instrumenti C

Instrumenti C është një obligacion me një datë maturimi të shpallur dhe paguhet një normë interesi variabël tregu. Kjo normë variabël e interesit ka një kufi maksimal.

Flukset monetare kontraktuale si të:

a) një instrumenti që ka një normë interesi fikse; dhe
b) një instrumenti që ka një normë interesi variabël; janë pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar për sa kohë që interesi pasqyron shumën për vlerën në kohë të parasë dhe për rrezikun e kredisë të lidhur me instrumentin gjatë afatit të tij.

Prandaj, një instrument që është një kombinim i (a) dhe (b) (p.sh. një obligacion me një normë interesi me kufi maksimal) mund të ketë flukse monetare të cilat janë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar. Një tipar i tillë mund të reduktojë ndryshueshmërinë e fluksit monetar duke vendosur një kufi mbi një normë interesi variabël (p.sh. një kufi maksimal apo minimal të normës së interesit) ose shton ndryshueshmërinë e fluksit monetar sepse një normë fikse bëhet variabël.

Instrumenti D

Instrumenti D është një kredi me rikthim të plotë dhe është siguruar me kolateral.

Fakti që një kredi me një kthim të plotë është e kolateralizuar në vetvete nuk ndikon në analizën nëse flukset monetare kontraktuale janë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar.

B4.1.14 Shembujt e mëposhtëm ilustrojnë flukset monetare kontraktuale që nuk janë pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar. Kjo listë e shembujve nuk është përfundimtare.

Instrumenti	Analiza
<p>Instrumenti E Instrumenti E është një obligacion që është i konvertueshëm me instrumente të kapitalit neto të emetuesit.</p>	<p>Mbajtësi do të analizojë obligacionin e konvertueshëm në tërësinë e tij. Flukset e mjeteve monetare kontraktuale nuk janë pagesat e principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar, sepse norma e interesit nuk pasqyron shumën vetëm për vlerën në kohë të parasë dhe të rrezikut të kredisë Kthimi është i lidhur me vlerën e kapitalit neto të emetuesit.</p>
<p>Instrumenti F Instrumenti F është një hua që paguan një normë interesi të luhatshme të anasjelltë (d.m.th. norma e interesit ka një marrëdhënie të anasjelltë me normat e interesit të tregut).</p>	<p>Flukset e mjeteve monetare kontraktuale nuk janë vetëm pagesat e principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar. Shumat e interesit nuk janë shuma për vlerën në kohë të parasë mbi shumën e principalit të papaguar.</p>
<p>Instrumenti G Instrumenti G është një instrument borxhi i vazhdueshëm, por lëshuesi mund ta rimarrë instrumentin në çdo moment dhe t'i paguajë mbajtësit shumën nominale plus interesin e konstatuar. Instrumenti G paguan një normë interesi tregu, por pagesa e interesit nuk mund të bëhet nëse emetuesi është i aftë të paguajë menjëherë më vonë. Interesi i shtyrë nuk shkakton interes shtesë.</p>	<p>Flukset e mjeteve monetare kontraktuale nuk janë pagesat e principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar. Kjo për shkak se emetuesit mund t'i kërkohet të shtyjë pagesat e interesit dhe nuk do të ketë interesa shtesë mbi shumat e interesit të shtyrë. Si rezultat, shuma e interesit nuk janë shuma për vlerën në kohë të parasë mbi shumën e principalit të papaguar. Nëse interesi konstatohet mbi shumat e shtyra, flukset monetare kontraktuale mund të jenë pagesat e principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar. Fakti që instrumenti G është i vazhdueshëm në vetvete nuk do të thotë se flukset monetare kontraktuale nuk janë pagesat e principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar. Në fakt, një instrument i vazhdueshëm ka opsione të vazhdueshme (të shumta) të zgjatjes së afatit. Opsione të tilla mund të çojnë në flukse monetare kontraktuale që janë pagesat e principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar në qoftë se pagesat e interesit janë të detyrueshme dhe duhet të paguhet në mënyrë të përhershme. Gjithashtu, fakti që instrumenti G është i kërkueshëm nuk do të thotë se flukset monetare kontraktuale nuk janë pagesat e principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar, nëse nuk është i kërkueshëm në një shumë që nuk e pasqyron në thelb pagesën e principalit të papaguar dhe interesat mbi të . Edhe në qoftë se shuma e kërkueshme përfshin një shumë që kompenson mbajtësin për ndërprerjen para kohe të instrumentit, flukset monetare kontraktuale mund të jenë pagesat e principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar.</p>



B4.1.15 Në disa raste një aktiv financiar mund të ketë flukse kontraktuale monetare që janë përshkruar si principalit dhe interesi, por këto flukse të mjeteve monetare nuk përfaqësojnë pagesën e principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar siç përshkruhet në paragrafët 4.1.2 (b) dhe 4.1.3 të këtij SNRF-je.

B4.1.16 Ky mund të jetë rasti kur aktivi financiar përfaqëson një investim në aktive apo flukse monetare të veçanta dhe kështu flukset monetare kontraktuale nuk janë vetëm pagesat e principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar. Për shembull, flukset monetare kontraktuale mund të përfshijnë pagesa për faktorë të tjerë, përveçse shumën për vlerën në kohë të parasë dhe për rrezikun e kredisë të lidhur me shumën e principalit të papaguar gjatë një periudhe kohore të caktuar. Si rezultat, instrumenti nuk do të përmbushë kushtet në paragrafin 4.1.2 (b). Ky mund të jetë rasti kur një kërkesë e kreditorit është e kufizuar në aktive të specifikuara të debitorit ose flukse monetare nga aktivet e specifikuara (për shembull, një aktiv financiar “i pakthyesëm”).

B4.1.17 Megjithatë, fakti që një aktiv financiar është i pakthyesëm në vetvete nuk e përjashton domosdoshmërisht aktivin financiar nga plotësimi i kushtit në paragrafin 4.1.2 (b). Në situata të tilla, është e nevojshme që kreditori të vlerësojë (të njihet me) aktivet bazë të veçanta ose flukset monetare për të përcaktuar nëse flukset monetare kontraktuale të aktivit financiar të klasifikuar janë pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar. Në qoftë se kushtet e aktivit financiar çojnë në flukse monetare të tjera ose kufizojnë flukset e mjeteve monetare në një mënyrë që nuk është në pajtueshmëri me pagesat e principalit dhe të interesit, aktivi financiar nuk i plotëson kushtet në paragrafin 4.1.2 (b). Nëse aktivet bazë janë aktive financiare ose jofinanciare në vetvete nuk ndikojnë në këtë vlerësim.

B4.1.18 Nëse një karakteristikë e fluksit monetar kontraktual nuk është e vërtetë, kjo nuk ndikon në klasifikimin e një aktivit financiar. Një karakteristikë e fluksit monetar nuk është e vërtetë në qoftë se ajo ndikon në flukset monetare kontraktuale të instrumentit vetëm kur ndodh një ngjarje që është shumë e rrallë, tepër e parregullt dhe nuk ka shumë gjasa të ndodhë.

B4.1.19 Në pothuajse çdo transaksion kreditimi, instrumenti i kreditorit renditet në lidhje me instrumentet e kreditorëve të tjerë të debitorit. Një instrument që është në vartësi të instrumenteve të tjera mund të ketë flukse monetare kontraktuale që janë pagesat e principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar në qoftë se mospagesa nga ana e debitorit është një shkelje e kontratës dhe mbajtësi ka të drejtën kontraktuale mbi shumën e papaguara të principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar edhe në rast falimentimi të debitorit. Për shembull, një llogari e arkëtueshme tregtare që rendit kreditorin e saj si kreditor të përgjithshëm do të kualifikohet si pagesë e principalit dhe interesit mbi shumën principale të papaguar. Ky është rasti edhe nëse debitori jep kredi që janë të kolateralizuara, i cili në rast falimentimi do t'i japë prioritet mbajtësit të borxhit kundrejt pretendimeve të kreditorit të përgjithshëm në lidhje me kolateralin, por nuk ndikon në të drejtën kontraktuale të kreditorit të përgjithshëm për shumën e papaguar të principalit dhe shumave të tjera për t'u paguar.

Instrumentet e lidhura kontraktualisht

B4.1.20 Në disa lloje transaksionesh, një njësi ekonomike mund t'u japë përparësi pagesave për mbajtësit e aktiveve financiare duke përdorur instrumente të shumta të lidhura kontraktualisht që krijojnë përqendrim të rrezikut të kredisë (këstet). Çdo këst ka një renditje varësie që përcakton rendin në të cilin çdo fluks monetar i krijuar nga emetuesi i caktohet këstit. Në situata të tilla, mbajtësit e një kësti kanë të drejtën për pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar vetëm në qoftë se emetuesi gjeneron flukse monetare të mjaftueshme për t'u përgjigjur kësteve sipas renditjes më të lartë.

B4.1.21 Në transaksione të tilla, një këst ka karakteristikat e fluksit monetar që janë pagesat e principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar vetëm nëse:

a) kushtet kontraktuale të këstit të vlerësuar për klasifikim (pa shqyrtuar grupin bazë të instrumenteve financiare) shkaktajnë flukse monetare, të cilat janë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar (p.sh. norma e interesit për këstin nuk lidhet me një indeks të mallrave);

b) grupi bazë i instrumenteve financiare ka karakteristikat e fluksit monetar të përcaktuara në paragrafët B4.1.23 dhe B4.1.24; dhe

c) ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë në grupimin bazë të instrumenteve financiare të pandara në këste është i barabartë me ose më i ulët sesa ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë të grupimit bazë të instrumenteve financiare (për shembull, ky kusht do të plotësohet nëse grupi bazë i instrumenteve do të zvogëlohet me 50 për qind, si pasojë e humbjeve të kredisë dhe në të gjitha rrethanat kësti do të ulej 50 për qind ose më pak).

B4.1.22 Një njësi ekonomike duhet të kërkojë deri sa ajo mund të identifikojë grupin bazë të instrumenteve që krijojnë (jo t'i anashkalojë) flukse monetare. Ky është grupi themelor i instrumenteve financiare.

B4.1.23 Grupi bazë duhet të përmbajë një ose më shumë instrumente që kanë flukse monetare kontraktuale që janë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar.

B4.1.24 Grupi bazë i instrumenteve mund të përfshijë edhe instrumentet që:

a) pakësojnë ndryshueshmërinë e fluksit monetar të instrumenteve në paragrafin B4.1.23 dhe, kur kombinohet me instrumentet në paragrafin B4.1.23, çon në flukse monetare, të cilat janë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar (p.sh. një normë interesi maksimale apo minimale ose një kontratë që zvogëlon rrezikun e kredisë në disa ose të gjitha instrumentet në paragrafin B4.1.23); ose

b) lidh flukset monetare të kësteve me flukset e mjeteve monetare të grupit të instrumenteve bazë në paragrafin B4.1.23 për të adresuar diferencat në, dhe vetëm në:

i) normën e interesit kur është fikse apo e luhatshme;

ii) monedhën në të cilën janë të shprehura flukset e mjeteve monetare, duke përfshirë edhe inflacionin në këtë monedhë; ose

iii) afatin e flukseve monetare.

B4.1.25 Nëse ndonjë instrument në grup nuk i plotëson kushtet në paragrafin B4.1.23 ose paragrafin B4.1.24 nuk plotësohet kushti në paragrafin B4.1.21 (b).

B4.1.26 Nëse mbajtësi nuk mund të vlerësojë kushtet në paragrafin B4.1.21 në njohjen fillestare, kësti duhet të matet me vlerën e drejtë. Nëse grupi bazë i instrumenteve mund të ndryshojë pas njohjes fillestare në mënyrë të tillë që grupi nuk mund të plotësojë kushtet në paragrafët B4.1.23 dhe B4.1.24, kësti nuk i plotëson kushtet në paragrafin B4.1.21 dhe duhet të matet me vlerën e drejtë.

Opsioni për të përcaktuar një aktiv financiar ose pasiv financiar me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (nenet 4.1 dhe 4.2)

B4.1.27 Në përputhje me kushtet në paragrafët 4.1.5 dhe 4.2.2, ky SNRF lejon një njësi ekonomike të përcaktojë një aktiv financiar, një detyrim financiar, ose një grup të instrumenteve financiare (aktive financiare, detyrime financiare ose të dyja) me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes me kusht që duke vepruar kështu rezulton në një informacion më të përshtatshëm.

B4.1.28 Vendimi i një njësie ekonomike për të përcaktuar një aktiv financiar ose pasiv financiar me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes është i ngjashëm me një zgjedhje të politikës kontabël (edhe pse, ndryshe nga një zgjedhje e politikës kontabël, nuk është e nevojshme të zbatohet në mënyrë të qëndrueshme për të gjitha transaksionet e ngjashme). Kur njësi ekonomike mund të bëjë një zgjedhje të tillë, paragrafi 14 (b) i SNK 8 kërkon që politika e zgjedhur të çojë në pasqyra financiare që japin informacion më të besueshëm dhe më të rëndësishëm për efektet e transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve të tjera në pozicionin financiar të njësisë ekonomike, performancën financiare ose flukset monetare. Për shembull, në rastin e caktimit të një pasivi financiar, si pasiv me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, paragrafi 4.2.2 përcakton të dyja rrethanat kur duhet të plotësohet kërkesa për më shumë informacion përkatës. Prandaj, për të bërë këtë përcaktim në përputhje me paragrafin 4.2.2, njësi ekonomike duhet të tregojë se ajo është në një rreth (ose të dyja) prej këtyre dy rrethanave.

Përcaktimi eliminon apo redukton ndjeshëm një mospërputhje të kontabilitetit

B4.1.29 Matja e një aktivi financiar ose pasivi financiar dhe klasifikimi i ndryshimeve të njohura në vlerën e tij përcaktohet nga klasifikimi i elementit dhe nëse elementi është pjesë e një marrëdhënie



mbrojtëse të caktuar. Këto kërkesa mund të krijojnë një mospërputhje të matjes apo të njohjes (nganjëherë referuar si një “mospërputhje kontabël”) kur, për shembull në mungesë të përcaktimit me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, një aktiv financiar do të klasifikohet më pas si i matur me vlerën e drejtë dhe një pasiv që njësia ekonomike e konsideron të lidhur do të matej më pas me koston e amortizuar (pa njohur ndryshimet në vlerën e drejtë). Në rrethana të tilla, një njësi ekonomike mund të nxjerrë përfundimin se pasqyrat e saj financiare do të siguronin informacion më të përshtatshëm nëse edhe aktivi, dhe pasivi janë të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

B4.1.30 Shembujt e mëposhtëm tregojnë se kur mund të përmbushet ky kusht. Në të gjitha rastet, një njësi ekonomike mund ta përdorë këtë kusht për të përcaktuar aktivet financiare ose pasivet financiare me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes vetëm nëse plotëson parimin në paragrafin 4.1.5 ose 4.2.2 (a).

a) Një njësi ekonomike ka pasive sipas kontratave të sigurimit, matja e të cilave përfshin informacionin aktual (siç lejohet nga SNRF 4, paragrafi 24), ndërsa aktivet financiare, që konsiderohen të lidhura do të mateshin me koston e amortizuar.

b) Një njësi ekonomike ka aktive financiare, pasive financiare ose të dyja bashkë që kanë një rrezik, të tillë si rrezikun e normës së interesit, që shkakton ndryshime të kundërta në vlerën e drejtë që tentojnë të kompensojnë njëri-tjetrin. Megjithatë, vetëm disa nga instrumentet do të maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (d.m.th. janë derivativë ose janë të klasifikuar si të mbajtur për tregtim). Mund të jetë edhe rasti që kërkesat për kontabilitetin mbrojtës nuk janë plotësuar, për shembull për shkak se nuk janë plotësuar kërkesat për efektivitetin në paragrafin 88 të SNK 39.

c) Një njësi ekonomike ka aktive financiare, pasive financiare ose të dyja bashkë që kanë një rrezik, të tillë si rrezikun e normës së interesit, që shkakton ndryshime të kundërta në vlerën e drejtë, që tentojnë të kompensojnë njëri-tjetrin dhe njësia ekonomike nuk i kualifikon për kontabilitet mbrojtës për shkak se asnjë nga instrumentet nuk është një derivativ. Për më tepër, në mungesë të kontabilitetit mbrojtës ka një mospërputhje të konsiderueshme në njohjen e fitimeve dhe të humbjeve neto. Për shembull, njësia ekonomike ka financuar një grup të caktuar kredish duke emetuar obligacione tregtare me ndryshime në vlerën e drejtë që tentojnë të kompensojnë njëri-tjetrin. Nëse, përveç kësaj, njësia ekonomike blen dhe shet rregullisht obligacione, por rrallë ose ndonjëherë, blen dhe shet huat, raportimi si i huave, dhe i obligacioneve me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes eliminon mospërputhjen në momentin e njohjes së fitimeve dhe humbjeve neto që ndryshe do të rezultonin nga matja e tyre me koston e amortizuar dhe njohjen e një fitimi ose humbje çdo herë që një obligacion riblihet.

B4.1.31 Në raste të tilla, si ato të përshkruara në paragrafin e mësipërm, në njohjen fillestare, për të caktuar aktivet financiare dhe pasivet financiare që nuk maten ndryshe veçse me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes mund të eliminohen ose reduktohen ndjeshëm mospërputhjet e matjes ose të njohjes dhe të jepet më shumë informacion përkatës. Për qëllime praktike, njësia ekonomike nuk duhet të hyjë në të gjitha aktivet dhe pasivet duke shkaktuar mospërputhje për matjen apo njohjen pikërisht në të njëjtën kohë. Një vonesë e arsyeshme është e lejuar me kusht që çdo transaksion përcaktohet si me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në njohjen e tij fillestare dhe, në këtë kohë, çdo transaksion i mbetur pritet të ndodhë.

B4.1.32 Nuk do të ishte e pranueshme të përcaktohen vetëm disa prej aktiveve financiare dhe pasiveve financiare me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes që shkaktojnë mospërputhje nëse në këtë mënyrë nuk do të eliminohej ose të zvogëlohej ndjeshëm mospërputhja dhe pra nuk do të kishte më shumë informacion të përshtatshëm. Megjithatë, do të ishte e pranueshme të përcaktohen vetëm disa nga një numër aktivesh financiare të ngjashme ose pasivesh financiare të ngjashme, nëse duke vepruar kështu arrihet një zvogëlim i ndjeshëm (dhe ndoshta një ulje më e madhe se përcaktimet e tjera të lejueshme) i mospërputhjes. Për shembull, supozojmë një njësi ekonomike ka një numër pasivesh financiare të ngjashme me një shumë prej 100 NJM dhe një numër aktivesh financiare të ngjashme me një shumë prej 50 NJM, por që janë të matura në baza të ndryshme. Njësia ekonomike mund të zvogëlojë ndjeshëm mospërputhjen në matje, duke i përcaktuar në njohjen fillestare të gjitha aktivet, por vetëm disa nga pasivet (për shembull, pasivet individuale me një total të kombinuar prej 45 NJM) me vlerën e drejtë

nëpërmjet fitimit ose humbjes. Megjithatë, për shkak se përcaktimi si me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes mund të zbatohet vetëm për një instrument financiar në tërësi, njësia ekonomike në këtë shembull duhet të caktojë një ose më shumë pasive në tërësinë e tyre. Ajo nuk mund të përcaktojë ose një përbërës të një pasivi (p.sh. ndryshimet në vlerë që i takojnë vetëm një rreziku, të tilla si ndryshimet në normën e interesit bazë) ose një pjesë (d.m.th. përqindje) të një pasivi.

Një grup i pasiveve ose aktiveve financiare dhe i pasiveve financiare që menaxhohen dhe performanca e tyre vlerësohet mbi bazën e vlerës së drejtë

B4.1.33 Një njësi ekonomike mund të menaxhojë dhe të vlerësojë performancën e një grupi pasivesh financiare ose aktivesh financiare dhe pasivesh financiare, në mënyrë të tillë që duke matur këtë grup me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes merret një informacion më i përshtatshëm. Në këtë rast, fokusi është në mënyrën sesi njësia ekonomike menaxhon dhe vlerëson performancën, sesa në natyrën e instrumenteve financiare.

B4.1.34 Për shembull, një njësi ekonomike mund ta përdorë këtë kusht për të përcaktuar pasivet financiare me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes nëse plotëson parimin në paragrafin 4.2.2 (b) dhe njësia ekonomike ka aktive financiare dhe detyrime financiare që ndajnë një ose më shumë rreziqe dhe këto rreziqe janë të menaxhuara dhe vlerësohen në bazë të vlerës së drejtë, në përputhje me një politikë të dokumentuar të menaxhimit të aktiveve dhe pasiveve. Një shembull mund të jetë një njësi ekonomike që ka emetuar “produkte të strukturuar” që përmbajnë derivativë të shumtë të përfshirë dhe menaxhon rreziqet që rezultojnë mbi bazën e vlerës së drejtë duke përdorur një përzierje të instrumenteve derivative dhe financiare joderivative.

B4.1.35 Siç vërehet më sipër, ky kusht mbështetet në mënyrën se si njësia ekonomike menaxhon dhe vlerëson performancën e grupit të instrumenteve financiare në shqyrtim. Prandaj, një njësi ekonomike (subjekt i kërkesës së përcaktimit në njohjen fillestare) që i përcakton pasivet financiare me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në bazë të këtij kushti, do të përcaktojë të gjitha detyrimet e përshtatshme financiare që janë menaxhuar dhe vlerësuar së bashku.

B4.1.36 Dokumentimi i strategjisë së njësisë ekonomike nuk duhet të jetë gjithëpërfshirës, por duhet të jetë i mjaftueshëm për të dëshmuar përputhjen me paragrafin 4.2.2 (b). Dokumentimi i tillë nuk është i nevojshëm për çdo zë individual, por mund të jetë mbi një bazë portofoli. Për shembull, në qoftë se sistemi i menaxhimit të performancës për një departament, siç është miratuar nga personeli drejtues kryesor i njësisë ekonomike, tregon qartë se performanca e tij vlerësohet në bazë të kthimit total, nuk kërkohet dokumentim i mëtejshëm për të demonstruar pajtueshmërinë me paragrafin 4.2.2 (b).

Derivativët e përfshirë (seksioni 4.3)

B4.3.1 Kur një njësi ekonomike bëhet palë në një kontratë hibride me një instrument bazë që nuk është një aktiv brenda objektit të këtij SNRF, paragrafi 4.3.3 kërkon që njësia ekonomike të identifikojë çdo derivativ të përfshirë, të vlerësojë nëse është e nevojshme të jenë të ndarë nga kontrata bazë dhe për ata që kërkohet të jenë të ndarë, të maten derivativët me vlerën e drejtë në njohjen fillestare dhe më pas.

B4.3.2 Nëse një kontratë bazë nuk e ka deklaruar apo paracaktuar maturimin dhe paraqet një interes të mbetur në aktivet neto të një njësie ekonomike, atëherë karakteristikat e saj ekonomike dhe rreziqet janë ato të një instrumenti të kapitalit neto dhe një derivativ i përfshirë do të duhet të ketë karakteristikat e kapitalit që lidhen me të njëjtën njësi ekonomike që të konsiderohet si i lidhur ngushtë. Nëse kontrata bazë nuk është një instrument kapitali neto dhe plotëson përkufizimin e një instrumenti financiar, atëherë karakteristikat e saj ekonomike dhe rreziqet janë ato të një instrumenti borxhi.

B4.3.3 Një derivativ i përfshirë pa opsjon (i tillë si një kontratë e të ardhmes) ndahet nga kontrata bazë e tij mbështetur në kushtet thelbësore të paraqitura apo të nënkuptuara, në mënyrë që të ketë një vlerë të drejtë zero në njohjen fillestare. Një derivativ i përfshirë bazuar në opsjon (i tillë si një kontratë me opsjon kthimi, blerje, me kufi maksimal, kufi minimal ose shkëmbimi) ndahet nga kontrata bazë e tij mbështetur në kushtet e caktuara në funksion të opsjonit. Shuma fillestare kontabël e instrumentit bazë është shuma e mbetur pasi ndahet derivativi i përfshirë.



B4.3.4 Në përgjithësi, derivativët e shumëfishtë të përfshirë në një kontratë të vetme hibride trajtohen si një përbërës i vetëm i derivativit të përfshirë. Megjithatë, derivativët e përfshirë që klasifikohen si kapital neto (shih SNK 32) trajtohen veças nga ato të klasifikuar si aktive ose pasive. Përveç kësaj, nëse një kontratë hibride ka më shumë se një derivativ të përfshirë dhe këta derivativë lidhen me ekspozime të ndryshme ndaj rrezikut dhe janë lehtësisht të ndashëm dhe të pavarur nga njëri-tjetri, ata trajtohen veçmas nga njëri-tjetri.

B4.3.5 Karakteristikat ekonomike dhe rreziqet e një derivativi të përfshirë nuk janë të lidhura ngushtë me kontratën bazë (paragrafi 4.3.3 (a)) në shembujt e mëposhtëm. Në këta shembuj, duke supozuar se janë plotësuar kushtet në paragrafin 4.3.3 (b) dhe (c), një njësi ekonomike i trajton derivativët e përfshirë veçmas nga kontrata bazë.

a) Një kontratë me opSION të përfshirë në një instrument që i jep mundësi mbajtësit të kërkojë nga lëshuesi të riblejë instrumentin për një shumë mjetesh monetare ose aktivesh të tjera, që ndryshon në bazë të ndryshimit të çmimit të kapitalit ose të mallrave, ose indeksit, nuk është e lidhur ngushtë me një instrument borxhi bazë.

b) Një opSION apo një parashikim automatik për të zgjatur kohën e mbetur deri në maturim të një instrumenti borxhi nuk është i lidhur ngushtë me instrumentin bazë të borxhit nëse nuk ka një rregullim në harmoni me normën e përafërt aktuale të interesit të tregut në kohën e shtrirjes. Në qoftë se një njësi ekonomike emeton një instrument borxhi dhe mbajtësi i tij shkruan një opSION blerjeje për instrumentin e borxhit me një palë të tretë, emetuesi e trajton opSIONIN e blerjes si një zgjatje të afatit të maturimit të instrumentit të borxhit me kusht që emetuesit mund t'i kërkojë të marrë pjesë në ose të lehtësojë ritregtimin e instrumentit të borxhit, si rezultat i ushtrimit të opSIONIT.

c) Interesi i indeksuar i kapitalit ose pagesat e principalit të përfshira në një instrument borxhi ose në kontratën e sigurimit - me të cilin shuma e interesit ose e principalit është e indeksuar me vlerën e instrumenteve të kapitalit - nuk janë të lidhura ngushtë me instrumentin bazë, sepse rreziqet e natyrshme në derivativin bazë dhe të përfshirë janë të ndryshme.

d) Interesi i indeksuar i mallit ose pagesat e principalit të përfshirë në një instrument borxhi ose kontratës e sigurimit - me të cilin shuma e interesit ose principalit është indeksuar me çmimin e një malli (i tillë si ari) - nuk janë të lidhura ngushtë me instrumentin bazë për shkak se rreziqet e natyrshme në derivativin bazë dhe të përfshirë janë të ndryshme.

e) Një opSION blerjeje, kthimi apo parapagimi i përfshirë në një kontratë bazë borxhi ose kontratë bazë sigurimi nuk është i lidhur ngushtë me kontratën bazë nëse:

i) çmimi i ushtrimit të opSIONIT është përafërsisht i barabartë, në çdo datë të ushtrimit, me koston e amortizuar të instrumentit bazë të borxhit ose vlerën kontabël të kontratës bazë të sigurimit; ose

ii) çmimi i ushtrimit të një opSIONI parapagimi rimbursos huadhënësin për një shumë deri në vlerën e përafërt aktuale të interesit të humbur për periudhën e mbetur të kontratës bazë. Interesi i humbur është produkt i shumës së principalit të parapaguar shumëzuar me normën diferenciale të interesit. Norma diferenciale e interesit është tejkalmi i normës së interesit efektiv të kontratës bazë mbi normën e interesit efektiv të njësisë ekonomike që do të merrte në datën e parapagimit nëse ajo riinveston shumën e principalit të parapaguar në një kontratë të ngjashme për periudhën e mbetur të kontratës bazë.

Vlerësimi nëse opSIONI i blerjes apo kthimit është i lidhur ngushtë me kontratën bazë të borxhit bëhet para se të ndahet elementi i kapitalit neto të një instrumenti borxhi të konvertueshëm në përputhje me SNK 32.

f) Derivativët e kredisë, që janë të përfshirë në një instrument bazë borxhi dhe lejojnë një palë (përfituesin) të transferojë rrezikun e kredisë të një aktivi të veçantë reference, të cilin nuk mund ta ketë, te një palë tjetër (garantuesi), nuk janë të lidhur ngushtë me instrumentin bazë të borxhit. Derivativë të tillë të kredisë lejojnë garantuesin të marrë përsipër rrezikun e kredisë lidhur me aktivin e referencës pa e zotëruar drejtpërdrejt atë.

B4.3.6 Një shembull i një kontrate hibride është një instrument financiar që i jep mbajtësit të drejtën për t'ia kthyer përsëri instrumentin financiar emetuesit në këmbim të një shume mjetesh monetare ose aktivesh të tjera financiare që ndryshon në bazë të ndryshimit në një indeks të kapitalit neto apo

mallrave që mund të rritet ose zvogëlohet (një “instrumenti i kthimit të aksionit”). Vetëm nëse emetuesi në njohjen fillestare i përcakton instrumentet e kthimit të aksioneve si një pasiv financiar me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, është e nevojshme të ndahet një derivativ i përfshirë (p.sh. pagesa e principalit të indeksuar) sipas paragrafit 4.3.3, sepse kontrata bazë është një instrument borxhi sipas paragrafit B4.3.2 dhe pagesa e principalit të indeksuar nuk është e lidhur ngushtë me një instrument bazë të borxhit sipas paragrafit B4.3.5 (a). Meqë pagesa e principalit mund të rritet dhe të ulet, derivativi i përfshirë është një derivativ pa opSION, vlera e të cilit është e indeksuar me variabël bazë.

B4.3.7 Në rastin e një instrumenti të kthyeshëm që mund të kthehet përsëri në çdo kohë për një shumë mjete monetare të barabartë me një pjesë proporcionale të vlerës neto të aktivitetit të një njësie ekonomike (të tilla si njësitë e një fondi të përbashkët të hapur ose disa produkte investimesh të lidhura me njësinë), efekti i ndarjes së një derivativi të përfshirë dhe trajtimi kontabël për çdo përbërës është të matet kontrata hibride me shumën e riblerjes që është e pagueshme në fund të periudhës raportuese, në qoftë se mbajtësi ushtron të drejtën e tij për t’ia kthyer përsëri instrumentin emetuesit.

B4.3.8 Karakteristikat ekonomike dhe rreziqet e një derivativi të përfshirë janë të lidhura ngushtë me karakteristikat ekonomike dhe rreziqet e kontratës bazë në shembujt e mëposhtëm. Në këta shembuj, një njësi ekonomike nuk i trajton derivativët e përfshirë veçmas nga kontrata bazë.

a) Një derivativ i përfshirë në të cilin baza është një normë interesi ose indeksi i normës së interesit që mund të ndryshojë shumën e interesit, që ndryshe do të paguhej ose arkëtohej nga një kontratë bazë borxhi me interes, ose një kontratë sigurimi e lidhur ngushtë me kontratën bazë përveç nëse kontrata hibride mund të shlyhet në një mënyrë të tillë që mbajtësi nuk do të mbulonte kryesisht të gjithë investimin e tij të njohur, ose derivativi i përfshirë mundet të paktën të dyfishojë normën fillestare të kthimit mbi kontratën bazë për mbajtësin dhe mund të çojë në një normë kthimi që është të paktën dyfish i asaj të tregut për një kontratë me kushte të njëjta si kontrata bazë.

b) Një derivativ me kufi maksimal ose minimal i përfshirë në normën e interesit të një kontrate borxhi, ose kontratë sigurimi është i lidhur ngushtë me kontratën bazë, me kusht që kufiri maksimal, në ose mbi normën e tregut të interesit dhe ai minimal është në ose nën normën e tregut të interesit kur kontrata emetohet, dhe kufiri maksimal ose minimal është i ndikuar nga lidhja me kontratën bazë. Në mënyrë të ngjashme, dispozitat e përfshira në një kontratë për të blerë ose shitur një aktiv (p.sh. një mall) që vendosin një kufi maksimal dhe minimal mbi çmimin që duhet paguar ose arkëtuar për aktivin janë të lidhura ngushtë me kontratën bazë nëse të dy kufijtë janë pa para në fillimin e kontratës dhe nuk janë të ndikuar.

c) Një derivativ në monedhë të huaj, që ofron një seri pagesash të principalit ose të interesit të shprehura në monedhë të huaj dhe ka të përfshirë në një instrument borxhi (p.sh. një obligacion në monedhë të dyfishtë) është i lidhur ngushtë me instrumentin bazë të borxhit. Një derivativ i tillë nuk është i ndarë nga instrumenti bazë, sepse SNK 21 kërkon që fitimet dhe humbjet neto në monedhë të huaj nga zërat monetarë të njihen në fitim ose humbje.

d) Një derivativ në monedhë të huaj i përfshirë në një kontratë bazë që është një kontratë sigurimi ose një instrument jofinanciar (si një kontratë për blerjen ose shitjen e një zëri jofinanciar, ku çmimi është i shprehur në monedhë të huaj) është i lidhur ngushtë me kontratën bazë po qe se është i ndikuar, nuk përmban një tipar opsioni, dhe kërkon pagesa të shprehura në një nga monedhat e mëposhtme:

- i) në monedhën funksionale të çdo pale të rëndësishme të kësaj kontrate;
- ii) në monedhën në të cilën zakonisht shprehet çmimi i mallit ose shërbimit përkatës që është blerë ose dorëzuar, në transaksionet tregtare në mbarë botën (të tillë si dollari amerikan për transaksionet e naftës së papërpunuar); ose
- iii) një monedhë që përdoret zakonisht në kontratat për të blerë ose shitur zërat jofinanciarë në mjedisin ekonomik në të cilin transaksioni kryhet (p.sh. një monedhë relativisht e qëndrueshme dhe likuide që përdoret zakonisht në transaksionet e biznesit lokal ose të tregtisë së jashtme).

e) Një opSION parapagimi i përfshirë në një interes të shitur veçmas ose principal të shitur veçmas është i lidhur ngushtë me kontratën bazë nëse kontrata bazë: i) fillimisht rezulton nga ndarja e të



drejtës për të arkëtuar flukse monetare kontraktuale të një instrumenti financiar, që në vetvete, nuk përmban një derivativ të përfshirë; dhe ii) nuk përmban asnjë kusht që nuk ka qenë i pranishëm në kontratën fillestare bazë të borxhit.

f) Një derivativ i përfshirë në një kontratë bazë qiraje është i lidhur ngushtë me kontratën bazë nëse derivativi i përfshirë është: i) një indeks i lidhur me inflacionin i tillë si një indeks i pagesave të qirasë për një indeks të çmimeve të konsumit (me kusht që qiraja nuk është e ndikuar dhe indeksi lidhet me inflacionin në mjedisin e vet ekonomik të njësisë ekonomike); ii) qiratë e kushtëzuara në bazë të shitjeve përkatëse; ose iii) qiratë e kushtëzuara në bazë të normave variabël të interesit.

g) Një veti lidhëse e përfshirë në një instrument financiar bazë ose në një kontratë sigurimi bazë është e lidhur ngushtë me instrumentin bazë ose kontratën bazë nëse pagesat e shprehura në njësi janë të matura me vlerën aktuale të njësisë që pasqyrojnë vlerat e drejta të aktiveve të fondit. Një veti lidhëse është një term kontraktual që kërkon pagesa të shprehura në njësitë e një fondi investimesh të brendshme ose të jashtme.

h) Një derivativ i përfshirë në një kontratë sigurimi është i lidhur ngushtë me kontratën bazë të sigurimit, nëse derivativi i përfshirë dhe kontrata bazë e sigurimit janë kaq të ndërvuar sa që një njësi ekonomike nuk mund ta masë derivativin e përfshirë në mënyrë të veçantë (d.m.th. pa marrë parasysh kontratën bazë).

Instrumentet që përmbajnë derivativët e përfshirë

B4.3.9 Siç është përmendur në paragrafin B4.3.1, kur një njësi ekonomike bëhet palë në një kontratë hibride me një bazë që nuk është një aktiv brenda objektit të këtij SNRF-je dhe me një ose më shumë derivativë të përfshirë, paragrafi 4.3.3 kërkon që njësia ekonomike për të identifikuar derivativë të tillë të përfshirë, të vlerësojë nëse është e nevojshme të jenë të ndarë nga kontrata bazë, dhe për ata që është e nevojshme të ndahen, mat derivativët me vlerën e drejtë në njohjen fillestare dhe më pas. Këto kërkesa mund të jenë më komplekse, ose të çojnë në matje më pak të besueshme, sesa matja e tërë instrumentit me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Për këtë arsye ky SNRF lejon të përcaktohet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes e tërë kontrata hibride.

B4.3.10 Ky përcaktim mund të përdoret nëse paragrafi 4.3.3 kërkon që derivativët e përfshirë të ndahen nga kontrata bazë, ose ndalon një ndarje të tillë. Megjithatë, paragrafi 4.3.5 nuk do të justifikonte caktimin e kontratës hibride me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në rastet e përcaktuara në paragrafin 4.3.5 (a) dhe (b) sepse duke bërë kështu nuk do të zvogëlohej kompleksiteti ose të rritej besueshmëria.

Rivlerësimi i derivativëve të përfshirë

B4.3.11 Në përputhje me paragrafin 4.3.3, një njësi ekonomike do të vlerësojë nëse një derivativ i përfshirë është i nevojshëm të jetë i ndarë nga kontrata bazë dhe të trajtohet si një derivativ, kur njësia ekonomike më parë bëhet palë e kontratës. Rivlerësimi i mëposhëm është i ndaluar nëse nuk ka një ndryshim në kushtet e kontratës që modifikon në mënyrë të konsiderueshme flukset monetare që përndryshe do të kërkoreshin sipas kontratës, rast në të cilin është i nevojshëm rivlerësimi. Një njësi ekonomike përcakton nëse është i rëndësishëm një modifikim në flukset monetare duke pasur parasysh shkallën në të cilën kanë ndryshuar flukset monetare të pritshme në të ardhmen të lidhura me derivativin e përfshirë, kontrata bazë ose që të dyja dhe nëse ndryshimi është i rëndësishëm në lidhje me flukset monetare të pritshme më parë në kontratë.

B4.3.12 Paragrafi B4.3.11 nuk aplikohet për derivativët e përfshirë në kontratat e përfituara në:

- a) një kombinim biznesi (siç përcaktohet në SNRF 3 “Kombinimet e biznesit”);
- b) një kombinim të njërive ekonomike ose bizneseve nën kontroll të përbashkët siç përshkruhet në paragrafët B1-B4 të SNRF 3; ose
- c) formimin e një sipërmarrje të përbashkët siç përcaktohet në SNK 31 “Interesat në sipërmarrje të përbashkët”,
ose rivlerësimin e tyre të mundshëm në datën e blerjes².

²SNRF 3 trajton, në një kombinim biznesi blerjen e kontratave me derivativë të përfshirë.

Riklasifikimi i aktiveve financiare (seksioni 4.4)

B4.4.1 Paragrafi 4.4.1 kërkon që një njësi ekonomike të riklasifikojë aktivet financiare, nëse ndryshon objektivi i modelit të biznesit të njësisë ekonomike për menaxhimin e këtyre aktiveve financiare. Këto ndryshime pritet të jenë shumë të rralla. Këto ndryshime duhet të përcaktohen nga drejtimi i lartë i njësisë ekonomike, si rezultat i ndryshimeve të jashtme dhe të brendshme dhe duhet të jenë të rëndësishme për veprimtaritë e njësisë ekonomike dhe të demonstrueshme ndaj palëve të jashtme. Shembuj të një ndryshimi në modelin e biznesit përfshijnë si në vijim:

a) Një njësi ekonomike ka një portofol të kredive tregtare që i mban për t'i shitur në afat të shkurtër kohor. Njësia ekonomike blen një kompani që menaxhon kreditë tregtare dhe ka një model biznesi që i mban kreditë në mënyrë që të mbledhë flukset monetare kontraktuale. Portofoli i kredive tregtare nuk është më për shitje, dhe menaxhohet tani së bashku me kreditë tregtare të blera dhe të gjitha mbahen për të mbledhur flukse monetare kontraktuale.

b) Një firmë e shërbimeve financiare vendos të mbyllë biznesin e shitjes me pakicë të hipotekave. Ky biznes nuk pranohet më biznes të ri dhe firma e shërbimeve financiare është përfshirë në mënyrë aktive në marketingun e portofolit të kredive hipotekare për shitje.

B4.4.2 Një ndryshim në objektivin e modelit të biznesit të njësisë ekonomike duhet të kryhet para datës së riklasifikimit. Për shembull, nëse një firmë e shërbimeve financiare vendos më 15 shkurt të mbyllë biznesin e saj të hipotekimit dhe kështu duhet të riklasifikojë të gjitha aktivet financiare të prekura më 1 prill (pra ditën e parë të periudhës tjetër raportuese të njësisë ekonomike), njësia ekonomike nuk duhet të pranojë biznesin e ri të shitjes me pakicë të kredive hipotekare ose të angazhohet në aktivitete në përputhje me modelin e saj të biznesit pas 15 shkurtit.

B4.4.3 Në vijim nuk janë ndryshime në modelet e biznesit:

a) një ndryshim në qëllimin për sa u përket aktiveve financiare të veçanta (edhe në rrethanat e ndryshimeve të rëndësishme në kushtet e tregut);

b) zhdukja e përkohshme e një tregu të caktuar për aktivet financiare;

c) transferimi i aktiveve financiare në mes pjesëve të njësisë ekonomike me modele të ndryshme biznesi.

Matja (kapitulli 5)

Matja fillestare (seksioni 5.1)

B5.1.1 Vlera e drejtë e një instrumenti financiar në njohjen fillestare është zakonisht çmimi i transaksionit (d.m.th. vlera e drejtë e shumës së dhënë ose të marrë, shih, gjithashtu, paragrafin B5.4.8). Megjithatë, nëse një pjesë e shumës së dhënë ose të marrë është për diçka që s'ka të bëjë me instrumentin financiar, vlera e drejtë e instrumentit financiar vlerësohet duke përdorur një teknikë vlerësimi (shih paragrafët B5.4.6-B5.4.12). Për shembull, vlera e drejtë e një kredie afatgjatë ose llogarie të arkëtueshme që nuk mbart interes mund të vlerësohet si vlera aktuale e të gjitha arkëttimeve të mjeteve monetare në të ardhmen e skontuar, duke përdorur normën mbizotëruese të tregut (tregjeve) të interesit për një instrument të ngjashëm (i ngjashëm si në monedhë, afat, llojin e normës së interesit dhe faktorë të tjerë) me një klasifikim kredie të ngjashëm. Çdo shumë shtesë e huazuar është një shpenzim ose një ulje e të ardhurave nëse nuk kualifikohet për njohje si ndonjë lloj tjetër aktivi.

B5.1.2 Nëse një njësi ekonomike ka nisur një kredi që mbart një normë interesi jashtë tregut (p.sh. 5 për qind, kur norma e tregut për kredi të ngjashme është 8 për qind) dhe merr një tarifë në fillim si kompensim, njësia ekonomike e njeht kredinë me vlerën e drejtë, d.m.th. neto nga tarifa e marrë.

Matja e mëpasshme e aktiveve financiare (seksioni 5.2)

B5.2.1 Nëse një instrument financiar, që është njohur më parë si një aktiv financiar, matet me vlerën e drejtë dhe vlera e drejtë e tij bie nën zero, ai është një detyrim financiar i matur në përputhje me paragrafin 4.2.1. Megjithatë, kontrata hibride me instrumente bazë, që janë aktive brenda objektit të këtij SNRF-je, matet gjithmonë në përputhje me paragrafin 4.3.2.

B5.2.2 Shembulli i mëposhtëm ilustron kontabilitetin për kostot e transaksionit në matjen fillestare dhe të mëpasshme të një aktivi financiar të matur me vlerën e drejtë me ndryshimet nëpërmjet të ardhurave të tjera të përgjithshme në përputhje me paragrafin 5.7.5. Një njësi ekonomike blen një aktiv



për 100 NJM plus një komision blerjeje për 2 NJM. Fillimisht, njësia ekonomike e njeh aktivin me 102 NJM. Periudha e raportimit përfundon një ditë më vonë, kur çmimi i kuotuar në treg i aktivit është 100 NJM. Nëse aktivi shitet, do të paguhet një komision për 3 NJM. Në këtë datë, njësia ekonomike e mat aktivin me 100 NJM (pa marrë parasysh komisionin e mundshëm në shitje) dhe njeh një humbje prej 2 NJM në të ardhura të tjera të përgjithshme.

Matja e vlerës së drejtë (seksioni 5.4)

B5.4.1 Në themel të përkufizimit të vlerës së drejtë është supozimi që një njësi ekonomike është në vijimësi pa ndonjë qëllim apo nevojë për likuidimin, për të zvogëluar materialisht shkallën e operacioneve të saj ose për të ndërmarrë një transaksion në kushte të pafavorshme. Vlera e drejtë nuk është, pra, shuma që një njësi ekonomike do të marrë ose të paguajë në një transaksion të detyruar, likuidim të pavullnetshëm ose shitje në presion. Megjithatë, vlera e drejtë pasqyron cilësinë e kredisë të instrumentit.

B5.4.2 Ky SNRF përdor termat “çmimi i ofertës” dhe “çmimi i ofruar” (nganjëherë referuar si “çmimi aktual i ofruar”) në kontekstin e çmimeve të kuotuar të tregut, dhe termin “marzhi midis çmimit të kërkuar e të ofruar” për të përfshirë vetëm shpenzimet e transaksionit. Rregullime të tjera për të arritur në vlerën e drejtë (p.sh. për rrezikun e kredisë të palës tjetër) nuk janë të përfshira në termin “marzhi midis çmimit të kërkuar e të ofruar”.

Tregu aktiv: Çmimi i kuotuar

B5.4.3 Një instrument financiar konsiderohet i kuotuar në një treg aktiv, nëse çmimet e kuotuar janë të disponueshme lehtësisht dhe rregullisht nga një shkëmbim, tregtari, ndërmjetësi, grupi të industrisë, shërbimi për vendosjen e çmimit apo agjenci rregullatore, ndaj dhe këto çmime përfaqësojnë transaksione tregu që ndodhin aktualisht dhe rregullisht midis palëve të palidhura. Vlera e drejtë përcaktohet në kushtet e një çmimi të rënë dakord nga një blerës dhe një shitës i vullnetshëm në një transaksion midis palëve të palidhura. Objektivi i përcaktimit të vlerës së drejtë për një instrument financiar që tregtohet në një treg aktiv është të arrihet në çmimin me të cilin një transaksion do të ndodhte në fund të periudhës raportuese në këtë instrument (d.m.th. pa e modifikuar ose ripërpunuar instrumentin) në tregun aktiv më të favorshëm, në të cilin njësia ekonomike ka të drejtë hyrjeje të menjëhershme. Megjithatë, njësia ekonomike i rregullon çmimet në tregun më të favorshëm për të reflektuar çdo dallim në rrezikun e kredisë së palës tjetër në mes të instrumenteve të tregtuara në këtë treg dhe që po vlerësohen. Ekzistenca e kuotimeve të çmimit të publikuar në një treg aktiv është evidenca më e mirë e vlerës së drejtë dhe kur këto ekzistojnë përdoren për të matur aktivin financiar ose pasivin financiar.

B5.4.4 Çmim i kuotuar i përshtatshëm i tregut për një aktiv të mbajtur apo pasiv që duhet të shlyhet zakonisht është çmimi aktual i ofertës dhe për një aktiv të blerë ose pasiv të mbajtur, çmimi i ofruar. Kur njësia ekonomike ka aktive dhe pasive me rreziqe tregu të kompensueshme, ajo mund të përdorë çmime tregu mesatare si bazë për vendosjen e vlerës së drejtë për kompensimin e rrezikut dhe zbaton çmimin e ofertës ose çmimin e ofruar në pozicionin neto të çeljes sipas rastit. Kur çmimet aktuale të ofertës dhe çmimet e ofruara nuk janë të disponueshme, çmimi i transaksionit më të fundit siguron evidencën e vlerës së drejtë aktuale për atë kohë sa nuk ka pasur një ndryshim të rëndësishëm në rrethanat ekonomike që nga koha e transaksionit. Nëse kushtet kanë ndryshuar që nga koha e transaksionit (p.sh. një ndryshim në normën e interesit pa rrezik pas çmimit më të fundit të kuotuar për një obligacion të shoqërisë tregtare), vlera e drejtë reflekton, sipas rastit, ndryshimin në kushtet, duke iu referuar çmimeve aktuale ose normave për instrumente financiare të ngjashme. Në mënyrë të ngjashme, nëse njësia ekonomike mund të tregojë se çmimi i transaksionit të fundit nuk është vlera e drejtë (p.sh. sepse pasqyrohet shuma që një njësi ekonomike do të kishte marrë ose paguar në një transaksion të detyruar, likuidim të pavullnetshëm ose shitje të sforcuar), atëherë çmimi rregullohet. Vlera e drejtë e një portofoli të instrumenteve financiare është produkt i numrit të njërive të instrumentit dhe çmimit të kuotuar të tregut të tij. Nëse nuk ekziston një kuotim, çmimi i publikuar në një treg aktiv për një instrument financiar në tërësinë e tij, por ekzistojnë tregjet aktive për pjesët përbërëse të tij, vlera e drejtë përcaktohet në bazë të çmimeve të tregut përkatës për pjesët përbërëse.

B5.4.5 Nëse një normë (dhe jo një çmim) është kuotuar në një treg aktiv, njësia ekonomike përdor këtë normë të kuotuar tregu si një input në një teknikë vlerësimi për të përcaktuar vlerën e drejtë. Nëse norma e kuotuar në treg nuk përfshin rrezikun e kredisë ose faktorë të tjerë që pjesëmarrësit e tregut do të përfshinin në vlerësimin e instrumentit, njësia ekonomike e rregullon për këta faktorë.

Mungesa e tregut aktiv: Teknika e vlerësimit

B5.4.6 Nëse tregu për një instrument financiar nuk është aktiv, një njësi ekonomike përcakton vlerën e drejtë duke përdorur një teknikë vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë përdorimin e transaksioneve të kryera midis palëve të vullnetshme, të palidhura me njëra-tjetrën, nëse është e mundur, referencën në vlerën e drejtë aktuale të një instrumenti tjetër që është në thelb i njëjtë, analizën e fluksit të skontuar të mjeteve monetare dhe modelet e vlerësimit të opsionit. Nëse ka një teknikë vlerësimi që përdoret zakonisht nga pjesëmarrësit e tregut për çmimin e instrumentit dhe kjo teknikë ka treguar që jep vlerësime të besueshme të çmimeve të përfuara në transaksionet e tregut aktual, njësia ekonomike e përdor këtë teknikë.

B5.4.7 Objektivi i përdorimit të një teknike vlerësimi është të vendosë se çfarë çmimi transaksioni do të kishte qenë në datën e matjes në këmbimin midis palëve të palidhura të motivuara nga rrethanat e biznesit normal. Vlera e drejtë çmohet mbi bazën e rezultateve të një teknike vlerësimi që kërkon përdorimin maksimal të inputeve të tregut dhe mbështetet sa më pak të jetë e mundur në inpute specifike të njesisë. Një teknikë vlerësimi pritet të arrijë në një vlerësim realist të vlerës së drejtë në qoftë se: a) reflekton në mënyrë të arsyeshme mënyrën se si tregu pritej të caktonte çmimin e instrumentit; dhe b) inputet për teknikën e vlerësimit në mënyrë të arsyeshme përfaqësojnë pritjet e tregut dhe masën e faktorëve të rrezikut të kthimit të qenësishëm në instrumentin financiar.

B5.4.8 Prandaj, një teknikë vlerësimi: a) përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të kishin parasysh në vendosjen e një çmimi; dhe b) është në përputhje me metodologjitë ekonomike të pranuar për caktimin e çmimit të instrumenteve financiare. Periodikisht, një njësi ekonomike kalibron teknikën e vlerësimit dhe e teston atë për vlefshmërinë, duke përdorur çmimet nga çdo transaksion tregu aktual të mbikëqyrur të instrumentit të njëjtë (d.m.th. pa modifikim ose ripërpunim) ose bazuar në të dhënat e disponueshme të tregut të mbikëqyrur. Një njësi ekonomike merr të dhënat në mënyrë të vazhdueshme në të njëjtin treg nga ku instrumenti ka origjinën ose është blerë. Evidenca më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar në njohjen fillestare është çmimi i transaksionit (d.m.th. vlera e drejtë e shumës së dhënë ose të marrë), përveç rastit kur vlera e drejtë e këtij instrumenti është evidentuar nga krahasimi me transaksionet e tjera aktuale të tregut të mbikëqyrur për instrumentin e njëjtë (d.m.th. pa modifikim ose ripërpunim) ose bazuar në një teknikë vlerësimi, variablat e të cilit përfshijnë të dhëna vetëm nga tregjet e mbikëqyrura.

B5.4.9 Matja e mëpasshme e aktivit financiar ose pasivit financiar dhe njohja e mëpasshme e fitimeve dhe humbjeve neto duhet të jenë në përputhje me kërkesat e këtij SNRF-je. Zbatimi i paragrafit B5.4.8 mund të bëjë që të mos njihet asnjë fitim ose humbje neto në njohjen fillestare të një aktivi financiar ose pasivi financiar. Në një rast të tillë, ky SNRF kërkon që një fitim ose humbje të njihet pas njohjes fillestare vetëm në atë masë që ai rrjedh nga një ndryshim në një faktor (përfshirë kohën) që pjesëmarrësit në treg do të kishin parasysh në vendosjen e një çmimi.

B5.4.10 Blerja fillestare ose krijimi i një aktivi financiar ose lindja e një pasivi financiar është një transaksion tregu që ofron një bazë për vlerësimin e vlerës së drejtë të instrumentit financiar. Në veçanti, nëse instrumenti financiar është një instrument borxhi (i tillë si një hua), vlera e tij e drejtë mund të përcaktohet duke iu referuar kushteve të tregut që ekzistonin në blerjen e tij, ose datës së krijimit dhe kushteve aktuale të tregut ose normave të interesit të shpenzuara aktualisht nga njësia ekonomike ose nga të tjerët për instrumente borxhi të ngjashme (p.sh. maturimi i mbetur i ngjashëm, struktura e fluksit monetar, monedha, rreziku i kredisë, kolaterali dhe bazat e interesit). Nga ana tjetër, me kusht që nuk ka asnjë ndryshim në rrezikun e kredisë së debitorit dhe marzhet e zbatueshme të kredisë pas lindjes së instrumentit të borxhit, mund të bëhet një vlerësim i normës aktuale të tregut të interesit duke përdorur një normë bazë interesi që pasqyron një cilësi më të mirë të kredisë sesa instrumenti bazë i borxhit, duke mbajtur të pandryshuar marzhin e kredisë dhe duke bërë rregullimin për ndryshimin në normën bazë të



interesit nga data e origjinës. Në qoftë se kushtet kanë ndryshuar që nga transaksioni më i fundit i tregut, ndryshimi përkatës në vlerën e drejtë të instrumentit financiar që po vlerësohet, përcaktohet duke iu referuar çmimeve aktuale ose normave për instrumente të ngjashme financiare, rregulluar sipas rastit, për çdo dallim nga instrumenti që vlerësohet.

B5.4.11 Në çdo datë të matjes mund të mos jetë në dispozicion i njëjti informacion. Për shembull, në datën që një njësi ekonomike fiton një hua ose blen një instrument borxhi që nuk është tregtuar në mënyrë aktive, njësia ekonomike ka një çmim transaksioni që është, gjithashtu, një çmim tregu. Megjithatë, në datën tjetër të matjes mund të mos jetë në dispozicion asnjë informacion i ri për transaksionin dhe ndonëse njësia ekonomike mund të përcaktojë nivelin e përgjithshëm të normave të interesit të tregut, nuk mund të dijë se çfarë niveli kredie ose rrezik tjetër do të kishin parasysh pjesëmarrësit e tregut në caktimin e çmimit të instrumentit në këtë datë. Një njësi ekonomike nuk mund të ketë informacione nga transaksionet e fundit për të përcaktuar marzhin e duhur të kredisë mbi normën e interesit bazë të përdorur në përcaktimin e një norme skontimi për llogaritjen e vlerës aktuale. Do të ishte e arsyeshme të supozohet, në mungesë të një evidence për të kundërtën, se nuk kanë ndodhur ndryshime në marzhin që ka ekzistuar në datën kur është fituar kredia. Megjithatë, njësia ekonomike pritet të bëjë përpjekje të arsyeshme për të përcaktuar nëse ka evidencë se ka pasur një ndryshim në këta faktorë. Kur ekziston evidenca e një ndryshimi, njësia ekonomike do të marrë në konsideratë efektet e ndryshimit në përcaktimin e vlerës së drejtë të instrumentit financiar.

B5.4.12 Kur zbatohet analiza e fluksit monetare të skontuar, një njësi ekonomike përdor një ose më shumë norma skontimi të barabarta me normat mbizotëruese të kthimit për instrumentet financiare që kanë kryesisht të njëjtat kushte dhe karakteristika, duke përfshirë cilësinë e kredisë së instrumentit, afatin e mbetur për të cilin është caktuar norma e interesit kontraktuale, kohën e mbetur për shlyerjen e principalit dhe monedhën në të cilën duhet të bëhet pagesa. Llogaritë afatshkurtra të arkëtueshme dhe të pagueshme pa normë interesi të shpallur mund të maten me shumën e faturës origjinale nëse efekti i skontimit është jomaterial.

Inputet për teknikat e vlerësimit

B5.4.13 Një teknikë e përshtatshme për vlerësimin e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar të veçantë do të përfshinte të dhënat e tregut të mbikëqyrur në lidhje me kushtet e tregut dhe faktorë të tjerë që mund të ndikojnë në vlerën e drejtë të instrumentit. Vlera e drejtë e një instrumenti financiar do të bazohet në një ose më shumë nga faktorët e mëposhtëm (dhe ndoshta të tjerë).

a) Vlera në kohë e parasë (d.m.th. interesi me normë bazë ose pa rrezik). Normat bazë të interesit zakonisht mund të rrjedhin nga çmimet e mbikëqyrura të obligacioneve qeveritare dhe që shpesh janë të kuotuar në botimet financiare. Këto norma zakonisht ndryshojnë sipas datave të pritshme të flukseve monetare të projektuara nëpër një kurbë të normave të interesit për periudha të ndryshme kohore. Për arsye praktike, një njësi ekonomike mund të përdorë si normë bazë një normë të mirëpranuar dhe të përgjithshme, lehtësisht të mbikëqyrur, e tillë si LIBOR ose një normë këmbimi. (Për shkak se një normë e tillë si LIBOR nuk është normë interesi pa rrezik, rregullimi i rrezikut të kredisë në përshtatje me instrumentin financiar të veçantë përcaktohet në bazë të rrezikut të tij të kredisë në lidhje me rrezikun e kredisë në këtë normë bazë.) Në disa vende, obligacionet e qeverisë qendrore mund të mbartin një rrezik të madh të kredisë dhe nuk mund të sigurojnë një bazë të qëndrueshme të normës bazë të interesit për instrumentet e shprehura në këtë monedhë. Disa njësi ekonomike në këto vende, mund të kenë një gjendje më të mirë të kredisë dhe një normë më të ulët huamarrjeje se qeveria qendrore. Në një rast të tillë, mund të jetë më e përshtatshme që norma bazë e interesit të përcaktohet duke iu referuar normave të interesit për obligacionet e shoqërisë tregtare me normat më të larta të emtuara në monedhën e atij juridiksioni.

b) Rreziku i kredisë. Efekti në vlerën e drejtë të rrezikut të kredisë (d.m.th. primin mbi normë bazë të interesit për rrezikun e kredisë) mund të vijë nga çmimet e tregut të mbikëqyrur për instrumentet e tregtuara me cilësi të ndryshme kredie ose nga normat e mbikëqyrura të interesit të kërkuara nga huadhënësit për huat e kategorizimeve të ndryshme.

c) Çmimet e këmbimit në monedhë të huaj. Tregjet aktive të këmbimit në monedhë të huaj ekzistojnë për shumicën e monedhave kryesore dhe çmimet janë të kuotuar në mënyrë të përditshme në publikimet financiare.

d) Çmimet e mallrave. Ka çmime tregu të mbikëqyrura për shumë mallra.

e) Çmimet e kapitalit neto. Çmimet (dhe indeksat e çmimeve) të instrumenteve të kapitalit neto janë lehtësisht të mbikëqyrura në disa tregje. Teknikat e bazuara në vlerën aktuale mund të përdoren për vlerësimin e çmimit aktual të tregut të instrumenteve të kapitalit neto, për të cilat nuk kanë çmime të mbikëqyrura.

f) Lulahshmëria (d.m.th. madhësia e ndryshimeve të ardhshme në çmimet e instrumentit financiar ose zëra të tjerë). Masat e lulahshmërisë së zërave që tregtohen në mënyrë aktive normalisht mund të vlerësohen në mënyrë të arsyeshme mbi bazën e të dhënave historike të tregut ose duke përdorur luhajtjet e nënkuptuara në çmimet aktuale të tregut.

g) Rreziku i parapagimit dhe rreziku i heqjes dorë. Modelet e parapagimit të pritshëm për aktive financiare dhe modelet e heqjes dorë të pritshme për pasivet financiare mund të vlerësohen mbi bazën e të dhënave historike. (Vlera e drejtë e një pasivi financiar nga i cili mund të hiqet dorë nga pala tjetër nuk mund të jetë më pak se vlera aktuale e shumës nga e cila është hequr dorë, shih paragrafin 5.4.3.)

h) Kostot e shërbimit për një aktiv financiar ose një pasiv financiar. Kostot e shërbimit mund të vlerësohen duke përdorur krahasimet me tarifatat aktuale të kërkuara nga pjesëmarrësit e tjerë të tregut. Nëse kostot e shërbimit të një aktivi financiar ose pasivi financiar janë të rëndësishme dhe pjesëmarrësit e tjerë të tregut do të përballen me kostot e krahasueshme, emetuesi do t'i marrë parasysh ato në përcaktimin e vlerës së drejtë të këtij aktivi financiar ose pasivi financiar. Është e mundshme që vlera e drejtë në fillimin e një të drejte kontraktuale për tarifatat e ardhshme është e barabartë me kostot e nisjes të paguara për to, përveç rastit kur tarifatat e ardhshme dhe kostot e lidhura nuk janë në të njëjtën linjë me të krahasueshmet e tregut.

Investimet në instrumente kapitali të pakuotuar (dhe kontratat për këto investime që duhet të shlyhen me dhënie instrumentesh kapitali të pakuotuar)

B5.4.14 Të gjitha investimet në instrumente kapitali dhe kontratat për këto instrumente duhet të maten me vlerën e drejtë. Megjithatë, në rrethana të kufizuara, kostoja mund të jetë një vlerësim i duhur i vlerës së drejtë. Ky mund të jetë rasti kur informacioni më i fundit që disponohet është i pamjaftueshëm për të përcaktuar vlerën e drejtë, ose nëse ka një gamë të gjerë matjesh të mundshme të vlerës së drejtë dhe kostoja përfaqëson vlerësimin më të mirë të vlerës së drejtë në të.

B5.4.15 Treguesit që kostoja mund të mos jetë përfaqësuese e vlerës së drejtë përfshijnë:

a) një ndryshim të rëndësishëm në performancën e të investuarit krahasuar me buxhetet, planet apo objektivat;

b) ndryshimet në pritshmëritë që objektivat teknike të produktit do të arrihen nga i investuari;

c) një ndryshim të rëndësishëm në treg për kapitalin e të investuarit ose produkteve të tij apo të produkteve potenciale;

d) një ndryshim të rëndësishëm në ekonominë globale ose mjedisin ekonomik në të cilin operon i investuari;

e) një ndryshim të rëndësishëm në performancën e njësive ekonomike të krahasueshme ose në vlerësime të nënkuptuara nga tregu i përgjithshëm;

f) çështje të brendshme të të investuarit, të tilla si: mashtrimi, mosmarrëveshjet tregtare, gjyqësore, ndryshimet në menaxhimin apo strategjinë;

g) evidenca nga transaksionet e jashtme në kapitalin e të investuarit ose nga i investuari (të tilla si emetimi i ri i kapitalit), ose nga transferimet e instrumenteve të kapitalit ndërmjet palëve të treta;

B5.4.16 Lista në paragrafin B5.4.15 nuk është përfundimtare. Një njësi ekonomike do të përdorë të gjithë informacionin për performancën dhe veprimtaritë e të investuarit që i vihet në dispozicion pas datës së njohjes fillestare. Këta faktorë mund të tregojnë se kostoja mund të mos jetë përfaqësuese e vlerës së drejtë, në masën që ekziston çdo faktor i tillë i rëndësishëm. Në raste të tilla, njësi ekonomike duhet të vlerësojë vlerën e drejtë.



B5.4.17 Kostoja nuk është vlerësimi më i mirë i vlerës së drejtë për investimet në instrumente kapitali neto të kuotuar (ose kontratat për instrumente kapitali të kuotuar).

Fitime dhe humbje neto (seksioni 5.7)

B5.7.1 Paragrafi 5.7.5 lejon një njësi ekonomike të bëjë një zgjedhje të pakthyeshme për të paraqitur në të ardhura të tjera të përgjithshme ndryshimet në vlerën e drejtë të një investimi në një instrument kapitali që nuk mbahet për tregtim. Kjo zgjedhje bëhet bazuar në instrument për instrument (d.m.th. aksion për aksion). Shumat e paraqitura në të ardhura të tjera të përgjithshme nuk do të transferohen më pas në fitim ose humbje. Megjithatë, njësi ekonomike mund të transferojë fitimin ose humbjen neto kumulative brenda kapitalit neto. Dividendët për investime të tilla njihen në fitim ose humbje në përputhje me SNK 18, përveç rastit kur dividendi paraqet qartë një mbulim të një pjese të koston së investimit.

B5.7.2 Një njësi ekonomike zbaton SNK 21 “Efektet e ndryshimeve në kurset e këmbimit të monedhave të huaja” për aktivet financiare dhe detyrimet financiare që janë zëra monetarë në përputhje me SNK 21 dhe të shprehura në monedhë të huaj. SNK 21 kërkon që çdo fitim dhe humbje neto nga këmbimi i monedhave të huaja për aktivet dhe detyrimet monetare të njihen në fitim ose humbje. Përbën përjashtim një zë monetar që është përcaktuar si një instrument mbrojtës ose në mbrojtje të fluksit të mjeteve monetare (shih paragrafët 95-101 të SNK 39) ose një mbrojtje e një investimi neto (shih paragrafin 102 të SNK 39).

B5.7.3 Paragrafi 5.7.5 lejon një njësi ekonomike të bëjë një zgjedhje të pakthyeshme për të paraqitur në të ardhura të tjera të përgjithshme ndryshimet në vlerën e drejtë të një investimi në një instrument kapitali neto që nuk mbahet për tregtim. Një investim i tillë nuk është një zë monetar. Kështu, fitimi ose humbja neto që është paraqitur në të ardhura të tjera të përgjithshme në përputhje me paragrafin 5.7.5 përfshin çdo përbërës që lidhet me këmbimin e monedhave të huaja.

B5.7.4 Nëse ka një marrëdhënie mbrojtëse në mes të një aktivi joderivativ monetar dhe pasivi joderivativ monetar, ndryshimet në përbërësin e monedhës së huaj të këtyre instrumenteve financiare paraqiten në fitim ose humbje.

Pasivet e përcaktuara si me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes

B5.7.5 Kur një njësi ekonomike përcakton një pasiv financiar si me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, ajo duhet të përcaktojë nëse paraqitja në të ardhura të tjera të përgjithshme e efekteve të ndryshimeve në rrezikun e kredisë të pasivit do të krijonte ose shtonte një mospërputhje kontabël në fitim ose humbje. Një mospërputhje kontabël do të krijohet apo shtohet, nëse paraqitja e efekteve të ndryshimeve në rrezikun e kredisë në të ardhura të tjera të përgjithshme do të çojë në një mospërputhje më të madhe në fitim ose humbje në qoftë se këto shuma paraqiten në fitim ose humbje.

B5.7.6 Për të bërë këtë përcaktim, një njësi ekonomike duhet të vlerësojë nëse ajo pret që efektet e ndryshimeve në rrezikun e kredisë të pasivit do të kompensohen në fitim ose humbje nga një ndryshim në vlerën e drejtë të një instrumenti tjetër financiar të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Një pritshmëri e tillë duhet të bazohet në një marrëdhënie ekonomike në mes të karakteristikave të pasivit dhe karakteristikave të instrumentit tjetër financiar.

B5.7.7 Ky përcaktim bëhet në njohjen fillestare dhe nuk rivlerësohet. Për qëllime praktike njësi ekonomike nuk duhet të hyjë në të gjitha aktivet dhe pasivet që shkaktojnë një mospërputhje kontabël saktësisht në të njëjtën kohë. Një shtyrje e arsyeshme lejohet me kushtin që pritet të ndodhin transaksionet e mbetura. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë vazhdimisht metodologjinë e saj për të përcaktuar nëse paraqitja në të ardhurat e tjera të përgjithshme të efekteve të ndryshimeve në rrezikun e kredisë të pasivit do të krijojë ose zgjerojë një mospërputhje kontabël në fitim ose humbje. Megjithatë, një njësi ekonomike mund të përdorë metodologjinë e ndryshme, kur ka marrëdhënie të ndryshme ekonomike në mes të karakteristikave të pasiveve të përcaktuara si me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes dhe karakteristikave të instrumenteve të tjera financiare. SNRF 7 kërkon që njësi ekonomike të japë informacione shpjeguese cilësore në shënimet e pasqyrave financiare në lidhje me metodologjinë e saj për të bërë këtë përcaktim.

B5.7.8 Nëse do të krijohet apo zgjerohet një mospërputhje, njësia ekonomike duhet të paraqesë të gjitha ndryshimet në vlerën e drejtë (duke përfshirë efektet e ndryshimeve në rrezikun e kredisë), në fitim ose humbje. Nëse nuk do të krijohet apo zgjerohet një mospërputhje, njësia ekonomike është e detyruar të paraqesë efektet e ndryshimeve në rrezikun e kredisë në të ardhura të tjera të përgjithshme.

B5.7.9 Shumat e paraqitura në të ardhura të tjera të përgjithshme nuk do të transferohen më pas në fitim ose humbje. Megjithatë, njësia ekonomike mund të transferojë fitimin ose humbjen neto kumulativ brenda kapitalit neto.

B5.7.10 Shembulli i mëposhtëm përshkruan një situatë në të cilën do të krijohet një mospërputhje kontabël në fitim ose humbje, nëse efektet e ndryshimeve në rrezikun e kredisë paraqiten në të ardhura të tjera të përgjithshme. Një bankë huash hipotekare ofron kredi për konsumatorët dhe i financon këto kredi duke shitur obligacione me karakteristikat e përputhjes (p.sh. shuma e papaguar, profili i shlyerjes, afati dhe monedha) në treg. Kushtet kontraktuale të kredisë e lejojnë konsumatorin e kredisë hipotekare të parapaguajë kredinë e tij (d.m.th. plotëson detyrimin e tij ndaj bankës), duke blerë obligacionin përkatës me vlerën e drejtë në treg dhe duke ia dhënë atë bankës. Si rezultat i kësaj të drejte parapagimi kontraktuale, në qoftë se cilësia e kredisë e obligacionit përkeqësohet (dhe, në këtë mënyrë, zvogëlohet vlera e drejtë e pasivit të bankës), vlera e drejtë e aktivit të kredisë hipotekare të bankës zvogëlohet. Ndryshimi në vlerën e drejtë të aktivit pasqyron të drejtën kontraktuale të konsumatorit të kredisë hipotekare për ta parapaguar kredinë duke blerë obligacione bazë me vlerën e drejtë (e cila, në këtë shembull është ulur) dhe duke ia livruar këto obligacione bankës hipotekare. Prandaj, efektet e ndryshimeve në rrezikun e kredisë të pasivit (obligacionit) do të kompensohen në fitimin ose humbjen nga një ndryshim korrespondues në vlerën e drejtë të një aktivi financiar (kredisë). Në qoftë se efektet e ndryshimeve në rrezikun e pasivit të kredisë paraqiten në të ardhura të tjera të përgjithshme do të kishte një mospërputhje kontabël në fitim ose humbje. Prandaj, banka hipotekare është e detyruar të paraqesë të gjitha ndryshimet në vlerën e drejtë të pasivit (duke përfshirë efektet e ndryshimeve në rrezikun e kredisë të pasivit) në fitim ose humbje.

B5.7.11 Në shembullin në paragrafin B5.7.10, ka një lidhje kontraktuale midis efekteve të ndryshimeve në rrezikun e kredisë së pasivit dhe ndryshimeve në vlerën e drejtë të aktivit financiar (d.m.th. si rezultat i të drejtës kontraktuale të konsumatorit të kredisë hipotekare për ta parapaguajë atë duke blerë obligacion me vlerën e drejtë dhe duke ia livruar bankës). Megjithatë, një mospërputhje kontabël mund të ndodhë edhe në mungesë të një lidhje kontraktuale.

B5.7.12 Për qëllime të zbatimit të kërkesave në paragrafët 5.7.7 dhe 5.7.8, një mospërputhje kontabël nuk shkaktohet vetëm nga metoda e matjes, që një njësi ekonomike përdor për të përcaktuar efektet e ndryshimeve në rrezikun e kredisë së një pasivi. Një mospërputhje kontabël në fitim ose humbje lind vetëm kur efektet e ndryshimeve në rrezikun e kredisë (siç përcaktohet në SNRF 7) pritet të kompensohen nga ndryshimet në vlerën e drejtë të një instrumenti tjetër financiar. Një mospërputhje që lind vetëm si rezultat i metodës së matjes (p.sh. për shkak se një njësi ekonomike nuk i ka izoluar ndryshimet në rrezikun e kredisë të një pasivi nga disa ndryshime të tjera në vlerën e tij të drejtë) nuk ndikon në përcaktimin e kërkuar nga paragrafët 5.7.7 dhe 5.7.8. Për shembull, një njësi ekonomike nuk mund të izolojë ndryshimet në rrezikun e kredisë nga ndryshimet në rrezikun e likuiditetit. Nëse njësia ekonomike paraqet efektin e kombinuar të të dy faktorëve në të ardhura të tjera të përgjithshme, mund të ndodhë një mospërputhje për shkak se ndryshimet në rrezikun e likuiditetit mund të përfshihen në matjen e vlerës së drejtë të këtyre aktiveve të njësisë ekonomike dhe i gjithë ndryshimi i vlerës së drejtë i këtyre aktiveve paraqitet në fitim ose humbje. Megjithatë, një mospërputhje e tillë shkaktohet nga pasaktësi të matjes dhe jo nga marrëdhënie kompensimi të përshkruar në paragrafin B5.7.6, dhe prandaj, nuk ndikon në përcaktimin e kërkuar nga paragrafët 5.7.7 dhe 5.7.8.

Kuptimi i “rrezikut të kredisë”

B5.7.13 SNRF 7 përcakton rrezikun e kredisë si “rrezikun që njëra palë në një instrument financiar do të shkaktojë humbje financiare për palën tjetër duke mos arritur të kryejë një detyrim”. Kërkesa në paragrafin 5.7.7 (a) ka të bëjë me rrezikun që emetuesi nuk do të arrijë të përmbushë këtë detyrim të veçantë. Kjo kërkesë jo medoemos lidhet me aftësinë huamarrëse të emetuesit. Për shembull,



nëse një njësi ekonomike emeton një pasiv të kolateralizuar dhe pasiv jo të kolateralizuar që ndryshe janë identikë, rreziku i kredisë i këtyre dy pasiveve do të jetë i ndryshëm, edhe pse ata janë emetuar nga e njëjta njësi ekonomike. Rreziku i kredisë për pasivin e kolateralizuar do të jetë më i ulët se rreziku i kredisë së pasivit të pakolateralizuar. Rreziku i kredisë për një detyrim të kolateralizuar mund të jetë afër zeros.

B5.7.14 Për qëllime të zbatimit të kërkesave në paragrafin 5.7.7 (a), rreziku i kredisë është i ndryshëm nga rreziku i performancës së aktivitetit specifik. Rreziku i performancës së aktivitetit specifik nuk lidhet me rrezikun që një njësi ekonomike nuk do të arrinte të përmbushte një detyrim të veçantë, por përkundrazi ai është i lidhur me rrezikun që një aktiv i vetëm ose një grup aktivesh do të funksionojë dobët (ose aspak).

B5.7.15 Në vijim janë shembuj të rrezikut të performancës të aktivitetit specifik:

a) një pasiv me një veti lidhëse ku shumat e detyrimit për investitorët është e përcaktuar me kontratë mbi bazën e performancës së aktiveve të specifikuara. Efekti i kësaj vetie lidhëse në vlerën e drejtë të pasivit është rreziku i performancës së aktivitetit specifik dhe jo rreziku i kredisë.

b) një pasiv i dhënë nga një njësi ekonomike me qëllim të veçantë (SPE), me karakteristikat e mëposhtme. SPE është e izoluar ligjërisht kështu që aktivet në SPE janë të mbrojtura vetëm për të mirën e investitorëve të saj, edhe në rast falimentimi. SPE nuk hyn në transaksione të tjera dhe aktivet në SPE nuk mund të hipotekohen. Shumat u paguhen investitorëve të SPE-së vetëm nëse aktivet e mbrojtura krijojnë flukse monetare. Kështu, ndryshimet në vlerën e drejtë të pasivit kryesisht pasqyrojnë ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve. Efekti i performancës së aktiveve në vlerën e drejtë të pasivit është rreziku i performancës së aktiveve të veçanta, nuk është rreziku i kredisë.

Përcaktimi i efekteve të ndryshimeve në rrezikun e kredisë

B5.7.16 Për qëllime të zbatimit të kërkesave në paragrafin 5.7.7 (a), një njësi ekonomike përcakton madhësinë e ndryshimit në vlerën e drejtë të pasivit financiar që i takon ndryshimeve në rrezikun e kredisë ose:

a) si shumë e ndryshimit në vlerën e drejtë të tij që nuk lidhet me ndryshimet në kushtet e tregut që shkaktojnë rrezikun e tregut (shih paragrafët B5.7.17 dhe B5.7.18); ose

b) duke përdorur një metodë alternative, njësi ekonomike mendon se e përfaqëson më besnikërisht shumën e ndryshimit në vlerën e drejtë të pasivit që i takon ndryshimeve në rrezikun e kredisë.

B5.7.17 Ndryshimet në kushtet e tregut që shkaktojnë rrezikun e tregut përfshijnë ndryshimet në një normë bazë interesi, çmimin e një instrumenti financiar të një njësie tjetër ekonomike, një çmim malli, një normë këmbimi të monedhave të huaja ose indeksin e çmimeve apo normave.

B5.7.18 Në qoftë se ndryshimet në një normë interesi (bazë) të mbikëqyruar janë të vetmet ndryshime përkatëse të rëndësishme në kushtet e tregut të një pasivi, shumat në paragrafin B5.7.16 (a) mund të vlerësohet si më poshtë:

a) Së pari, njësi ekonomike llogarit normën e brendshme të kthimit të pasivit në fillim të periudhës duke përdorur vlerën e drejtë të pasivit dhe flukset monetare kontraktuale të tij në fillim të periudhës. Nga kjo normë kthimi zbritet norma e mbikëqyruar (bazë) e interesit në fillim të periudhës, për të arritur në një përbërës specifik të normës së brendshme të kthimit të instrumentit.

b) Pas kësaj, njësi ekonomike llogarit vlerën aktuale të flukseve monetare të lidhura me pasivin duke përdorur flukset monetare kontraktuale të tij në fund të periudhës dhe një normë skontimi të barabartë me shumën e: i) normës së mbikëqyruar (bazë) të interesit në fund të periudhës; dhe ii) përbërësin specifik të normës së brendshme të kthimit të përcaktuar në pikën (a).

c) Diferenca midis vlerës së drejtë të pasivit në fund të periudhës dhe shumës së përcaktuar në pikën (b) është ndryshimi në vlerën e drejtë që nuk i takon ndryshimeve në normën e mbikëqyruar (bazë) të interesit. Kjo është shumata që do të paraqitet në të ardhura të tjera të përgjithshme në përputhje me paragrafin 5.7.7 (a).

B5.7.19 Shembulli në paragrafin B5.7.18 supozon se ndryshimet në vlerën e drejtë që vijnë nga faktorë të tjerë dhe jo nga ndryshimet në rrezikun e kredisë ose ndryshimet në normat e mbikëqyruara

(bazë) të interesit nuk janë të rëndësishme. Kjo metodë nuk do të ishte e përshtatshme në qoftë se ndryshimet në vlerën e drejtë, që vijnë nga faktorë të tjerë, janë të rëndësishme. Në këto raste, një njësi ekonomike kërkohet të përdorë një metodë alternative që mat më me besnikëri efektet e ndryshimeve në rrezikun e kredisë (shih paragrafin B5.7.16 (a)). Për shembull, nëse instrumenti në shembull përmban një derivativ të përfshirë, ndryshimi në vlerën e drejtë të derivativit të përfshirë përjashtohet në përcaktimin e shumës që do të paraqitet në të ardhura të tjera të përgjithshme në përputhje me paragrafin 5.7.7 (a).

B5.7.20 Si me të gjitha vlerësimet e vlerës së drejtë, metoda e matjes e një njësie ekonomike për përcaktimin e pjesës së ndryshimit në vlerën e drejtë të pasivit, që i takon ndryshimeve në rrezikun e tij të kredisë, duhet të shfrytëzojë maksimalisht inputet e tregut.

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha transitore (kapitulli 7)

Periudha transitore (seksioni 7.2)

Aktivitetet financiare të mbajtura për tregtim

B7.2.1 Në datën e zbatimit fillestar të këtij SNRF-je, një njësi ekonomike duhet të përcaktojë nëse objektivi i modelit të biznesit të saj për menaxhimin e aktiveve të saj financiare plotëson kushtet në paragrafin 4.1.2 (a) apo nëse një aktiv financiar është i përshtatshëm për zgjedhjen në paragrafin 5.7.5. Për këtë qëllim, një njësi ekonomike duhet të përcaktojë nëse aktivitetet financiare plotësojnë përkufizimin e mbajtur për tregtim sikur njësi ekonomike t'i kishte blerë aktivet në datën e zbatimit për herë të parë.

SHTOJCA A PËRKUFIZIMET

Derivativët

BA.1 Shembuj tipikë të derivativëve janë kontrata të së ardhmes, të këmbimit dhe opsionet. Një derivativ zakonisht ka një shumë imagjinare, e cila është një sasi e monedhës, një numër aksionesh, një numër i njësive të peshës apo vëllimit ose njësi të tjera të specifikuar në kontratë. Megjithatë, një instrument derivativ nuk kërkon që mbajtësi apo shkruesi të investojë ose të arkëtojë shumën imagjinare në fillimin e kontratës. Nga ana tjetër, një derivativ mund të kërkojë një pagesë fikse ose pagesën e një shume që mund të ndryshojë (por jo në mënyrë proporcionale me një ndryshim në bazë), si rezultat i disa ngjarjeve të ardhshme që nuk janë të lidhura me një shumë imagjinare. Për shembull, një kontratë mund të kërkojë një pagesë të caktuar të 1,000 NJM, në qoftë se LIBOR për gjashtë muaj rritet me 100 pikë bazë. Një kontratë e tillë është një derivativ edhe pse nuk është e specifikuar një shumë imagjinare.

BA.2 Përkufizimi i një derivativi në këtë SNRF përfshin kontratat që shlyhen bruto nëpërmjet livrimit të zërit bazë (p.sh. një kontratë të ardhshme për të blerë një instrument borxhi me normë fikse). Një njësi ekonomike mund të ketë një kontratë për të blerë ose shitur një zë jofinanciar që mund të shlyhet neto me mjete monetare ose me çdo instrument financiar tjetër ose duke këmbyer instrumentet financiare (p.sh. një kontratë për të blerë ose shitur një mall me një çmim të fiksuar në një datë në të ardhmen). Një kontratë e tillë është brenda objektit të këtij SNRF-je, nëse nuk është lidhur dhe vazhdon të mbahet me qëllim të livrimit të një zëri jofinanciar në përputhje me kërkesat e pritshme të njësive ekonomike për blerjen, shitjen apo përdorimin (shih paragrafët 5-7 të SNK 39).

BA.3 Një nga karakteristikat përcaktuese të një derivativi është se ai ka një investim fillestar neto që është më i vogël sesa do të ishte e nevojshme për llojet e tjera të kontratave që pritet të kenë një reagim të ngjashëm ndaj ndryshimeve në faktorët e tregut. Një kontratë opsioni e plotëson këtë përkufizim, sepse primi është më i vogël se investimi që do të ishte i nevojshëm për të përftuar instrumentin financiar bazë për të cilin është i lidhur opsioni. Një shkëmbim i monedhave që kërkon një shkëmbim fillestar monedhash të ndryshme ndërmjet vlerave të drejta të barabarta plotëson përkufizimin, sepse ka një investim fillestar neto zero.

BA.4 Një mënyrë e rregullt blerjeje ose shitjeje krijon një angazhim me çmim fiks mes datës së tregtimit dhe datës së shlyerjes që plotëson përkufizimin e një derivativi. Megjithatë, për shkak të kohëzgjatjes së shkurtër, angazhimi nuk njihet si një instrument financiar derivativ. Përkundrazi, ky SNRF jep një trajtim kontabël të veçantë për këto kontrata (shih paragrafët 3.1.2 dhe B3.1.3-B3.1.6).



BA.5 Përkufizimi i një derivativi i referohet variablave jofinanciare që nuk janë specifike për një palë të kontratës. Këto përfshijnë një indeks të humblave nga tërmeti në një rajon të veçantë dhe një indeks të temperaturave në një qytet të veçantë. Variabëliti jofinanciarë specifike për një palë të kontratës përfshijnë rënien ose jo të një zjarri që dëmton ose shkatërron një aktiv të një pale në kontratë. Një ndryshim në vlerën e drejtë të një aktivi jofinanciar është specifik për pronarin, nëse vlera e drejtë pasqyron ndryshimet jo vetëm në çmimet e tregut për këto aktive (një variabël financiar), por edhe gjendjen e aktivitetit të veçantë jofinanciar të mbajtur (variabël jofinanciar). Për shembull, nëse një garanci për vlerën e mbetur të një makine specifike e ekspozon garantuesin ndaj rrezikut të ndryshimeve në gjendjen fizike të makinës, ndryshimi në këtë vlerë të mbetur është specifik për pronarin e makinës.

Aktivitetet dhe pasivitetet financiare të mbajtura për tregtim

BA.6 Tregtimi në përgjithësi pasqyron blerjen dhe shitjen aktive dhe të shpeshtë, ndaj dhe instrumentet financiare të mbajtura për tregtim në përgjithësi përdoren me qëllim që të gjenerojnë një fitim nga luhatjet afatshkurtra në çmimin ose marzhin e ndërmjetësit.

BA.7 Pasivitetet financiare të mbajtura për tregtim përfshijnë:

a) detyrimet derivative që nuk trajtohen si instrumente mbrojtëse;

b) detyrimet për të livruar aktive financiare të huazuara nga një shitës instrumentesh që nuk i ka në pronësi (d.m.th. një njësi ekonomike që shet aktive financiare që ka i marrë hua dhe nuk i ka akoma të vetat);

c) pasivitetet financiare që janë krijuar me qëllim riblerjeje të tyre në të ardhmen e afërt (p.sh. një instrument borxhi i kuotuar që emetuesi mund ta blejë përsëri në të ardhmen e afërt në varësi të ndryshimeve në vlerën e drejtë); dhe

d) pasivitetet financiare që janë pjesë e një portofoli instrumentesh financiarë të identifikuar që drejtohen së bashku dhe për të cilin ka evidencë të një modeli më të fundit të sigurimit të fitimeve afatshkurtra.

BA.8 Fakti që një detyrim është përdorur për të financuar aktivitetet tregtare nuk do të thotë se ky detyrim është i mbajtur për tregtim.

SHTOJCA C NDRYSHIMET E SNFR-VE TË TJERA

Kur një njësi ekonomike zbaton SNRF 9, të publikuar në tetor 2010, ajo duhet të zbatojë ndryshimet e kësaj shtojce, me përjashtim të rastit kur përcaktohet ndryshe. Këto ndryshime përfshijnë dhe plotësojnë ndryshimet e publikuara në shtojcën C të SNRF 9 në vitin 2009.

SNRF 1 “Adoptimi për herë të parë i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar”

C1 Paragrafi 29 është ndryshuar për t’u lexuar si vijon, është fshirë paragrafi 39B dhe janë shtuar paragrafët 29A dhe 39G:

29 Një njësi ekonomike lejohet të përcaktojë një aktiv financiar të njohur më parë si aktiv financiar me vlerë të drejtë nëpërmjet humbjes apo fitimit në përputhje me paragrafin D19A. Njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për vlerën e drejtë të këtyre aktiveve financiare në datën e përcaktimit dhe për klasifikimin dhe vlerën kontabël të tyre në pasqyrat financiare të mëparshme.

29A Një njësi ekonomike lejohet të përcaktojë një pasiv financiar të njohur më parë si pasiv financiar me vlerë të drejtë nëpërmjet humbjes apo fitimit në përputhje me paragrafin D19. Njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për vlerën e drejtë të këtyre pasiveve financiare në datën e përcaktimit dhe për klasifikimin dhe vlerën kontabël të tyre në pasqyrat financiare të mëparshme.

39B [Fshirë].

39G SNRF 9 “Instrumentet financiare”, i publikuar në tetor 2010, ndryshoi paragrafët 29, B1-B5, D1(j), D14, D15, D19 dhe D20, shtoi paragrafët 29A, B8, B9, D19A–D19D, E1 dhe E2 dhe fshiu paragrafin 39B. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime nëse zbaton SNRF 9 të nxjerrë në tetor 2010.

C2 Në shtojcën B janë ndryshuar paragrafët B1–B5 për t’u lexuar si vijon dhe janë shtuar një titull dhe paragrafi B8, dhe një titull dhe paragrafi B9:

B1 Një njësi ekonomike do të zbatojë përjashtimet në vijim:

- a) mosnjohja e aktiveve financiare dhe pasiveve financiare (paragrafët B2 dhe B3);
- b) kontabiliteti mbrojtës (paragrafët B4–B6);
- c) interesat jokontrollues (paragrafi B7);
- d) klasifikimi dhe matja e aktiveve financiare (paragrafi B8); dhe
- e) derivativët e përfshirë (paragrafi B9).

Mosnjohja e aktiveve financiare dhe pasiveve financiare

B2 Përveçsa është lejuar nga paragrafi B3, një zbatues për herë të parë duhet të zbatojë kërkesat e mosnjohjes që jepen në SNRF 9 “Instrumentet financiare” për transaksionet që ndodhin me datën 1 janar 2004 ose pas kësaj date. Me fjalë të tjera, nëse një zbatues për herë të parë nuk njeh aktive ose pasive financiare joderivative sipas PPPK-ve të tij të mëparshëm, si rrjedhojë e transaksioneve të ndodhura para datës 1 janar 2004, ai nuk do t’i njohë ato aktive dhe pasive sipas SNRF-ve (përveç rasteve kur ato kualifikohen për njohje si rezultat i një transaksioni ose ngjarjeje të mëvonshme).

B3 Pavarësisht paragrafit B2, një njësi ekonomike mund të zbatojë kërkesat e mosnjohjes të dhëna në SNRF 9 në mënyrë retrospektive, duke filluar nga një datë e përzgjedhur nga njësia ekonomike, me kusht që informacioni i cili nevojitet për të zbatuar SNRF 9 për mosnjohjen e aktiveve dhe pasiveve financiare, si rezultat i transaksioneve të ndodhura në të shkuarën, për këto transaksione ka qenë siguruar në kohën e njohjes së tyre fillestare.

Kontabiliteti mbrojtës

B4 Siç kërkohet nga SNRF 3, në datën e kalimit sipas SNRF-ve, një njësi ekonomike:

- a) mat të gjithë derivativët me vlerën e drejtë; dhe
- b) eliminon të gjitha humbjet dhe fitimet neto të shtyra që rrjedhin nga derivativët, të cilat kanë qenë të raportuara sipas PPPK-ve të mëparshëm sikur ato të ishin aktive ose pasive.

B5 Një njësi ekonomike, në pasqyrën e pozicionit financiar të çeljes sipas SNRF-ve, nuk duhet të reflektojë një marrëdhënie mbrojtëse që nuk kualifikohet si kontabilitet mbrojtës sipas SNK 39 (për shembull, shumë marrëdhënie mbrojtëse ku instrumenti mbrojtës është një instrument mjjetesh monetare ose një opion i shkruar, ose ku elementi i mbrojtur është një pozicion neto). Megjithatë, nëse një njësi ekonomike ka përcaktuar një pozicion neto si një element të mbrojtur sipas PPPK-ve të mëparshme, ajo mund ta klasifikojë një element individual brenda atij pozicioni neto, si një element të mbrojtur sipas SNRF-ve, me kusht që ajo e bën këtë jo më vonë se data e kalimit sipas SNRF-ve.

Klasifikimi dhe matja e aktiveve financiare

B8 Një njësi ekonomike vlerëson nëse një aktiv financiar plotëson kërkesat e paragrafit 4.1.2 të SNRF 9 mbi bazën e fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në datën e kalimit sipas SNRF-ve.

Derivativët e përfshirë

B9 Një zbatues për herë të parë duhet të vlerësojë nëse një derivativ i përfshirë kërkohet të veçohet nga kontrata bazë dhe të trajtohet si derivativ bazuar në kushtet ekzistuese të një date të mëvonshme nga data kur ai u bë pjesë e kontratës bazë dhe të datës kur kërkohet rivlerësimi sipas paragrafit B4.3.11 të SNRF 9.

C3 Në shtojcën D, paragrafët D1 (j), D14, D15, D19 dhe D20 janë ndryshuar si vijon dhe janë shtuar paragrafët D19A–D19D:

D1Një njësi ekonomike mund të zgjedhë të përdorë një ose disa nga përjashtimet në vijim:

- a) ...
- j) emërtimin e një instrumenti financiar të njohur më parë (paragrafët D19–D19D)
- k) ...

D14 Nëse një njësi ekonomike përgatit pasqyra financiare të veçanta, SNK 27 kërkon që investimet e saj në filiale, pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta të trajtohen ose:

- a) me kosto; ose
- b) sipas SNRF 9.



D15 Nëse një zbatues për herë të parë mat një investim të tillë me kosto, në përputhje me SNK 27, në pasqyrën e pozicionit financiar të çeljes sipas SNRF-ve duhet të masë këtë investim me një nga shumatat në vijim:

a) kosto e përcaktuar në përputhje me SNK 27; ose

b) koston e synuar. Kosto e synuar e një investimi të tillë do të jetë:

i) vlera e drejtë e tij (e përcaktuar në përputhje me SNRF 9) në datën e kalimit sipas SNRF-ve të njësisë ekonomike në pasqyrat e saj financiare të veçanta; ose

ii) vlera kontabël në atë datë sipas PPPK-ve të mëparshme.

Një zbatues për herë të parë mund të përdorë pikën (i) ose (ii) më sipër për të matur investimet e tij në çdo filial, njësi ekonomike të kontrolluar bashkërisht ose pjesëmarrje që ai zgjedh t'i masë duke përdorur koston e synuar.

D19 SNRF 9 lejon që një pasiv financiar (nëse plotëson disa kriteret) të klasifikohet si pasiv financiar me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes. Pavarësisht kësaj kërkesë, në datën e kalimit sipas SNRF-ve një njësi ekonomike lejohet të përcaktojë çdo pasiv financiar me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes nëse pasivi plotëson kërkesat e paragrafit 4.2.2 të SNRF 9 në atë datë.

D19A Një njësi ekonomike mund të përcaktojë një aktiv financiar si të matur me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes në përputhje me paragrafin 4.1.5 të SNRF 9 bazuar në faktet dhe rrethanat që ekzistojnë në datën e kalimit sipas SNRF-ve.

D19B Një njësi ekonomike mund të përcaktojë një investim në një instrument kapitali si me vlerë të drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave përmbledhëse në përputhje me paragrafin 5.7.5 të SNRF 9 bazuar në faktet dhe rrethanat që ekzistojnë në datën e kalimit sipas SNRF-ve

D19C Nëse nuk është praktike (sipas përcaktimit në SNK 8) që një njësi të zbatojë në mënyrë retrospektive metodën e interesit efektiv ose kërkesat për zhvlerësim të paragrafëve 58-65 dhe AG84-AG93 të SNK 39, vlera e drejtë e aktivitetit financiar në datën e kalimit sipas SNRF-ve do të jetë kostoja e re e amortizuar e aktivitetit financiar në atë datë.

D19D Një njësi ekonomike duhet të përcaktojë nëse trajtimi në paragrafin 5.7.7 të SNRF 9 do të sjellë mospërputhje kontabël në fitim ose humbje bazuar në faktet dhe rrethanat që ekzistojnë në datën e kalimit sipas SNRF-ve.

Matja me vlerën e drejtë e aktiveve ose pasiveve financiare në momentin e njohjes fillestare

D20 Me të gjitha kërkesat e paragrafëve 7 dhe 9, një njësi ekonomike mund të zbatojë kërkesat në fjalinë e fundit të paragrafit B5.4.8 dhe të paragrafit B5.4.9 të SNRF 9, në njërin nga mënyrat në vijim:

a) në mënyrë prospektive për transaksionet e regjistruara pas datës 25 tetor 2002; ose

b) në mënyrë prospektive për transaksionet e regjistruara pas datës 1 janar 2004.

C4 Në shtojcën E, janë shtuar një titull dhe paragrafët E1 dhe E2:

Përjashtime nga kërkesat për të riparuar informacionin krahasues për SNRF 9

E1 Në pasqyrat e para financiare sipas SNRF-ve, një njësi ekonomike që: a) zbaton SNRF-të për periudha vjetore që fillojnë përpara datës 1 janar 2012; dhe b) që zbaton SNRF 9, duhet të paraqesë informacion krahasues të paktën për një vit. Por ky informacion krahasues nuk është i nevojshëm të jetë në pajtim me SNRF 7 “Instrumentet financiare: Dhënie informacionesh shpjeguese” ose SNRF 9, për sa i takon dhënies së informacioneve shpjeguese të kërkuara nga SNRF 7 që lidhen me zërat brenda objektit të SNRF 9. Për të tilla njësi ekonomike, referimi si datë e kalimit sipas SNRF-ve, vetëm në rastin e SNRF 7 dhe SNRF 9, nënkupton fillimin e periudhës së parë të raportimit sipas SNRF-ve.

E2 Një njësi ekonomike që zgjedh të paraqesë informacione krahasuese që nuk janë në pajtim me SNRF 7 dhe SNRF 9, në vitin e parë të kalimit duhet:

a) të zbatojë kërkesat e njohjes dhe të matjes të PPPK-ve të mëparshme në vend të kërkesave për informacionin krahasues të SNRF 9, për zërat që janë brenda objektit të SNRF 9;

b) të shpjegojë këtë fakt së bashku me bazën e përdorur për të përgatitur këtë informacion;

c) të trajtojë çdo rregullim midis pasqyrës së pozicionit financiar (bilancit) në datën e raportimit të periudhës krahasuese (d.m.th. pasqyrën e pozicionit financiar që përfshin informacion krahasues sipas

PPPK-ve të mëparshme) dhe pasqyrës së pozicionit financiar në fillim të periudhës së parë të raportimit sipas SRNF-ve (d.m.th. periudhës së parë që përfshin informacionin, i cili është në pajtim me SNRF 7 dhe SNRF 9) që rrjedh nga një ndryshim në politikën kontabël, dhe të japë informacionet shpjeguese që kërkohen nga paragrafi 28(a)-(e) dhe (f)(i) të SNK 8. Paragrafi 28(f)(i) zbatohet vetëm për shumat e paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar në datën e raportimit të periudhës krahasuese;

d) të zbatojë paragrafin 17(c) të SNK 1 për dhënie informacionesh shpjeguese shitesë nëse pajtueshmëria me kërkesat specifike të SNRF-ve është e pamjaftueshme, për t'u lejuar përdoruesve të kuptojnë ndikimin e transaksioneve të veçanta, ngjarjeve dhe kushteve të tjera mbi pozicionin dhe performancën financiare të njësisë ekonomike.

SNRF 3 Kombinimet e biznesit

C5 Paragrafët 16, 42, 53, 56 dhe 58(b) janë ndryshuar si vijon, paragrafi 64A është fshirë dhe është shtuar paragrafi 64D:

16 Në disa rrethana, SNRF-të ofrojnë trajtime kontabël të ndryshme në varësi të mënyrës sesi një njësi ekonomike klasifikon ose përcakton një aktiv ose pasiv të caktuar. Shembuj të klasifikimeve ose përcaktimeve që do të bëjë blerësi në bazë të kushteve mbizotëruese në datën e blerjes, përfshijnë por nuk kufizohen vetëm në sa vijon:

a) klasifikimi i aktiveve ose pasiveve financiare të caktuara si të matura përmes vlerës së drejtë ose me koston e amortizuar në përputhje me SNRF 9 “Instrumentet financiare”;

b) përcaktimi i një instrumenti derivativ si një instrument mbrojtës në përputhje me SNK 39; dhe

c) vlerësimi nëse një derivativ i përfshirë duhet të veçohet nga një kontratë bazë në përputhje me SNRF 9 (që është çështje “klasifikimi” sipas përdorimit të termit në këtë SNRF).

42 Nëse kombinimi i bizneseve është realizuar në faza, blerësi duhet të rrimasë interesat e kapitalit të mbajtura më parë te njësia e blerë me vlerën e drejtë në ditën e blerjes dhe të njohë fitimin ose humbjen, nëse ka, në rezultatin e periudhës ose në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse, cilado qoftë më e përshtatshme. Në periudhat raportuese të mëparshme blerësi mund të ketë njohur ndryshimet në vlerën e interesave të tij te njësia e blerë në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse. Në këtë rast shuma e njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse duhet të njihet mbi të njëjtat baza si në rastin kur blerësi të kishte sistemuar menjëherë interesat e kapitalit të mbajtura më parë.

53 Kostot që lidhen me blerjen janë kostot që kryen blerësi gjatë realizimit të kombinimit të biznesit. Këto kosto përfshijnë komisionet e ndërmjetësit; të këshillimit, ligjore, kontabël, të vlerësimit dhe komisione të tjera profesionale; kosto të përgjithshme administrimi, përfshirë kostot e mbajtjes së një departamenti të brendshëm blerjeje dhe kostot e regjistrimit dhe të emetimit të letrave me vlerë të borxhit dhe të kapitalit. Blerësi do t'i trajtojë kostot që lidhen me blerjen si shpenzime të periudhave gjatë të cilave janë realizuar kostot dhe janë marrë shërbimet, me një përjashtim. Kostot e emetimit të letrave me vlerë të borxhit ose të kapitalit do të njihen në përputhje me SNK 32 dhe SNRF 9.

56 Pas njohjes fillestare dhe derisa pasivi të shlyhet, fshihet ose skadojë, blerësi do të masë një pasiv të kushtëzuar të njohur në një kombinim biznesi me vlerën më të madhe:

a) të shumës që do të njëhej sipas SNK 37; dhe

b) të shumës që do të njëhej fillimisht minus, nëse duhet, amortizimin e akumuluar të njohur në përputhje me SNK 18 “Të ardhurat”.

Kjo kërkesë nuk zbatohet për kontratat që trajtohen në përputhje me SNRF 9.

58 Disa ndryshime ...

b) Shuma e kushtëzuar e klasifikuar si një aktiv ose pasiv që:

i) është një instrument financiar dhe është brenda objektit të SNRF 9, do të matet me vlerën e drejtë, dhe çdo fitim ose humbje që do të rezultojë do të njihet në rezultatin e periudhës ose në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse, në përputhje me SNRF 9;

ii) nuk është brenda objektit të SNRF 9, do të trajtohet në përputhje me SNK 37 ose SNRF-të e tjera sipas rastit.



64A [Fshirë]

64D SNRF 9 “Instrumentet financiare”, i nxjerrë në tetor 2010, ndryshoi paragrafët 16, 42, 53, 56 dhe 58(b) dhe fshiu paragrafin 64A. Nëse zbaton SNRF 9, të nxjerrë në tetor 2010, njësia ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime.

SNRF 4 Kontratat e sigurimit

C6 [Jo i zbatueshëm për Standardin]

C7 Paragrafët 3, 4(d), 7, 8, 12, 34(d), 35 dhe 45 janë ndryshuar si vijon, paragrafi 41C është fshirë dhe është shtuar paragrafi 41D:

3 Ky SNRF nuk trajton aspekte të tjera të kontabilitetit për siguruesit, të tilla si kontabiliteti për aktivet financiare të mbajtura nga siguruesit dhe pasivet financiare të emetuara nga siguruesit (shih SNK 32 “Instrumentet financiare”: Paraqitja, SNK 39 “Instrumentet financiare”: Njohja dhe Matja, SNRF 7 dhe SNRF 9 “Instrumentet financiare”), me përjashtim të dispozitave kalimtare në paragrafin 45.

4 Një njësi ekonomike nuk do të zbatojë këtë SNRF për:

a) ...

d) kontratat e garancisë financiare me përjashtim të rastit kur emetuesi ka shprehur qartë se i sheh kontrata të tilla si kontrata sigurimi dhe ka përdorur trajtime kontabël të zbatueshme për kontratat e sigurimit. Në këtë rast emetuesi mund të zgjedhë të përdorë ose SNK 32, SNRF 7 dhe SNRF 9 ose këtë SNRF për të tilla kontrata të garancisë financiare. Emetuesi mund të zgjedhë kontratë pas kontrate por zgjedhja për secilën kontratë është e parevokueshme.

e) ...

7 SNRF 9 kërkon që një njësi ekonomike të veçojë disa derivativë të përfshirë nga kontrata e tyre bazë, t'i masë ata me vlerën e drejtë dhe të përfshijë në rezultatin e periudhës ndryshimet në vlerën e tyre të drejtë. SNRF 9 zbatohet për derivativët e përfshirë në një kontratë sigurimi me përjashtim të rastit kur derivativi i përfshirë është vetë një kontratë sigurimi.

8 Si një përjashtim nga kërkesat e SNRF 9, një sigurues nuk ka nevojë të veçojë dhe masë me vlerë të drejtë opsionin si mbajtës i një police për një shumë fikse (ose për një shumë të bazuar në një shumë fikse dhe një normë interesi) edhe nëse çmimi i ushtrimit ndryshon nga vlera kontabël e pasivit të siguruar bazë. Megjithatë, kërkesat e SNRF 9 janë të zbatueshme për një opsion për shitje ose opsion për të dhënë mjete monetare, të përfshirë në një kontratë sigurimi, nëse vlera për t'u dhënë ndryshon në varësi të ndryshimeve në një variabël financiar (si p.sh. çmimi ose indeksi i një aksioni apo malli), ose në një variabël jofinanciar që nuk është specifik për një palë të kontratës. Këto kërkesa zbatohen, gjithashtu, edhe në rastin kur aftësia e mbajtësit për të ushtruar opsionin për shitje ose opsion për të dhënë mjete monetare nxitet nga një ndryshim në këtë variabël (për shembull një opsion për shitje që mund të ushtrohet nëse indeksi i bursës arrin një nivel të caktuar).

12 Për të hequr barrën e një kontrate, një sigurues:

a) do të zbatojë këtë SNRF për përbërësin e siguruar;

b) do të zbatojë SNRF 9 për përbërësin depozitë.

34 Disa kontrata sigurimi përfshijnë një tipar pjesëmarrjeje sipas dëshirës, si dhe një element të garantuar. Emetuesi i një kontrate të tillë:

a) ...

d) do të zbatojë SNRF 9 për derivativin e përfshirë, nëse kontrata përmban një derivativ të përfshirë brenda objektit të SNRF 9.

e) ...

Tiparet e pjesëmarrjes së lirë në instrumentet financiare

35 Kërkesat në paragrafin 34 zbatohen edhe për një instrument financiar që përmban një tipar pjesëmarrjeje të lirë. Për më tepër:

a) Nëse emetuesi klasifikon të gjithë tiparin e pjesëmarrjeje së lirë si një pasiv, duhet të zbatojë testin e përshtatshmërisë së pasivit në paragrafët 15–19 për të gjithë kontratën (d.m.th. si për elementin e garantuar, ashtu edhe për tiparin e pjesëmarrjes së lirë). Nuk është e nevojshme që emetuesi të përcaktojë shumën që do të rezultojë nga zbatimi i SNRF 9 në elementin e garantuar.

b) Nëse emetuesi klasifikon një pjesë ose të gjithë këtë tipar si një përbërës të veçantë të kapitalit, pasivi i njohur për të gjithë kontratën nuk duhet të jetë më i vogël se shuma që do të rezultonte nga zbatimi i SNRF 9 tek elementi i garantuar. Kjo shumë do të përfshijë vlerën e brendshme të një opsioni për të dhënë kontratën por nuk është e nevojshme që të përfshijë vlerën në kohë nëse paragrafi 9 e përjashton këtë opsion nga matja me vlerën e drejtë. Nuk është e nevojshme që emetuesi të japë informacion shpjegues për shumën që do të rezultojë nga zbatimi i SNRF 9 për elementin e garantuar ose që ta paraqesë këtë shumë veçmas. Gjithashtu, nuk është e nevojshme që emetuesi të përcaktojë këtë shumë nëse totali i njohur i pasivit është dukshëm më i madh.

c) ...

41C [Fshirë]

41D SNRF 9 “Instrumentet financiare”, i nxjerrë në tetor 2010, ndryshoi paragrafët 3, 4(d), 7, 8, 12, 34(d), 35, 45 dhe B18-B20 dhe shtojcën A dhe fshiu paragrafin 41C. Nëse zbaton SNRF 9 të nxjerrë në tetor 2010, njësia ekonomike duhet të zbatohet këto ndryshime.

45 Pavarësisht nga paragrafi 4.4.1 i SNRF 9, nëse një sigurues ndryshon politikat e tij kontabël për pasivet e sigurimit, lejohet por nuk kërkohet të riklasifikojë disa ose të gjitha aktivet e tij financiare kështu që ato mund të maten me vlerën e drejtë. Ky riklasifikim lejohet nëse një sigurues ndryshon politikat kontabël gjatë zbatimit për herë të parë të këtij SNRF, dhe nëse ai bën një ndryshim të mëpasshëm të politikës së lejuar nga paragrafi 22. Riklasifikimi është një ndryshim në politikën kontabël dhe për të zbatohet SNK 8.

C8 Në shtojcën A përcaktimi i termit “përbërës depozitë” është ndryshuar si vijon:

Përbërës depozitë Një përbërës kontraktual që nuk është trajtuar si derivativ sipas SNRF 9 dhe që është brenda objektit të SNRF 9 nëse do të ishte një instrument i veçantë.

C9 Në shtojcën B, paragrafët B18–B20 janë ndryshuar si vijon:

B18 Në vijim jepen shembuj të kontratave që janë kontrata sigurimi nëse transferimi i rrezikut të sigurimit është i rëndësishëm:

a) ...

g) sigurimi i kredisë nëse kërkon që të bëhen pagesa të specifikuara për të shpërblyer mbajtësin për një humbje të ndodhur në rast se një debitor nuk arrin të bëjë pagesën e kërkuar sipas kushteve fillestare ose të modifikuara të një instrumenti borxhi. Këto kontrata mund të kenë forma ligjore të ndryshme, të tilla si: garanci, disa tipa letrash krediti, një kontratë krediti derivative ose një kontratë sigurimi. Megjithatë, ndonëse këto kontrata plotësojnë përkufizimin e një kontrate sigurimi, ato plotësojnë edhe përkufizimin e një kontrate garancie financiare sipas SNRF 9 dhe janë brenda objektit të SNK 32 [fshirë shënimi në fund të faqes] dhe SNRF 9 dhe jo të këtij SNRF (shih paragrafin 4(d)). Sidoqoftë, nëse një emetues i kontratave të garancisë financiare ka shprehur qartë më parë se i sheh këto kontrata si kontrata sigurimi dhe ka përdorur trajtime kontabël të zbatueshme për kontratat e sigurimit, ai mund të zgjedhë të zbatohet ose SNK 32 [fshirë shënimi në fund të faqes] dhe SNRF 9 ose këtë SNRF për kontrata të tilla të garancisë financiare.

h) ...

B19 Në vijim jepen shembuj të zërave që nuk janë kontrata sigurimi:

a) ...

e) derivativët që ekspozojnë një palë ndaj rrezikut financiar por jo ndaj rrezikut të sigurimit, sepse kërkojnë që pala të bëjë pagesa vetëm për ndryshimet në një ose disa prej normave të caktuara të interesit, çmimeve të instrumenteve financiare të caktuara, çmimeve të mallrave të caktuara, kurseve të caktuara të këmbimit, indekseve të çmimeve ose normave të caktuara, indekseve të kredive ose klasifikimit të kredive ose të variabëlve të tjerë, me kushtin që në rastin e një variabëli jofinanciar, ky variabël nuk është specifik për palën në kontratë (shih SNRF 9).



f) një garanci e lidhur me kredinë (ose letër krediti, kontratë krediti derivativ ose kontrata sigurimi kredie) që kërkon pagesa edhe nëse mbajtësi nuk ka pësuar një humbje nga paaftësia e debitorit për të kryer pagesat në kohë (shih SNRF 9).

g) ...

B20 Nëse kontrata e përshkruar në paragrafin B19 krijon aktive ose pasive financiare, ata janë brenda objektit të SNRF 9. Ndër të tjera kjo do të thotë ...

SNRF 5 Aktivitet Afatgjata që Mbahen për Shitje dhe Operacionet Jo të Vijueshme

C10 Paragrafi 5 është ndryshuar si vijon dhe është shtuar paragrafi 44F:

5 Dispozitat për matjen në këtë SNRF [fshirë shënimi në fund të faqes] nuk zbatohen për aktivet e mëposhtme, që trajtohen nga standardet e listuara, qoftë si aktive individuale, ose qoftë si pjesë e një grupi të nxjerrë jashtë përdorimit:

a) ...

c) aktivet financiare brenda objektit të SNRF 9 “Instrumentet financiare”.

d) ...

44F SNRF 9 “Instrumentet financiare”, i nxjerrë në tetor 2010, ndryshoi paragrafin 5. Nëse zbaton SNRF 9 të nxjerrë në tetor 2010, njësia ekonomike duhet të zbatojë këtë ndryshim.

SNRF 7 “Instrumentet financiare”: Dhënie informacionesh shpjeguese

C11 Paragrafët 2–5, 8–10, 11, 14, 20, 28 dhe 30 janë ndryshuar si vijon, janë fshirë paragrafët 12, 12A, 29(b) dhe 44H, dhe janë shtuar një titull dhe paragrafët 10A, 11A, 11B, 12B–12D, 20A, 44I, 44J dhe 44N:

2. Parimet në këtë SNRF plotësojnë parimet për njohjen, matjen dhe paraqitjen e aktiveve financiare dhe pasiveve financiare në SNK 32 “Instrumentet financiare: Paraqitja” dhe SNRF 9 “Instrumentet financiare”.

Objekti

3. Ky SNRF duhet të zbatohet nga të gjitha njësitë ekonomike për të gjitha llojet e instrumenteve financiare me përjashtim të:

a) interesave në filiale, pjesëmarrje dhe shoqëritë e përbashkëta, të cilat trajtohen në përputhje me SNK 27 “Pasqyrat financiare të konsoliduara dhe të veçanta”, SNK 28 “Investimet në pjesëmarrje” ose SNK 31 “Interesa në shoqëritë e përbashkëta”. Megjithatë, në disa raste SNK 27, SNK 28 ose SNK 31 lejon që një njësi ekonomike të trajtojë interesat në një filial, pjesëmarrje ose shoqëri të përbashkët duke përdorur SNRF 9; në këto raste, njësitë ekonomike duhet të zbatojnë kërkesat e këtij SNRF. Njësitë ekonomike duhet të zbatojnë këtë SNRF për të gjithë derivativët e lidhur me interesat në filiale, pjesëmarrje ose shoqëri të përbashkëta, me përjashtim të rastit kur derivativi plotëson përkufizimin e një instrumenti kapitali sipas SNK 32.

b) ...

d) kontratat e sigurimit siç përcaktohen në SNRF 4 “Kontratat e sigurimit”. Megjithatë, ky SNRF zbatohet për derivativët që janë të përfshirë në kontratat e sigurimit nëse SNRF 9 kërkon që njësia ekonomike t’i trajtojë ato veçmas. Gjithashtu, një emetues duhet të zbatojë SNRF për kontratat e garancisë financiare nëse emetuesi zbaton SNRF 9 në njohjen dhe matjen e kontratave por duhet të zbatojë SNRF 4 nëse emetuesi zgjedh, në përputhje me paragrafin 4 (d) të SNRF 4, të zbatojë SNRF 4 në njohjen dhe matjen e tyre.

e) ...

4. Ky SNRF zbatohet për instrumentet financiare të njohura dhe të panjohura. Instrumentet financiare të njohura përfshijnë aktive financiare dhe pasive financiare që janë objekt i SNRF 9. Instrumentet financiare të panjohura përfshijnë disa instrumente financiare që, megjithëse janë jashtë objektit të SNRF 9, janë objekt i këtij SNRF (të tilla si disa angazhimet e huas).

5. Ky SNRF zbatohet për kontratat për të blerë ose shitur një zë jofinanciar që është objekt i SNRF 9.

8. Vlera kontabël e secilës prej kategorive vijuese, siç përcaktohet në SNRF 9, duhet të paraqitet në bilanc ose në shënimet shpjeguese:

a) aktivet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, duke paraqitur veçmas: i) ato që janë të tilla nga njohja fillestare; dhe ii) ato që klasifikohen si të mbajtura për shitje në përputhje me SNRF 9;

b)-(d)[fshirë];

e) pasivet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, duke paraqitur veçmas: i) ato që janë të tilla nga njohja fillestare; dhe ii) ato që klasifikohen si të mbajtura për shitje në përputhje me SNRF 9;

f) aktivet financiare të matura me koston e amortizuar;

g) pasivet financiare të matura me koston e amortizuar;

h) aktivet financiare të matura me vlerën e drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave të tjera përmbledhëse.

Aktivitet financiare ose pasivet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes

9 Nëse një njësi ekonomike ka përcaktuar si të matur me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes një aktiv financiar (ose grupativesh financiare) që ndryshe do të mateshin me koston e amortizuar, duhet të japë informacione shpjeguese për:

a) ekspozimin maksimal ndaj rrezikut të kredisë (shih paragrafin 36 (a)) të aktivitet financiar (ose grupit të aktiveve financiare) në datën e raportimit;

b) shumën me të cilën çdo derivativ kredie i lidhur ose instrumente të ngjashëm zbusin këtë ekspozim maksimal ndaj rrezikut të kredisë;

c) shumën e ndryshimit, gjatë periudhës dhe shumën e akumuluar, me vlerën e drejtë të aktivitet financiar (ose të grupit aktiveve financiare), e cila i takon ndryshimit në rrezikun e kredisë së aktiveve financiare të përcaktuara; ose

i) ...

d) shumën e ndryshimit në vlerën e drejtë të çdo derivativi kredie të lidhur ose instrumenti të ngjashëm që ka ndodhur gjatë periudhës dhe në mënyrë kumulative që prej momentit të përcaktimit të aktivitet financiar.

10. Nëse një njësi ekonomike ka përcaktuar një pasiv financiar me vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes në përputhje me paragrafin 4.2.2 të SNRF 9 dhe kërkohet të paraqesë efektet e ndryshimeve në rrezikun e kredisë të këtij pasivi në pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (shih paragrafin 5.7.7 të SNRF 9) duhet të japë informacione shpjeguese për:

a) shumën e ndryshimit të akumuluar, në vlerën e drejtë të pasivit financiar që i takon ndryshimeve në rrezikun e kredisë së këtij pasivi (shih paragrafët B5.7.13-B5.7.20 të SNRF 9 si udhëzues për të përcaktuar efektet e ndryshimeve në rrezikun e kredisë të pasivit);

b) diferencën mes vlerës kontabël të pasivit financiar dhe shumës që njësia ekonomike është e detyruar të paguajë në maturim mbajtësit të detyrimit sipas kontratës;

c) çdo transferim të fitimit ose humbjes së akumuluar në kapital gjatë periudhës përfshirë arsyet e këtyre transferimeve;

d) nëse një pasiv nuk njihet gjatë periudhës, shuma e paraqitur (nëse ka) në pasqyrën e të ardhurave të tjera përmbledhëse që realizohet në momentin e çregjistrimit.

10A Nëse një njësi ekonomike ka përcaktuar një pasiv financiar me vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes në përputhje me paragrafin 4.2.2 të SNRF 9 dhe kërkohet të paraqesë efektet e ndryshimeve në rrezikun e kredisë të këtij pasivi në rezultatin e periudhës (shih paragrafët 5.7.7 dhe 5.7.8 të SNRF 9) duhet të japë informacione shpjeguese për:

a) shumën e ndryshimit, gjatë periudhës dhe të akumuluar, në vlerën e drejtë të pasivit financiar që i takon ndryshimeve në rrezikun e kredisë të këtij pasivi (shih paragrafët B5.7.13-B5.7.20 të SNRF 9 si udhëzues për të përcaktuar efektet e ndryshimeve në rrezikun e kredisë të pasivit); dhe

b) diferencën mes vlerës kontabël të pasivit financiar dhe shumës që njësia ekonomike është e detyruar t'i paguajë në maturim mbajtësit të detyrimit sipas kontratës.

11. Njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese edhe:



a) për një përshkrim të detajuar të metodave të përdorura për të plotësuar kërkesat në paragrafët 9 (c), 10 (a) dhe 10A(a) dhe paragrafët 5.7.7(a) të SNRF 9, përfshirë një shpjegim se pse metoda është e përshtatshme;

b) për nëse njësia ekonomike beson se informacionet shpjeguese të dhëna në pasqyrën e bilancit ose në shënimet shpjeguese, për të plotësuar kërkesat në paragrafët 9 (c), 10 (a) dhe 10A(a) ose paragrafët 5.7.7(a) të SNRF 9, nuk paraqesin në mënyrë besnike ndryshimin në vlerën e drejtë të aktivitetit financiar ose pasivitetit financiar që i takon ndryshimeve në rrezikun e tij të kredisë, arsyet që sjellin këto përfundime dhe faktorët që ajo mendon se janë të rëndësishëm;

c) për një përshkrim të detajuar të metodës ose metodave të përdorura për të përcaktuar nëse paraqitja e efekteve të ndryshimit në rrezikun e kredisë të një pasivi në pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse do të krijojë ose zmadhojë një mospërputhje kontabël në fitim ose humbje (shih paragrafët 5.7.7 dhe 5.7.8 të SNRF 9). Nëse një njësi ekonomike duhet të paraqesë efektet e ndryshimit në rrezikun e kredisë të një pasivi në rezultatin e periudhës (shih paragrafin 5.7.8 të SNRF 9), dhënia e informacioneve shpjeguese duhet të përfshijë një përshkrim të detajuar të marrëdhënies ekonomike të përcaktuar në paragrafin B5.7.6 të SNRF 9.

Aktivitetet financiare të matura me vlerë të drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

11A Nëse një njësi ekonomike ka përcaktuar investime në instrumente kapitali që maten me vlerën e drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, siç lejohet nga paragrafi 5.7.5 i SNRF 9, ajo duhet të japë informacione shpjeguese:

a) se cilat investime në instrumente kapitali janë përcaktuar si të matura me vlerën e drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse;

b) për arsyet e përdorimit të kësaj alternative paraqitjeje;

c) për vlerën e drejtë të secilit prej këtyre investimeve në datën e raportimit;

d) për dividendët e njohur gjatë periudhës duke treguar veçmas ata që lidhen me investimet e panjohura gjatë periudhës së raportimit dhe ata që lidhen me investimet e mbajtura në datën e raportimit;

e) çdo transferim të fitimit ose humbjes së akumuluar në kapital gjatë periudhës, përfshirë arsyet e këtyre transferimeve.

11B Nëse një njësi ekonomike nuk i njeh investimet në instrumente kapitali të matura me vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes në pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse gjatë periudhës së raportimit, ajo duhet të japë informacione shpjeguese:

a) për arsyet e daljes nga përdorimi të investimit;

b) për vlerën e drejtë të investimeve në datën e çregjistrimit;

c) për fitimin ose humbjen e akumuluar nga dalja nga përdorimi.

12B Një njësi ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese, nëse në periudhën aktuale ose të mëparshme të raportimit, ka riklasifikuar ndonjë aktiv financiar në përputhje me paragrafin 4.4.1 të SNRF 9. Për çdo rast të tillë, njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese:

a) për datën e riklasifikimit;

b) një shpjegim të detajuar për ndryshimin në modelin e biznesit dhe një përshkrim me fjalë të efekteve të tij në pasqyrat financiare të njësisë ekonomike;

c) për shumën e riklasifikuar brenda dhe jashtë çdo kategorie.

12C Për çdo periudhë raportimi pas riklasifikimit e deri në çregjistrim, njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese për aktivitetet e riklasifikuara të matura me koston e amortizuar në përputhje me paragrafin 4.4.1 të SNRF 9 për:

a) interesin efektiv të përcaktuar në datën e riklasifikimit; dhe

b) të ardhurën ose shpenzimin e njohur nga interesi.

12D Nëse një njësi ekonomike ka riklasifikuar aktive financiare që ato të maten me koston e amortizuar, duke filluar nga periudha e fundit vjetore e raportimit, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për:

a) vlerën e drejtë të aktiveve financiare në fund të periudhës së raportimit; dhe

b) vlerën e drejtë të fitimit ose humbjes që do të njihej në rezultat gjatë periudhës së raportimit nëse aktivet financiare nuk do të ishin riklasifikuar.

14 Një njësi ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese për:

- a) vlerën kontabël të aktiveve financiare që ka premtuar si garanci për pasive të kushtëzuara ose jo, përfshirë shumat që janë riklasifikuar në përputhje me paragrafin 3.3.23(a) të SNRF 9; dhe
- b) afatet dhe kushtet e lidhura me këto premtime.

20. Një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për zërat në vijim të të ardhurave, shpenzimeve, fitimeve ose humbjeve ose në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, ose në shënimet shpjeguese:

a) fitimet neto ose humbjet neto nga:

i) aktivet financiare ose pasivet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, duke paraqitur veçmas ato që vijnë nga aktive financiare ose pasive financiare të përcaktuara si të tilla nga njohja fillestare dhe ato që vijnë nga aktive financiare ose pasive financiare që maten detyrimisht me vlerën e drejtë në përputhje SNRF 9 (p.sh. pasive financiare që plotësojnë përkufizimin si të mbajtura për shitje në përputhje me SNRF 9). Për pasivet financiare të përcaktuara si me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes, një njësi ekonomike do të paraqesë veçmas shumën e fitimit ose humbjes të njohur në pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse dhe shumën e njohur në fitim ose humbje;

ii)-(iv) [fshirë];

v) pasivet financiare të matura me koston e amortizuar;

vi) aktivet financiare të matura me koston e amortizuar;

vii) aktivet financiare të matura me vlerën e drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

b) totalin e të ardhurave nga interesi dhe shpenzimet gjithsej nga interesi (të llogaritura duke përdorur metodën e interesit efektiv) për aktivet financiare që maten me koston e amortizuar ose pasivet financiare që nuk maten me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes.

c) të ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet (të ndryshme nga shumat e përfshira në përcaktimin e normës efektive të interesit) që vijnë nga:

i) aktivet financiare që maten me koston e amortizuar ose pasivet financiare të cilat nuk maten me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes; dhe

ii) aktivitetet *trust* dhe veprimtari besimi të tjera që vijnë nga mbajtja ose investimi i aktiveve për llogari të të tretëve, trusteeve, skemave të përfitimit të pensionit dhe institucioneve të tjera.

d) të ardhurat nga interesi i aktiveve financiare të zhvlerësuara të përlllogaritura në përputhje me paragrafin AG93 të SNK 39.

e) ...

20A Një njësi ekonomike do të japë në shënimet shpjeguese një analizë të fitimit ose humbjes së njohur në pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse që vjen nga mosnjohja e aktiveve financiare të matura me koston e amortizuar, duke treguar veçmas fitimet ose humbjet që vijnë nga mosnjohja e këtyre aktiveve financiare. Kjo dhënie informacionesh shpjeguese duhet të përfshijë arsyet për mosnjohjen e këtyre aktiveve financiare.

28. Nëse tregu për një instrument financiar nuk është aktiv, një njësi ekonomike përcakton vlerën e drejtë të tij duke përdorur një teknikë vlerësimi (shih paragrafët B5.4.6-B5.4.12 të SNRF 9). Megjithatë, evidenca më e mirë e vlerës së drejtë në njohjen fillestare është çmimi i transaksionit (p.sh. vlera e drejtë e konsideratës së dhënë ose të marrë), me përjashtim të rastit kur plotësohen kushtet e përshkruara në paragrafin B5.4.8 të SNRF 9. Si pasojë, mund të ketë një ndryshim mes vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe shumës që do të përcaktohet në po atë datë, duke përdorur teknikën e vlerësimit. Nëse ka një ndryshim të tillë, një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues, për çdo klasë të instrumentit financiar:

a) për politikën kontabël të saj për njohjen e kësaj difference në fitimin ose humbjen për të pasqyruar një ndryshim në faktorët (përfshirë kohën) që do të marrin në konsideratë pjesëmarrësit në treg në vendosjen e një çmimi (shih paragrafin B5.4.9 të SNRF 9); dhe



b) për diferencën gjithsej të mbetur për t'u njohur në fitimin ose humbjen në fillim dhe në fund të periudhës dhe një rakordim të ndryshimeve në tepricën e kësaj difference.

29. Nuk kërkohet dhënie e informacioneve shpjeguese për vlerën e drejtë:

- a) ...
- b) [fshirë]
- c) ...

30 Në rastet e përshkruara në paragrafin 29(b), një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për të ndihmuar përdoruesit e pasqyrave financiare që të bëjnë gjykimet e tyre lidhur me madhësinë e ndryshimeve të mundshme mes vlerës kontabël të këtyre kontratave dhe vlerës së drejtë të tyre, duke përfshirë:

- a) ...
- 44H [fshirë]

44I Kur një njësi ekonomike zbaton për herë të parë SNRF 9, duhet të japë informacione shpjeguese për secilën klasë të aktiveve financiare në datën e zbatimit fillestar për:

- a) kategorinë fillestare të matjes dhe vlerën kontabël të përcaktuar në përputhje me SNK 39;
- b) kategorinë e re të matjes dhe vlerën kontabël të përcaktuar në përputhje me SNK 39;
- c) shumën e çdo aktivi financiar në pasqyrën e pozicionit financiar që më parë ishte përcaktuar për t'u matur me vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes, por që tashmë nuk përcaktohen si të tillë, duke dalluar mes atyre për të cilët SNRF 9 kërkon riklasifikim dhe atyre për të cilët njësia ekonomike zgjedh të riklasifikojë.

Një njësi ekonomike duhet të paraqesë këtë informacion sasior në formë tabele, me përjashtim të rastit kur një format tjetër është më i përshtatshëm.

44J Kur një njësi ekonomike zbaton për herë të parë SNRF 9, ajo duhet të japë informacione shpjeguese cilësore për t'u mundësuar përdoruesve të kuptojnë:

- a) mënyrën se si njësia ka zbatuar kërkesat për klasifikim të SNRF 9 për ato aktive financiare, klasifikimi i të cilave ndryshoi si rezultat i zbatimit të SNRF 9;
- b) arsyet për çdo përcaktim ose jo të aktiveve ose pasiveve financiare si të matur me vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes.

44N SNRF 9 "Instrumentet financiare", i nxjerrë në tetor 2010, ndryshoi paragrafët 2-5, 8-10, 11, 14, 20, 28, 30, shtojcën A, B1, B5, B10 (a), B22 dhe B27, shtoi paragrafët 10A, 11A, 11B, 12B-12D, 20A, 44I dhe 44J, dhe fshiu paragrafët 12, 12A, 29 (b), 44H, B4 dhe shtojcën D. Nëse zbaton SNRF 9 të nxjerrë në tetor 2010, njësia ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime.

C12 Në shtojcën A, paragrafi i fundit është ndryshuar për t'u lexuar si vijon:

Termat në vijim janë përkufizuar në paragrafin 11 të SNK 32, paragrafin 9 të SNK 39 ose shtojcën A të SNRF 9 dhe përdoren në SNRF me kuptimin e përcaktuar në SNK 32, SNK 39 dhe SNRF 9:

- Kosto e amortizuar e një aktivi ose pasivi financiar;
- Çregjistrimi;
- Derivativ;
- Metoda e interesit efektiv;
- Instrument kapitali;
- Vlera e drejtë;
- Aktiv financiar;
- Kontratë garancie financiare;
- Instrument financiar;
- Pasiv financiar;
- Pasiv financiar me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes;
- Transaksion parashikues;
- Instrument mbrojtës;
- I mbajtur për tregtim;

- Data e riklasifikimit;
- Blerje ose shitje në mënyrë të rregullt.

C13 Në shtojcën B, paragrafi B4 është fshirë dhe paragrafët B1, B5, B10(a), B22 dhe B27 janë ndryshuar si vijon:

B1 Paragrafi 6 kërkon që një njësi ekonomike të grupojë instrumentet financiare në klasa që janë të përshtatshme me natyrën e informacionit të paraqitur dhe që merr në konsideratë karakteristikat e këtyre instrumenteve financiare. Klasat e përshkruara në paragrafin 6 përcaktohen nga njësi ekonomike dhe prandaj janë të dallueshme nga kategoritë e instrumenteve financiare të specifikuar në SNRF 9 (i cili përcakton mënyrën si maten instrumentet financiare dhe kur njihen ndryshimet në vlerën e drejtë).

B5 Paragrafi 21 kërkon dhënie informacionesh shpjeguese për bazën (ose bazat) e matjes të përdorura në përgatitjen e pasqyrave financiare dhe për politikën kontabël të tjera të përdorura, të cilat janë të rëndësishme për të kuptuar pasqyrat financiare. Për instrumentet financiare, dhënie informacionesh shpjeguese të tilla mund të përfshijnë:

- a) për pasivet financiare të përcaktuara me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes:
 - i) natyrën e pasiveve financiare të cilat njësi ekonomike i ka përcaktuar me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes;
 - ii) kriterin për një përcaktim të tillë të këtyre pasiveve financiare në njohjen fillestare; dhe
 - iii) mënyrën sesi njësi ekonomike ka plotësuar kushtet e paragrafit 4.2.2 të SNRF 9 për këtë përcaktim.
- aa) për aktivet financiare të përcaktuara me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes:
 - i) natyrën e aktiveve financiare të cilat njësi ekonomike i ka përcaktuar me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes; dhe
 - ii) mënyrën se si njësi ekonomike ka plotësuar kushtet e paragrafit 4.2.2 të SNRF 9 për këtë përcaktim;
- b) [fshirë];
- c) faktin nëse blerjet dhe shitjet në mënyrë të rregullt të aktiveve financiare janë kontabilizuar në datën e tregtimit ose të shlyerjes (shih paragrafin 3.1.2 të SNRF 9);
- d) ...

B10 Aktivitetet që sjellin rrezikun e kredisë dhe ekspozimin maksimal që shoqëron rrezikun e kredisë, përfshijnë por nuk kufizohen vetëm në:

- a) dhënien e huave për klientët dhe vendosjen e depozitave me njësi të tjera ekonomike. Në raste të tilla ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë është vlera kontabël e aktiveve financiare përkatëse;
- b) ...

B22 Rreziku i normës së interesit rezulton në instrumentet financiare bartës të interesit të njohur në bilanc (p.sh. instrumentet e borxhit të blerë ose të emetuar) dhe në disa instrumente financiare të panjohura në bilanc (p.sh. disa angazhime huaje).

B27 Në përputhje me paragrafin 40 (a) ndjeshmëria e fitimit ose humbjes (që vjen për shembull nga instrumentet e matura me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes) paraqitet veçmas ndjeshmërisë së pasqyrës së të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (që vjen, për shembull nga investimet në instrumente kapitali, ndryshimet në vlerën e drejtë të të cilave paraqiten në pasqyrën e të ardhurave të tjera përmbledhëse).

C14 Shtojca D është fshirë.

SNK 1 Paraqitja e pasqyrave financiare

C15 Në paragrafin 7, përkufizimi i “të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse” dhe paragrafët 68, 71, 82, 93, 95 dhe 123 janë ndryshuar si vijon, paragrafi 139E është fshirë dhe është shtuar paragrafi 139G.

7. Termat në vijim përdoren në këtë Standard me kuptimin e specifikuar më poshtë:

“Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse” përfshin zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve (përfshirë rregullimet për riklasifikim) që nuk janë njohur në fitim ose humbje sipas kërkesave apo lejes së SNRF-ve të tjera.



Përbërësit e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse:

- a) ...;
- d) fitimet dhe humbjet nga investimet në instrumentet e kapitalit të matur me vlerën e drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse në përputhje me paragrafin 5.7.5 të SNRF 9 “Instrumentet financiare”;
- e) pjesën përkatëse të fitimeve ose humbjeve nga instrumentet mbrojtëse në një mbrojtje të fluksit monetar (shih SNK 39 “Instrumentet financiare: Njohja dhe matja”);
- f) për pasive të veçanta të përcaktuara si me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbje, shumën e ndryshimit në vlerën e drejtë që i takon ndryshimeve në rrezikun e kredisë të pasivit (shih paragrafin 5.7.7 të SNRF 9).

....

68 Cikli i shfrytëzimit i një njësie ekonomike ... Aktivet afatshkurtra përfshijnë edhe aktivet e mbajtura kryesisht për qëllime tregtare (shembuj përfshijnë disa aktive financiare që plotësojnë përkufizimin në SNRF 9 e të mbajturave për tregtim) dhe pjesa afatshkurtër e aktiveve afatgjata financiare.

71 Pasivet e tjera afatshkurtra që nuk janë shlyer gjatë ciklit normal të shfrytëzimit por që duhet të shlyhen brenda dymbëdhjetë muajve nga periudha e raportimit ose që mbahen kryesisht për qëllime tregtare. Shembuj janë disa pasive financiare që plotësojnë përkufizimin si të mbajtura për tregtim në SNRF 9, *overdraftet* (zbulimet) bankare dhe pjesa afatshkurtër e aktiveve afatgjata financiare, dividendët e pagueshëm, tatimi mbi të ardhurat dhe të pagueshme të tjera jotregtare. Pasivet financiare që sigurojnë financim mbi baza afatgjata (d.m.th. nuk janë pjesë e kapitalit qarkullues të përdorur gjatë ciklit normal të shfrytëzimit të njësisë ekonomike) dhe që nuk kërkohet të shlyhen brenda dymbëdhjetë muajve nga periudha e raportimit janë pasive afatgjata, objekt i paragrafëve 74 dhe 75.

82. Pasqyra e ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të përmbajë minimalisht zërat që paraqesin shumat vijuese për periudhën:

- a) të ardhurat;
- aa) fitimet ose humbjet që vijnë nga çregjistrimi i aktiveve financiare të matura me koston e amortizuar;
- b) kostot e financimit;
- c) pjesën e fitimit ose humbjes nga pjesëmarrjet dhe shoqëritë e përbashkëta të kontabilizuara sipas metodës së kapitalit neto;
- ca) nëse një aktiv financiar riklasifikohet që të matet me vlerën e drejtë, çdo fitim ose humbje që vjen nga diferenca mes vlerës së mëparshme kontabël dhe vlerës së drejtë të tij në datën e riklasifikimit (siç përcaktohet në SNRF 9);
- d) ...

93. SNRF-të e tjera specifikojnë nëse shumat e njohura më parë në pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse klasifikohen në fitim ose humbje. Riklasifikime të tilla, në këtë Standard përcaktohen si rregullime riklasifikimi. Një rregullim riklasifikimi përfshihet me përbërësin përkatës të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse në periudhën që rregullimi riklasifikohet si fitim ose humbje. Këto shuma mund të jenë njohur në pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

...

95. Rregullimet e riklasifikimit vijnë, për shembull, nga shitja ose heqja dorë e një veprimi të kryer jashtë vendit (shih SNK 21) dhe kur një transaksion parashikues i mbrojtur ndikon fitimin ose humbjen (shih paragrafin 100 të SNK 39 në lidhje me mbrojtjen e fluksit monetar).

123 Gjatë zbatimit të politikave kontabël të njësisë ekonomike, drejtimi përdor gjykime të ndryshme, përveç atyre që përfshijnë vlerësime, të cilat mund të ndikojnë ndjeshëm shumat e njohura në pasqyrat financiare. Për shembull, drejtimi përdor gjykimin në përcaktimin e:

- a) [fshirë];
- b) ...

139E [Fshirë]

139G SNRF 9 “Instrumentet financiare”, i nxjerrë në tetor 2010, ndryshoi paragrafët 7, 68, 71, 82, 93, 95 dhe 123 dhe fshiu paragrafin 139E. Nëse zbaton SNRF 9 të nxjerrë në tetor 2010, njësia ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime.

SNK 2 Inventaret

C16 Paragrafi 2(b) është ndryshuar si vijon, paragrafi 40A është fshirë dhe është shtuar paragrafi 40B:

2 Ky standard zbatohet për të gjithë inventarët, me përjashtim të:

a) ...;

b) instrumenteve financiare (shih SNK 32 “Instrumentet financiare: Paraqitja” dhe SNRF 9 “Instrumentet financiare); dhe

c) ...

40A [Fshirë]

40B SNRF 9 “Instrumentet financiare”, i nxjerrë në tetor 2010, ndryshoi paragrafin 2 (b) dhe fshiu paragrafin 40A. Nëse zbaton SNRF 9 të nxjerrë në tetor 2010, njësia ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime.

SNK 8 Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet

C17 Paragrafi 53 ndryshohet si vijon, paragrafi 54A është fshirë dhe është shtuar paragrafi 54B.

53. Nuk kërkohet zbatimi retrospektiv i një politike të re kontabël për një periudhë paraardhëse ose korigjimi i shumave për një periudhë paraardhëse, qoftë në bërjen e supozimeve rreth atyre se cilat duhet të ishin synimet e drejtimit në periudhën paraardhëse ose për vlerësimin e shumave të njohura, matura apo paraqitura në një periudhë paraardhëse. Për shembull, kur një njësi ekonomike korigjon një gabim të periudhës paraardhëse në llogaritjen e detyrimeve të tij për lejet e paafëtisë së përkohshme në punë të akumuluar në përputhje me SNK 19 “Përfitimet e të punëmarrësve”, nuk merr parasysh informacionin rreth një sezoni gripi të rëndë të pazakontë gjatë periudhës tjetër që bëhet i disponueshëm pasi pasqyrat financiare për periudhën paraardhëse janë autorizuar për publikim. Fakti që vlerësime të rëndësishme shpesh kërkohen kur ndryshohen informacionet krahasuese të paraqitura për periudhat paraardhëse nuk parandalon rregullimet ose korigjimet e besueshme të informacionit krahasues.

54A [Fshirë]

54B SNRF 9 “Instrumentet financiare”, i nxjerrë në tetor 2010, ndryshoi paragrafin 53 dhe fshiu paragrafin 54A. Nëse zbaton SNRF 9 të nxjerrë në tetor 2010, njësia ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime.

SNK 12 Tatimet mbi të ardhurat

C18 Paragrafi 20 është ndryshuar si vijon, paragrafi 96 është fshirë dhe është shtuar paragrafi 97:

20. SNRF-të lejojnë ose kërkojnë që disa aktive të mbahen me vlerën e drejtë ose të rivlerësohen (shih për shembull, SNK 16 “Aktivet afatgjata materiale”, SNK 38 “Aktivet jomateriale”, SNK 40 “Aktivet materiale afatgjata të investuara” dhe SNRF 9 “Instrumentet financiare”). Në disa juridiksione, rivlerësimet ose riparaqitjet e tjera të një aktivi me vlerën e drejtë ndikojnë në fitimin e tatueshëm (humbjen e tatueshme) të periudhës aktuale. Si rezultat, ...

96 [Fshirë]

97 SNRF 9 “Instrumentet financiare”, i nxjerrë në tetor 2010, ndryshoi paragrafin 20 dhe fshiu paragrafin 96. Nëse zbaton SNRF 9 të nxjerrë në tetor 2010, njësia ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime.

SNK 18 Të ardhurat

C19 Paragrafët 6(d) dhe 11 janë ndryshuar si vijon, është fshirë paragrafi 39 dhe është shtuar paragrafi 40:

6. Ky Standard nuk trajton të ardhurat që vijnë nga:

a) ...;



d) ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve ose pasiveve financiare ose nga shitja e tyre (shih SNRF 9 “Instrumentet financiare”);

e)

11 Në shumicën e rasteve ... Diferenca mes vlerës së drejtë dhe vlerës nominale të shumës së konsideruar do të njihet si e ardhur nga interesi në përputhje me paragrafët 29 dhe 30 dhe në përputhje me SNRF 9.

39 [Fshirë]

40 SNRF 9 “Instrumentet financiare”, i nxjerrë në tetor 2010, ndryshoi paragrafët 6 (d) dhe 11 dhe fshiu paragrafin 39. Nëse zbaton SNRF 9 të nxjerrë në tetor 2010, njësia ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime.

SNK 20 “Kontabiliteti për grandet qeveritare dhe dhënia e informacioneve shpjeguese për ndihmën qeveritare”

C20 Paragrafi 10A është ndryshuar si vijon dhe është shtuar paragrafi 44.

10A Përfitimi i një huaje qeveritare me normë interesi më të ulët se tregu, trajtohet si grand qeveritar. Huaja do të njihet dhe matet në përputhje me SNRF 9 “Instrumentet financiare”. Përfitimi nga norma e interesit më e ulët se tregu do të matet si diferencë me vlerës kontabël fillestare të huas së përcaktuar në përputhje me SNRF 9 dhe të ardhurave të marra. Përfitimi trajtohet sipas këtij Standardi. Njësia do të marrë në konsideratë të gjitha kushtet dhe detyrimet që janë plotësuar ose duhet të plotësohen, kur identifikon kostot që mendohet se do të kompensohen nga përfitimi i huas.

44 SNRF 9 “Instrumentet financiare”, i nxjerrë në tetor 2010, ndryshoi paragrafin 10A. Nëse zbaton SNRF 9 të nxjerrë në tetor 2010, njësia ekonomike duhet të zbatojë këtë ndryshim.

SNK 21 Efektet e ndryshimit në kurset e këmbimit

C21 [Jo i zbatueshëm për Standardin bazë]

C22 Paragrafët 3(a), 4 dhe 52(a) janë ndryshuar si vijon, është fshirë paragrafi 60C dhe është shtuar paragrafi 60E:

3 Ky Standard do të zbatohet: [është hequr shënimi në fund të faqes]

a) për trajtimin kontabël të transaksioneve dhe tepricave në monedhë të huaj, duke përjashtuar ato transaksione dhe teprica të derivativëve që trajtohen nga SNRF 9 “Instrumentet financiare”;

b) ...

4 SNRF 9 zbatohet për shumë derivativë në monedhë të huaj, ndaj për këtë arsye këta janë përjashtuar nga ky standard. Megjithatë, ata derivativë në monedhë të huaj që nuk trajtohen nga SNRF 9 (p.sh. derivativët në monedhë të huaj që janë të përfshirë në kontratat e tjera) trajtohen sipas këtij standardi. Përveç kësaj, ky standard zbatohet kur një njësi ekonomike përkthen shumat, që u përkasin derivativave, nga monedha e tyre funksionale në monedhën e paraqitjes.

52 Njësia ekonomike duhet të paraqesë në shënimet shpjeguese:

a) shumën e diferencave të këmbimit të njohura në fitim ose humbje, përveç atyre që rrjedhin nga matja e instrumenteve financiare me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes në përputhje me SNRF 9; dhe

b) ...

60C [Fshirë]

60E SNRF 9 “Instrumentet financiare”, i nxjerrë në tetor 2010, ndryshoi paragrafët 3 (a), 4 dhe 52 (a) dhe fshiu paragrafin 60C. Nëse zbaton SNRF 9 të nxjerrë në tetor 2010, njësia ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime.

SNK 27 Pasqyrat financiare të konsoliduara dhe individuale

C23 [Jo i zbatueshëm për Standardin bazë]

C24 Paragrafët 35, 37, 38 dhe 40 janë ndryshuar si vijon, paragrafi 45D është fshirë dhe është shtuar paragrafi 45E.

35. Nëse shoqëria mëmë humbet kontrollin e një filiali, ... për shembull, nëse një filial ka një diferencë këmbimi të akumuluar që lidhet me një operacion të kryer jashtë vendit dhe shoqëria mëmë ka humbur kontrollin e filialit, kjo e fundit duhet të riklasifikojë në fitim ose humbje fitimin ose humbjen e

njohur më parë në pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse nga operacioni i kryer jashtë vendit. Në mënyrë të ngjashme, ...

37. Vlera e drejtë e çdo investimi të zotëruar më parë në filial në datën kur humb kontrollin duhet të vlerësohet si vlera e drejtë në njohjen fillestare të aktivitetit financiar në përputhje me SNRF 9 “Instrumente financiare” ose kur është e përshtatshme, si kosto në njohjen fillestare të një investimi në një sipërmarrje, ose njësi ekonomike të kontrolluar bashkërisht.

Kontabiliteti për investimet në filiale, njësi ekonomike të kontrolluara bashkërisht dhe pjesëmarrje në pasqyrat financiare individuale

38. Kur një entitet përgatit pasqyra financiare individuale, investimet në filiale, në njësitë ekonomike të kontrolluara bashkërisht dhe në sipërmarrjet do të llogariten ose:

- a) me kosto; ose
- b) në përputhje me SNRF 9.

Njësia ekonomike do të përdorë të njëjtin trajtim kontabël për çdo kategori investimesh. Investimet e trajtuara me kosto do të trajtohen në përputhje me SNRF 5 “Aktivet afatgjata që mbahen për shitje dhe operacionet jo të vijueshme” nëse janë klasifikuar si të mbajtura për shitje (ose nëse janë përfshirë në një grup për t’u nxjerrë nga përdorimi që është klasifikuar si i mbajtur për shitje). Kontabiliteti për investimet në përputhje me SNRF 9 nuk ndryshon në rrethana të tilla.

40 Investimet në njësi ekonomike të kontrolluara bashkërisht dhe pjesëmarrjet që në pasqyrat financiare të konsoliduara trajtohen në përputhje me SNRF 9, do të trajtohen në të njëjtën mënyrë në pasqyrat financiare individuale të investitorit.

45D [Fshirë]

45E SNRF 9 “Instrumentet financiare”, i nxjerrë në tetor 2010, ndryshoi paragrafët 35, 37, 38 dhe 40 dhe fshiu paragrafët 45D. Nëse zbaton SNRF 9 të nxjerrë në tetor 2010, njësia ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime.

SNK 28 Investime në pjesëmarrje

C25 [Jo i zbatueshëm për Standardin bazë]

C26 Paragrafët 1 dhe 18-19A janë ndryshuar si vijon, paragrafi 41D është fshirë dhe është shtuar paragrafi 41F:

1. Ky Standard duhet të zbatohet në kontabilitetin e investimeve në pjesëmarrje. Megjithatë standardi nuk zbatohet për investimet në pjesëmarrje të zotëruara nga:

a) organizatat e kapitalit sipërmarrës; ose

b) fondet e përbashkëta, njësitë e besimit dhe njësi ekonomike të ngjashme, duke përfshirë këtu fondet e sigurimeve të lidhura me investimin;

të cilat maten me vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes në përputhje me SNRF 9 “Instrumentet financiare”. Një njësi ekonomike do të masë këto investime me vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes në përputhje me SNRF 9. Një njësi ekonomike që zotëron investime të tilla duhet të japë informacionet shpjeguese të përcaktuara në paragrafin 37(f).

18 Një investitor do të ndalojë përdorimin e metodës së kapitalit neto nga data kur ndalon së pasuri influencë të ndjeshme (jodominuese) mbi një pjesëmarrje dhe i kontabilizon investimet në përputhje me SNRF 9 prej kësaj date, me kusht që pjesëmarrja të mos bëhet një filial apo një sipërmarrje e përbashkët sipas përkufizimit në SNK 31. Me humbjen e influencës së ndjeshme, ...

19 Kur një investim nuk është më një pjesëmarrje dhe trajtohet në përputhje me SNRF 9, vlera e drejtë e tij në datën kur ndalon së qeni një pjesëmarrje konsiderohet si vlera e drejtë e tij në matjen fillestare si një aktiv financiar në përputhje me SNRF 9.

19A Nëse një investitor humb influencën e ndjeshme ndaj një pjesëmarrjeje, ... për shembull nëse një pjesëmarrje ka diferenca nga këmbimi të akumuluar lidhur me një operacion të kryer jashtë vendit dhe investitori humb influencën e ndjeshme ndaj pjesëmarrjes, investitori do të riklasifikojë në fitim ose humbje fitimin ose humbjen e njohur më parë në pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse nga operacioni i kryer jashtë vendit. Nëse ...



41D [Fshirë]

41F SNRF 9 “Instrumentet financiare”, i nxjerrë në tetor 2010, ndryshoi paragrafët 1 dhe 18–19A dhe fshiu paragrafin 41D. Nëse zbaton SNRF 9 të nxjerrë në tetor 2010, njësia ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime.

SNK 31 “Interesat në sipërmarrjet e përbashkëta”

C27 [Jo i zbatueshëm për Standardin bazë]

C28 Paragrafët 1, 45-45B dhe 51 janë ndryshuar si vijon, është fshirë paragrafi 58C dhe është shtuar paragrafi 58E:

1 Ky standard do të zbatohet në kontabilizimin e interesave në sipërmarrjet e përbashkëta dhe në raportimin e aktiveve, pasiveve, të ardhurave dhe shpenzimeve të sipërmarrjes së përbashkët, në pasqyrat financiare të sipërmarrësit dhe investitorit, pavarësisht nga struktura apo nga forma që ka aktiviteti i sipërmarrjes së përbashkët. Megjithatë nuk do të zbatohet për interesat e sipërmarrësit në njësitë ekonomike të bashkëkontrolluara të zotëruara nga:

a) organizatat e kapitalit sipërmarrës; ose

b) fondet e përbashkëta, njësitë e besimit dhe njësi ekonomike të ngjashme, duke përfshirë këtu fondet e sigurimeve të lidhura me investimin;

të cilat janë matur me vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes në përputhje me SNRF 9 “Instrumentet financiare”. Një njësi ekonomike do të masë këto investime me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes në përputhje me SNRF 9. Një sipërmarrës që zotëron interesa të tillë do të japë informacionet shpjeguese të kërkuara në paragrafët 55 dhe 56.

45 Nëse një sipërmarrës humbet kontrollin e përbashkët ndaj një njësie ekonomike ai duhet të kontabilizojë interesat e mbetur të investimit në përputhje me SNRF 9 që prej kësaj date, me kushtin që ish-njësia ekonomike e bashkëkontrolluar nuk bëhet filial ose sipërmarrje. Nga ...

45A Nëse një investim nuk është më një njësi ekonomike me kontroll të përbashkët dhe trajtohet në përputhje me SNRF 9, vlera e drejtë e investimit kur ai përfundon së qeni një njësi ekonomike me kontroll të përbashkët, do të shihet si vlera e drejtë e tij në njohjen fillestare si aktiv financiar në përputhje me SNRF 9.

45B Nëse një sipërmarrës humbet kontrollin e përbashkët ndaj një njësie ekonomike, ... për shembull, nëse një njësi ekonomike me kontroll të përbashkët ka diferenca nga këmbimi të akumuluar lidhur me një operacion të kryer jashtë vendit dhe investitori humb kontrollin e përbashkët në njësinë ekonomike, investitori do të riklasifikojë në fitime ose humbje fitimin ose humbjen e njohur më parë në pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse nga operacioni i kryer jashtë vendit. Nëse ...

51 Një investitor në një sipërmarrje të përbashkët që nuk ushtron bashkëkontroll duhet ta kontabilizojë këtë investim në përputhje me SNRF 9 ose, nëse ai ushtron një influence të ndjeshme mbi këtë sipërmarrje të përbashkët, në përputhje me SNK 28.

58C [Fshirë]

58E SNRF 9 “Instrumentet financiare”, i nxjerrë në tetor 2010, ndryshoi paragrafët 1, 45–45B dhe 51 dhe fshiu paragrafin 58C. Nëse zbaton SNRF 9 të nxjerrë në tetor 2010, njësia ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime.

SNK 32 “Instrumentet financiare: Paraqitja”

C29 [Jo i zbatueshëm për Standardin bazë]

C30 Paragrafët 3, 4, 12, 23, 31, 42 dhe 96C janë ndryshuar si vijon, paragrafi 97F është fshirë dhe është shtuar paragrafi 97H:

3 Parimet në këtë Standard plotësojnë parimet për njohjen dhe matjen e aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare në SNRF 9 “Instrumentet financiare”, dhe për dhënien e informacioneve shpjeguese rreth tyre në SNRF 7 “Instrumentet financiare: Dhënie informacionesh shpjeguese”.

Objekti

4 Ky Standard do të zbatohet nga të gjitha njësitë ekonomike ndaj të gjitha llojeve të instrumenteve financiare, përveç:

a) Atyre interesave në filiale, pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta, që janë kontabilizuar në përputhje me SNK 27 “Pasqyrat financiare të konsoliduara dhe të veçanta”, SNK 28 “Investimet në pjesëmarrje” ose SNK 31 “Interesat në sipërmarrjet e përbashkëta”. Megjithatë, në disa raste, SNK 27, SNK 28 ose SNK 31 lejojnë njësinë ekonomike të kontabilizojë një interes në një filial, pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët duke zbatuar SNRF 9; në këto raste, njësitë ekonomike duhet të zbatojnë kërkesat e këtij Standardi. Njësitë ekonomike, gjithashtu, zbatojnë këtë Standard për të gjithë derivativët e lidhur me interesat në filiale, pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkëta.

b) ...

d) Kontratat e sigurimit sipas përcaktimit në SNRF 4 “Kontratat e sigurimit”. Megjithatë, ky Standard zbatohet për derivativët që janë të përfshirë në kontratat e sigurimit në qoftë se SNRF 9 kërkon që njësia ekonomike t’i kontabilizojë ato veçmas. Më tej, një emetues zbaton këtë Standard për kontratat e garancisë financiare në qoftë se emetuesi zbaton SNRF 9 për njohjen dhe matjen e kontratave, por duhet të zbatojë SNRF 4 në qoftë se emetuesi zgjedh, në përputhje me paragrafin 4(d) të SNRF 4, të zbatojë SNRF 4 për njohjen dhe matjen e tyre.

e) Instrumentet financiare që janë brenda objektit të SNRF 4, për arsyen se ato përmbajnë një tipar subjektiv pjesëmarrjeje. Emetuesi i këtyre instrumenteve përjashtohet nga zbatimi i këtyre tipareve në paragrafët 15-32 dhe AG25-AG35 të këtij Standardi në lidhje me dallimin mes pasiveve financiare dhe instrumenteve të kapitalit të vet. Megjithatë, këto instrumente janë subjekt i të gjitha kërkesave të tjera të këtij Standardi. Gjithashtu, ky Standard zbatohet për derivativët që janë të përfshirë në këto instrumente (shih SNRF 9).

12 Termat e mëposhtëm janë përkufizuar në shtojcën A të SNRF 9 ose në paragrafin 9 të SNK 39 dhe janë përdorur në këtë Standard me kuptimin e përcaktuar në SNK 39 dhe SNRF 9:

- Kosto e amortizuar e një aktivi financiar ose pasivi financiar;
- Çregjistrimi;
- Derivat;
- Metoda e interesit efektiv;
- Kontratë e garancisë financiare;
- Pasiv financiar me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes;
- Angazhim i pandryshueshëm;
- Transaksion parashikues;
- Efektivitet mbrojtje;
- Element i mbrojtur;
- Instrument mbrojtës;
- I mbajtur për tregtim;
- Mënyrë e rregullt blerjeje ose shitjeje;
- Kostot e transaksionit.

23 Përveç rasteve të përshkruara në paragrafët 16A dhe 16B ose në paragrafët 16C dhe 16D, një kontratë që përmban një detyrim për një njësi ekonomike për të blerë instrumentet e kapitalit të vet me mjete monetare ose aktive të tjera financiare krijon një pasiv financiar për vlerën aktuale të shumës së shpërblimit (për shembull, për vlerën aktuale të çmimit të ardhshëm të riblerjes, çmimin e ushtrimit të opsionit ose shuma të tjera shpërblimi). Është kështu edhe nëse vetë kontrata është një instrument i kapitalit të vet. Një shembull është një detyrim i njësisë ekonomike sipas një kontrate të ardhshme për të blerë instrumentet e kapitalit të vet me mjete monetare. Kur pasivi financiar është njohur fillimisht sipas SNRF 9, vlera e tij e drejtë (vlera aktuale e shumës së shpërblimit) riklasifikohet prej kapitalit të vet. Në vijim, pasivi financiar matet në përputhje me SNRF 9. Nëse kontrata skadon pa transferime, vlera kontabël e pasivit financiar riklasifikohet në kapitalin e vet. Një detyrim kontraktual i njësisë ekonomike për të blerë instrumentet e kapitalit të vet krijon një pasiv financiar me vlerën aktuale të shumës së



shpërblimit edhe në qoftë se detyrimi për të blerë është i kushtëzuar nga fakti nëse pala tjetër do të ushtrojë apo jo të drejtën për të këmbyer (p.sh. një opsion shitje me shkrim që i jep palës tjetër të drejtën për të shitur instrumentet e kapitalit të vet të një njësie ekonomike te vetë njësia ekonomike me një çmim fiks).

31 SNRF 9 trajton matjen e aktiveve financiare dhe pasiveve financiare. Instrumentet e kapitalit 42 ...

Për kontabilizimin e transferimit të një aktivi financiar që nuk përcaktohet për t'u çregjistruar, njësia ekonomike nuk e kompenson aktivin e transferuar dhe pasivin që e shoqëron (shih SNRF 9, paragrafi 3.2.22).

96C Klasifikimi i instrumenteve sipas këtij përjashtimi do të kufizohet për trajtimin kontabël të instrumenteve të tilla sipas SNK 1, SNK 32, SNK 39, SNRF 7 dhe SNRF 9. Instrumenti nuk do të konsiderohet një instrument kapitali sipas udhëzuesve të tjerë, për shembull SNRF 2.

97F [Fshirë]

97H SNRF 9 "Instrumentet financiare", i nxjerrë në tetor 2010, ndryshoi paragrafët 3, 4, 12, 23, 31, 42, 96C, AG2 dhe AG30 dhe fshiu paragrafin 97F. Nëse zbaton SNRF 9 të nxjerrë në tetor 2010, njësia ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime.

C31 Në shtojcë paragrafët AG2 dhe AG30 janë ndryshuar si vijon:

AG2 Standardi nuk trajton njohjen ose matjen e instrumenteve financiare. Kërkesat rreth njohjes dhe matjes së aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare paraqiten në SNRF 9.

AG30 Paragrafi 28 zbatohet vetëm për emetuesit e instrumenteve financiare të përbërë, joderivativë. Paragrafi 28 nuk trajton instrumentet financiare të përbëra nga këndvështrimi i zotëruesve. SNRF 9 trajton klasifikimin dhe matje e aktive financiare që janë instrumente financiare të përbëra nga këndvështrimi i zotëruesve.

SNK 36 Zhvlerësimi i aktiveve

C32 Paragrafët 2(e) dhe 5 janë ndryshuar si vijon, paragrafi 140F është fshirë dhe është shtuar paragrafi 140G:

2 ...

e) aktivet financiare të cilat janë brenda objektit të SNRF 9 "Instrumentet financiare";

f) ...

5 Ky Standard nuk aplikohet për aktivet financiare që përfshihen në objektin e SNRF 9, për aktivet afatgjata materiale të investuara, të matura me vlerën e drejtë në përputhje me SNK 40, apo për aktivet biologjike që kanë lidhje me veprimtarinë bujqësore të matura me vlerën e drejtë minus kostot e shitjes në përputhje me SNK 41. Megjithatë, ...

140F [Fshirë]

140G SNRF 9 "Instrumentet financiare", i nxjerrë në tetor 2010, ndryshoi paragrafët 2 (e) dhe 5 dhe fshiu paragrafin 140F. Nëse zbaton SNRF 9 të nxjerrë në tetor 2010, njësia ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime.

SNK 37 Provizionet, pasivet dhe aktivet e kushtëzuara

C33 Paragrafi 2 është ndryshuar si vijon dhe është shtuar paragrafi 97:

2 Ky Standard nuk zbatohet për instrumentet financiare (përfshirë garancitë) që janë brenda objektit të SNRF 9 "Instrumentet financiare".

97 SNRF 9 "Instrumentet financiare", i nxjerrë në tetor 2010, ndryshoi paragrafin 2. Nëse zbaton SNRF 9 të nxjerrë në tetor 2010, njësia ekonomike duhet të zbatojë këtë ndryshim.

SNK 39 "Instrumentet financiare: Njohja dhe matja"

C34 [Jo i zbatueshëm për Standardin bazë]

C35 Paragrafi 1 është fshirë.

C36 Paragrafët 2 dhe 4 janë ndryshuar si vijon:

2 Ky standard do të zbatohet nga të gjitha njësitë ekonomike, për të gjitha llojet e instrumenteve financiare, me përjashtim të:

a) ...

b) të drejtat dhe detyrimet që lindin nga qiratë për të cilat zbatohet SNK 17 “Qiratë”.
Megjithatë:

i) qiratë e arkëtueshme të njohura nga qiradhënësi janë subjekt i çregjistrimit dhe i provizioneve për zhvlerësim të këtij Standardi;

ii) qiratë financiare të pagueshme, të njohura nga qiramarrësi, janë subjekt i provizioneve të çregjistrimit të këtij Standardi; dhe

iii) derivativët që janë të përfshirë në qiratë janë subjekt i provizioneve për derivativët e përfshirë të këtij Standardi.

c) ...

e) të drejtat dhe detyrimet që lindin nga: i) një kontratë sigurimi që përkufizohet në SNRF 4 Kontratat e sigurimit, përveç të drejtave dhe detyrimeve që lindin nga një kontratë sigurimi që plotëson përkufizimin e dhënë për një kontratë garancie financiare në shtojcën A të SNRF 9; ose ii) një kontratë që është objekt i SNRF 4 meqë ajo përmban një tipar të pjesëmarrjes së lirë. Megjithatë, ky Standard zbatohet për një derivativ që është i përfshirë në një kontratë që përbën objekt të SNRF 4, në qoftë se derivativi nuk është në vetvete një kontratë objekt i SNRF 4. Për më tepër, nëse një emetues i kontratave të garancisë financiare ka pohuar paraprakisht në mënyrë të qartë që ai i konsideron këto kontrata si kontrata sigurimi dhe ka përdorur kontabilitetin e zbatueshëm për kontratat e sigurimit, atëherë emetuesi mund të zgjedhë të zbatojë ose këtë Standard ose SNRF 4 për këto lloj kontratash të garancisë financiare (shih paragrafët AG4 dhe AG4A). Emetuesi mund ta bëjë këtë zgjedhje kontratë pas kontrate, por zgjedhja për secilën kontratë është e paprapësueshme.

f) ...

h) angazhimet për hua, përveç atyre angazhimeve të përshkruara në paragrafin 4. Një emetues i angazhimeve për hua do të zbatojë SNK 37 “Provizionet, pasivet dhe aktivet e kushtëzuara” për angazhime huaje, të cilat nuk janë objekt i këtij Standardi. Megjithatë, të gjitha angazhimet për hua janë subjekt i kërkesave për mosnjohje të këtij Standardi.

i) instrumentet financiare, kontratat dhe detyrimet sipas transaksioneve të pagesave bazuar në aksione, për të cilat zbatohet SNRF 2 “Pagesa të bazuara në aksione”, me përjashtim të kontratave që janë objekt i paragrafëve 5-7 të këtij Standardi, për të cilat zbatohet ky Standard.

j) ...

4 Angazhimet e mëposhtme për hua janë objekt i këtij Standardi:

a) angazhimet për hua që njësia ekonomike i ka përcaktuar si pasive financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (shih paragrafin 4.2.2 të SNRF 9). Një njësi ekonomike që ka një praktikë të kaluar të shitjes së aktiveve, si rezultat i një angazhimi të saj për hua, pak pas nisjes do të zbatojë këtë Standard për të gjitha angazhimet për hua të saj të së njëjtës klasë.

b) ...

c) angazhimet për të siguruar një hua me një normë interesi poshtë nivelit të tregut (shih paragrafin 4.2.1 të SNRF 9).

C37 Paragrafët 8 dhe 9 janë ndryshuar si vijon:

8 Termat e përkufizuar në SNRF 9 dhe SNK 32 përdoren në këtë Standard me kuptimet e specifikuar në shtojcën A të SNRF 9 dhe në paragrafin 11 të SNK 32. Në SNRF 9 dhe SNK 32 përkufizohen termat e mëposhtëm:

- Çregjistrim;
- Derivativ;
- Instrument kapitali;
- Vlera e drejtë;
- Aktiv financiar;
- Kontratë garancie financiare;
- Instrument financiar;
- Pasiv financiar;

dhe jepet udhëzimi për zbatimin e këtyre përkufizimeve.



Në paragrafin 9, janë fshirë “Përkufizimi i një derivativi”, “Përkufizimet e katër kategorive të instrumenteve financiare” dhe “Përkufizimi i një kontrate të garancisë financiare”. Në “Përkufizimin në lidhje me njohjen dhe matjen” janë fshirë përkufizimet “Çregjistrimi”, “Vlerë të drejtë” dhe “Blerje ose shitje në mënyrë të rregullt”.

C38 Paragrafët 10-57 janë fshirë.

C39 Titulli “Zhvlerësimi dhe mosarkëtueshmëria e aktiveve financiare” mbi paragrafin 58 dhe paragrafët 58 dhe 63 është ndryshuar si vijon dhe janë fshirë paragrafët 61 dhe 66-70 dhe titujt mbi paragrafët 63, 66 dhe 67:

Zhvlerësimi dhe mosarkëtueshmëria e aktiveve financiare të matura me koston e amortizuar

58 Njësia ekonomike do të vlerësojë në çdo datë të fundit të periudhës së raportimit, nëse ka të dhëna që një aktiv financiar ose grup aktivesh financiare të matura me koston e amortizuar janë zhvlerësuar. Në qoftë se këto të dhëna ekzistojnë, atëherë njësia ekonomike do të zbatojë paragrafin 63 për të përcaktuar shumën e çdo humbjeje nga zhvlerësimi.

63 Në qoftë se ka një evidencë objektive që tregon për një humbje nga zhvlerësimi në aktivet financiare të vlerësuara me koston e amortizuar, madhësia e humbjes përcaktohet si ...

C40 Paragrafi 79 është fshirë dhe paragrafët 88(d), 89(b), 90 dhe 96(c) janë ndryshuar si vijon:

88 Një marrëdhënie mbrojtëse kualifikohet si kontabilitet mbrojtës sipas paragrafëve 89-102 nëse dhe vetëm nëse, plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) ...

d) Efektiviteti i mbrojtjes mund të matet në mënyrë të besueshme, d.m.th. vlera e drejtë ose fluksi i mjeteve monetare të zërit të mbrojtur që janë të lidhura drejtpërdrejt me rrezikun e mbrojtur dhe vlera e drejtë e instrumentit mbrojtës mund të matet në mënyrë të besueshme.

e) ...

Mbrojtja me vlerën e drejtë

89 Në qoftë se gjatë periudhës, një mbrojtje me vlerën e drejtë plotëson kushtet e parashtruara në paragrafin 88, do të trajtohet si vijon:

a) ...

b) Fitimi ose humbja neto nga zëri i mbrojtur i lidhur drejtpërdrejt me rrezikun e mbrojtur do të rregullojë vlerën kontabël të zërit të mbrojtur dhe do të njihet në fitim ose humbje. Kjo zbatohet në qoftë se zëri i mbrojtur është matur me kosto.

90. Në qoftë se janë të mbrojtura vetëm rreziqet e veçanta të lidhura drejtpërdrejt me një zë të mbrojtur, atëherë ndryshimet e njohura në vlerën e drejtë të zërit të mbrojtur, të palidhura me rrezikun e mbrojtur, njihen sipas përshkrimit të bërë në paragrafin 5.7.1 të SNRF 9.

96 Në mënyrë më specifike, një mbrojtje e fluksit të mjeteve monetare do të trajtohet si vijon:

a) ...

c) Në qoftë se një strategji e dokumentuar e drejtimit të rrezikut për një marrëdhënie mbrojtëse të veçantë përjashton nga vlerësimi i efektivitetit të mbrojtjes një element specifik të fitimit ose humbjes neto ose të lidhur me flukset e mjeteve monetare nga instrumenti mbrojtës (shih paragrafët 74, 75 dhe 88(a)), atëherë elementi i përjashtuar i fitimit ose humbjes neto njihet në përputhje me paragrafin 5.7.1 të SNRF 9.

C41 Paragrafët 103B, 103C, 103K, 104 dhe 108C janë ndryshuar si vijon, paragrafët 103H-103J, 103L, 103M dhe 105-107A janë fshirë dhe është shtuar paragrafi 103O:

103B Kontratat e garancisë financiare (ndryshimet e bëra për SNK 39 dhe SNRF 4), nxjerrë në gusht të vitit 2005, ndryshuan paragrafët 2(e) dhe (h), 4 dhe AG4, shtuan paragrafin AG4A, shtuan një përkufizim të ri të kontratave të garancisë financiare dhe hoqën paragrafin 3. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2006. Inkurajohet zbatimi më i hershëm. Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime në një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacion shpjegues për këtë fakt dhe do të zbatojë në të njëjtën kohë ndryshimet e lidhura me SNK 32 [është fshirë shënimi në fund të faqes] dhe SNRF 4.

103C SNK 1 (i rishikuar në vitin 2007) ndryshoi terminologjinë e përdorur në SNRF-të. Ai ndryshoi edhe paragrafët 95(a), 97, 98, 100, 102, 108 dhe AG99B. Një njësi ekonomike do të zbatohet këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2009 ose më pas. Nëse një njësi ekonomike zbaton SNK 1 (i rishikuar në vitin 2007) në një periudhë më të hershme, ndryshimet do të zbatohen edhe për këtë periudhë.

103K Përmirësime të SNRF-ve, i nxjerrë në prill 2009, ndryshoi paragrafët 2(g), 97 dhe 100. Një njësi ekonomike do të zbatohet ndryshimet në këto paragrafë në mënyrë pasvepruese për të gjitha kontratat ende të vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2010 ose më pas. Lejohet zbatimi më i hershëm. Nëse një njësi ekonomike zbaton këtë ndryshim në një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacion shpjegues për këtë fakt.

103L [Fshirë]

103M [Fshirë]

103O SNRF 9 “Instrumentet financiare”, i nxjerrë në tetor 2010, ndryshoi paragrafët 2, 4, 8, 9, 58, 63, 88(d), 89(b), 90, 96(c), 103B, 103C, 103K, 104, 108C, AG3-AG4, AG8, AG84, AG95, AG114(a) dhe AG118(b) dhe fshiu paragrafët 1, 10-57, 61, 66-70, 79, 103H-103J, 103L, 103M, 105-107A, AG4B-AG4K, AG9-AG12A, AG14-AG15, AG27-AG83 dhe AG96. Nëse zbaton SNRF 9 të nxjerrë në tetor 2010, njësi ekonomike duhet të zbatohet këto ndryshime.

104 Ky standard do të zbatohet në mënyrë retrospektive, me përjashtim të asaj që është specifikuar në paragrafin 105. Teprica e çeljes e fitimeve të pashpërndara për periudhën më të hershme të mëparshme dhe të gjitha shumat krahasuese do të rregullohen sikur ky standard të kishte qenë gjithmonë në zbatim, me përjashtim të rastit kur rivlerësimi i informacionit do të ishte i pamundur. Nëse rivlerësimi është i pamundur, njësi ekonomike do të japë informacion shpjegues sipas shkallës së rivlerësimit të tij.

108C Paragrafët 73 dhe AG8 u ndryshuan nga “Përmirësime të SNRF-ve”, nxjerrë në maj 2008. Paragrafi 80 u ndryshua nga “Përmirësime të SNRF-ve”, nxjerrë në prill 2009. Një njësi ekonomike do të zbatohet këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2009 ose më pas. Lejohet zbatimi më i hershëm. Nëse një njësi ekonomike zbaton këtë ndryshim në një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacion shpjegues për këtë fakt.

C42 Në shtojcën A, paragrafët AG3-AG4 janë ndryshuar si vijon:

AG3... Në qoftë se as metoda e kapitalit neto dhe as ajo e konsolidimit proporcional nuk është e përshtatshme, njësi ekonomike do të zbatohet këtë Standard dhe SNRF 9 për atë investim strategjik.

AG3A Ky Standard dhe SNRF 9 zbatohet për aktivet financiare dhe pasivet financiare të shoqërive të sigurimit, përveç të drejtave dhe detyrimeve që përjashtohen nga paragrafi 2(e), sepse ato lindin nga kontrata që janë objekt i SNRF 4.

AG4 Kontratat e garancisë financiare mund të jenë të formave të ndryshme ligjore, të tilla si ...

a) Ndonëse një kontratë e garancisë financiare plotëson përkufizimin e një kontrate sigurimi sipas SNRF 4, nëse rreziku i transferuar është i rëndësishëm, emetuesi do të zbatohet këtë Standard dhe SNRF 9. Gjithsesi, në qoftë se emetuesi ka pohuar paraprakisht, në mënyrë të qartë, se ai i konsideron këto kontrata si kontrata sigurimi dhe ka përdorur kontabilitetin e zbatueshëm për to, atëherë emetuesi mund të zgjedhë nëse do të zbatohet këtë Standard dhe SNRF 9 apo SNRF 4 për këto kontrata të garancisë financiare. Nëse zbatohet ky Standard dhe SNRF 9, atëherë sipas paragrafit 5.1.1 të SNRF 9 kërkohet që emetuesi të njohë fillimisht kontratën e garancisë financiare me vlerën e drejtë. Kur kontrata e garancisë financiare është lidhur me një palë të palidhur në një transaksion të veçuar i kryer në mënyrë të vullnetshme midis palëve të palidhura me njëra-tjetrën, vlera e drejtë e saj në fillim është pak a shumë e barabartë me primin e marrë, me përjashtim kur vërtetohet e kundërta. Rrjedhimisht, nëse kontrata e garancisë financiare nuk është përcaktuar qysh në fillim si me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes ose nëse nuk zbatohen paragrafët 3.2.15-3.2.23 dhe B3.2.12-B3.2.17 të SNRF 9 (kur transferimi i një aktivi financiar nuk kualifikohet për mosnjohje ose zbatohet metoda e përfshirjes së vazhdueshme), atëherë emetuesi e mat atë me vlerën më të lartë mes:



i) vlerës së përcaktuar në përputhje me SNK 37; dhe
ii) vlerës së njohur fillimisht të pakësuar, kur është e nevojshme, me amortizimin e akumuluar të njohur në përputhje me SNK 18 (shih paragrafin 4.2.1(c) të SNRF 9).

b) Disa garanci të lidhura me kredinë nuk kërkojnë, si një parakusht për pagesë, që mbajtësi të ekspozohet dhe të pësojë humbje nga paaftësia e debitorit për të bërë në kohë pagesën për aktivin e garantuar. Si shembull për këtë lloj garancie është ajo e cila kërkon që pagesa të bëhet në përputhje me ndryshimet në klasifikimin e specifikuar të kredisë ose indeksin e kredisë. Të tilla garanci nuk janë kontrata të garancisë financiare, sikurse përkufizohet në SNRF 9 dhe nuk janë kontrata sigurimi, sipas përkufizimit të bërë në SNRF 4. Të tilla garanci janë derivativë dhe emetuesi zbaton këtë Standard dhe SNRF 9 për ta.

c) ...

C43 Në shtojcën A, janë fshirë paragrafët AG4B-AG4K, AG9-AG12A dhe AG14-AG15 dhe paragrafi AG8 është ndryshuar si vijon:

AG8 Në qoftë se një njësi ekonomike rishikon çmuarjet e saj të bëra për pagesat ose arkëtimet, atëherë ajo do të rregullojë vlerën kontabël të aktivit financiar ose të pasivit financiar (ose të grupit të instrumenteve financiare) për të pasqyruar çmuarjet aktuale dhe të rishikuara të flukseve të mjeteve monetare. Njësia ekonomike rillogarit vlerën kontabël duke njehsuar vlerën aktuale të flukseve të mjeteve monetare të ardhshme të çmuara me normën fillestare të interesit efektiv të instrumentit financiar ose kur është e mundshme, me normë efektive të rishikuar të interesit të llogaritur në përputhje me paragrafin 92. Rregullimet njihen si të ardhura ose shpenzime në rezultat.

C44 Në shtojcën A, janë fshirë paragrafët AG27-AG83.

C45 Në shtojcën A, titulli “Zhvlerësimi dhe mosarkëtueshmëria e aktiveve financiare (paragrafët 58-70)” mbi paragrafin AG84 dhe paragrafin AG84 është ndryshuar si vijon:

Zhvlerësimi dhe mosarkëtimi i aktiveve financiare të matura me koston e amortizuar (paragrafët 58-65)

AG84 Zhvlerësimi i një aktivi financiar të matur me koston e amortizuar, matet duke përdorur normën fillestare të interesit efektiv të instrumentit financiar, sepse skontimi me normën aktuale të interesit të tregut, në fakt, do të impononte matjen me vlerën e drejtë të një aktivi financiar që ndryshe është i matur me koston e amortizuar. Nëse termat e një aktivi financiar të matur me koston e amortizuar janë rinegociuar ose ndryshe janë modifikuar për shkak të vështirësive financiare të huamarrësit ose emetuesit, zhvlerësimi matet duke përdorur normën e interesit efektiv fillestar përpara modifikimit të termave. Flukset e mjeteve monetare në lidhje me llogaritë e arkëtueshme afatshkurtra nuk skontohen nëse ndikimi i skontimit është jomaterial. Nëse një aktiv financiar i matur me koston e amortizuar ka një normë interesi të ndryshueshme, norma e skontimit për matjen e çdo humbjeje nga zhvlerësimi, sipas paragrafit 63, është norma aktuale e interesit efektiv e përcaktuar sipas kontratës. Sipas përvojës praktike, një kreditor mund të masë zhvlerësimin e një aktivi financiar, të mbajtur me koston e amortizuar, mbi bazën e vlerës së drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e tregut të mbikëqyrur. Llogaritja e vlerës aktuale e flukseve të çmuara të mjeteve monetare të ardhshme të një aktivi financiar të dhënë garanci pasqyron flukset monetare që rezultojnë nga likuidimi i detyrimit i pakësuar me koston për përfitim dhe shitjen e garancisë, qoftë ose jo i mundshëm likuidimi.

C46 Në shtojcën A janë fshirë paragrafi AG96 dhe shënimi i parë në fund të faqes për paragrafin AG118 (b) dhe paragrafët AG95, AG114 (a) dhe AG118 (b) janë ndryshuar si vijon:

AG95 Një aktiv financiar i matur me koston e amortizuar mund të përcaktohet si një instrument mbrojtës në një mbrojtje nga rreziku i monedhës së huaj.

AG96 [Fshirë]

AG114 Për mbrojtjen e vlerës së drejtë ndaj rrezikut të normës së interesit lidhur me portofolin e aktiveve financiare ose pasiveve financiare, një njësi ekonomike do të plotësojë kërkesat e këtij Standardi nëse ajo përmbush procedurat e përshkruara në (a)-(i) dhe paragrafët AG115-AG132 më poshtë.

a) Si pjesë e procesit të drejtimit të rrezikut, njësia ekonomike identifikon një portofol të zërave që dëshiron të mbrojë nga rreziku i normës së interesit. Portofoli mund të përbëhet vetëm nga aktivet,

vetëm nga pasivet, ose nga aktivet dhe pasivet bashkë. Njësia ekonomike mund të identifikojë dy ose më shumë portofola dhe në një rast të tillë për çdo portofol të veçantë zbatohet udhëzimi i mëposhtëm.

b) ...

AG118 Si një shembull përcaktimi të paraqitur...

a) ...

b) Zëra, që do të ishin kualifikuar për kontabilitetin mbrojtës të vlerës së drejtë, nëse ata do të ishin përcaktuar si të mbrojtur në mënyrë individuale. Në veçanti, meqë SNRF 9 specifikon që vlera e drejtë e një pasivi financiar me një tipar kërkueshmërie pa afat (siç janë...

C47 Titulli “Periudha kalimtare (paragrafët 103-108N)” mbi paragrafin AG133 është ndryshuar si vijon:

Periudha kalimtare (paragrafët 103-108C)

KIRFN 2 Aksionet e anëtarëve në njësitë ekonomike kooperativa dhe instrumente të ngjashme

C48 Referenca për SNK 39 poshtë titullit “Referencat” është fshirë dhe është shtuar një referencë për SNRF 9 “Instrumentet financiare”. Është shtuar paragrafi 15:

15 SNRF 9, i nxjerrë në tetor 2010, ndryshoi paragrafët A8 dhe A10. Nëse zbaton SNRF 9 të nxjerrë në tetor 2010, njësia ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime.

C49 Në shtojcë, paragrafët A8 dhe A10 janë ndryshuar si vijon:

A8 Aksionet e anëtarëve mbi nivelin e ndalesës ndaj riblerjes janë detyrime financiare. Njësia kooperativë e mat këtë detyrim financiar me vlerën e drejtë në momentin e njohjes fillestare. Për arsye se këto aksione janë të tërheqshme sipas kërkesës, njësia tip kooperativë e përcakton vlerën e drejtë të detyrimeve të tilla në përputhje me paragrafin 5.4.3 të SNRF 9, i cili thotë: “Vlera e drejtë e një detyrimi financiar me një tipar kërkueshmërie pa afat (p.sh. depozita pa afat) nuk është më pak se shuma e pagueshme në momentin e kërkesës...” Për këtë arsye, njësia tip kooperativë klasifikon si detyrime financiare shumë maksimale të pagueshme në përputhje me kërkesat e kushteve të riblerjes.

A10 Menjëherë pas ndryshimit në strukturën e saj qeverisëse, njësia kooperativë mund të jetë e detyruar të tërheqë një maksimum prej 25% të aksioneve të saj të emetuara në treg ose maksimumin prej 50,000 aksionesh për 20 NJM secilin. Për pasojë, më 1 janar 20X3 njësia tip kooperativë klasifikon si detyrim financiar shumë prej 1,000,000 NJM e cila është maksimumi i shumës së pagueshme në momentin e kërkesës sipas kërkesave të kushteve të riblerjes, në përputhje me paragrafin 5.4.3 të SNRF 9. Në këtë mënyrë, ajo transferon në 1 janar 20X3 nga kapitali në detyrim financiar një shumë prej 200,000 NJM duke lënë 2,000,000 NJM të klasifikuar si kapital. Në këtë shembull njësia nuk njeh ndonjë fitim ose humbje nga transferimi.

KIRFN 5 Të drejtat për interesat që rrjedhin nga fondet e nxjerrjes nga përdorimi, restaurimi dhe rehabilitimi mjedisor

C50 Referenca për SNK 39 poshtë titullit “Referencat” është fshirë dhe është shtuar një referencë për SNRF 9 “Instrumentet financiare”. Paragrafi 5 është ndryshuar si vijon dhe është shtuar paragrafi 14A:

5. Interesi i mbetur në një fond që shkon përtej të drejtës për rimbursim, i tillë si një e drejtë kontraktuale për shpërndarje pasi të ketë përfunduar e gjithë nxjerrja nga përdorimi ose mbi mbylljen e fondit mund të jetë një instrument kapitali neto brenda objektit të SNRF 9 dhe nuk është objekt i këtij interpretimi.

14ASNRF 9, i nxjerrë në tetor 2010, ndryshoi paragrafin 5. Nëse zbaton SNRF 9 të nxjerrë në tetor 2010, njësia ekonomike duhet të zbatojë këtë ndryshim.

KIRFN 10 Raportimi financiar i ndërmjetëm dhe zhvlerësimi

C51 Referenca për SNK 39 poshtë titullit “Referencat” është fshirë dhe është shtuar një referencë për SNRF 9 “Instrumentet financiare”. Paragrafët 5, 6 dhe 11 janë fshirë, paragrafët 1, 2, 7 dhe 8 janë ndryshuar si vijon dhe është shtuar paragrafi 12:

1. Një njësie ekonomike i kërkohet të vlerësojë emrin e mirë për zhvlerësimin në çdo datë raportimi dhe, nëse kërkohet, të njohë një humbje nga zhvlerësimi në këtë datë në përputhje me SNK 36. Megjithatë, ...



2. Interpretimi merret me bashkëveprimin midis kërkesave të SNK 34 dhe njohjes së humbjeve nga zhvlerësimi në emrin e mirë në SNK 36 dhe efektin e këtij bashkëveprimi në pasqyrat financiare të ndërmjetme dhe vjetore, të periudhës më pas.

7. Interpretimi merret me çështjen e mëposhtme:

A duhet një njësi ekonomike të rimarrë humbjet nga zhvlerësimi në emrin e mirë të njohura në një periudhë të ndërmjetme nëse nuk është njohur humbje apo është njohur një humbje më e vogël dhe këtë vlerësim të zhvlerësimit ta ketë bërë vetëm në fund të periudhës vijuese të raportimit?

Marrëveshje

8. Një njësi ekonomike nuk do të rimarrë një humbje nga zhvlerësimi të njohur në një periudhë të mëparshme të ndërmjetme në lidhje më emrin e mirë.

11 [Fshirë]

12 SNRF 9 “Instrumentet financiare”, i nxjerrë në tetor 2010, ndryshoi paragrafët 1, 2, 7 dhe 8 dhe fshiu paragrafët 5, 6 dhe 11. Nëse zbaton SNRF 9 të nxjerrë në tetor 2010, njësi ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime.

KIRFN 12. Marrëveshjet koncesionare të shërbimit”

C52 Referenca për SNK 39 poshtë titullit “Referencat” është fshirë dhe është shtuar një referencë për SNRF 9 “Instrumentet financiare”. Paragrafët 23-25 janë ndryshuar si vijon, është fshirë paragrafi 28A dhe është shtuar paragrafi 28B:

23. SNK dhe SNRF-të 7 dhe 9 zbatohen për aktivin financiar të njohur sipas paragrafëve 16 dhe 18.

24. Shuma që detyrohet nga ose me urdhër të koncesiondhënësit trajtohet në përputhje me SNRF 9 si:

a) me koston e amortizuar; ose

b) i matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

25. Nëse shuma që paguhet nga koncesiondhënësi është trajtuar si e matur me koston e amortizuar, SNRF 9 kërkon që interesi, i llogaritur duke përdorur metodën e interesit efektiv, të njihet në fitim ose humbje.

28A [Fshirë]

28B SNRF 9 “Instrumentet financiare”, i nxjerrë në tetor 2010, ndryshoi paragrafët 23-25 dhe fshiu paragrafin 28A. Nëse zbaton SNRF 9 të nxjerrë në tetor 2010, njësi ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime.

KIRFN 19 Shlyerja e detyrimeve financiare me instrumente kapitali

C53 Referenca për SNK 39 poshtë titullit “Referencat” është fshirë dhe është shtuar një referencë për SNRF 9 “Instrumentet financiare”. Paragrafët 4(a), 5, 7, 9 dhe 10 janë ndryshuar si vijon dhe është shtuar paragrafi 14:

4. Interpretimi merret me çështjen e mëposhtme:

a) A janë “shumë (konsideratë) e paguar”, instrumentet e kapitalit që një njësi ekonomike emeton për të shlyer të gjithë apo një pjesë të detyrimit financiar, në përputhje me paragrafin 3.3.3 të SNRF 9?

b) ...

Marrëveshje

5. Emetimi i instrumenteve të kapitalit të një njësie ekonomike ndaj një kreditori për të shlyer të gjithë ose një pjesë të detyrimit financiar është shumë (konsideratë) e paguar në përputhje me paragrafin 3.3.3 të SNRF 9. Njësi ekonomike duhet të heqë nga pasqyrat e saj financiare një detyrim financiar (ose një pjesë të tij) atëherë dhe vetëm atëherë kur ai është shlyer në përputhje me paragrafin 3.3.1 të SNRF 9.

7. Nëse vlera e drejtë e instrumenteve të kapitalit nuk mund të matet në mënyrë të besueshme, atëherë instrumentet e kapitalit do të maten me vlerën e drejtë të detyrimit financiar që po shlyhet. Gjatë matjes së vlerës së drejtë të një detyrimi financiar të shlyer që përmban një tipar kërkueshmërie pa afat (p.sh. një depozitë pa afat), nuk zbatohet paragrafi 5.4.3 i SNRF 9.

9. Diferenca mes vlerës kontabël të detyrimit financiar të shlyer (ose një pjesë të detyrimit financiar) dhe konsideratës së paguar do të njihet në fitim ose humbje në përputhje me paragrafin 3.3.3 të SNRF 9. Instrumentet e kapitalit të emtuar do të njihen fillimisht dhe do të maten në datën e shlyerjes së detyrimit financiar (ose pjesës së atij detyrimi).

10. Nëse shlyhet vetëm një pjesë e detyrimit financiar, konsiderata do të shpërndahet në përputhje me paragrafin 8. Konsiderata e shpërndarë në pjesën e mbetur të detyrimit do të bëhet pjesë e vlerësimit nëse janë modifikuar në mënyrë të ndjeshme kushtet e detyrimit të mbetur. Nëse detyrimi i mbetur ka ndryshuar në mënyrë të ndjeshme, njësia ekonomike do të trajtojë modifikimin si shlyerje e detyrimit fillestar dhe njohje e një detyrimi të ri në përputhje me kërkesat e paragrafit 3.3.2 të SNRF 9.

14 SNRF 9 “Instrumentet financiare”, i nxjerrë në tetor 2010, ndryshoi paragrafët 4(a), 5, 7, 9 dhe 10. Nëse zbaton SNRF 9 të nxjerrë në tetor 2010, njësia ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime.

KIS Interpretimi 27 “Vlerësimi i përmbajtjes së transaksioneve që përfshijnë formën ligjore të qirasë”

C54 Referenca për SNK 39 poshtë titullit “Referencat” është fshirë dhe është shtuar një referencë për SNRF 9 “Instrumentet financiare”. Te marrëveshja, paragrafi 7 është ndryshuar si vijon:

7. Detyrimet e tjera të një marrëveshjeve përfshirë garancitë e dhëna dhe detyrimet e ndeshura si rezultat i përfundimit më të hershëm do të trajtohen sipas SNK 37, SNRF 4 ose SNRF 9 në varësi të kushteve.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 21.2.2012
Doli nga shtypi më 23.2.2012

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 92 lekë